



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



DRAFT

RREGULLORE NR. 01/2020

PËR

TAKSA KOMUNALE

Rahovec, Shkurt 2020

DRAFT

DRAFT-RREGULLORE PËR TAKSAT KOMUNALE

Kuvendi i Komunës së Rahovecit

Në mbështetje të nenit 11 dhe nenit 12, paragrafi 2, pika c), nenit 40.2, pika a) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008, 04 Qershor 2008), të Kreut II dhe Kreut III të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 27/2008, 03 Qershor 2008), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L-108 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2016, 03 Gusht 2018), nenit 10 paragrafi 2 pika 2.3, nenit 40 paragrafi 2 pika 2.1, nenit 63 lidhur me nenin 64 dhe 65 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i dates 29.03.2017, në mbledhjen e mbajtur më datë.....
Kuvendi i Komunës së Rahovecit, miraton;

RREGULLORE PËR TAKSAT KOMUNALE

KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Kjo Rregullore ka për qëllim përcaktimin e aktiviteteve të cilat i nënshtrohen taksës komunale në Komunën e Rahovecit, lartësinë e taksave komunale, përcaktimin e kategorive të liruar nga taksa dhe përcaktimin e kundërvajtjeve dhe sanksioneve kundërvajtëse për shkeljet e dispozitave të kësaj Rregulloreje.

Neni 2 Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj Rregulloreje janë të obligueshme për të gjithë personat fizik dhe juridik që nëpërmjet ndonjë aktiviteti të zhvilluar obligohen të paguajnë taksë komunale të përcaktuar me këtë Rregullore si dhe për të gjitha njësitë e Komunës që zbatojnë dispozitat e kësaj Rregulloreje.

Neni 3 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë këto kuptime:

1.1. **Taksë komunale** – nënkupton shumën fikse dhe e pakthyeshme e pagesës sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje, që paguhet nga personat juridik dhe fizik autoriteteve të Komunës në mënyrën e paraparë në këtë Rregullore, në emër të:

- 1.1.1. lëshimit të certifikatave dhe dokumenteve tjera zyrtare të lëshuara nga Komuna;
- 1.1.2. shërbimeve administrative të pranuar nga Komuna;
- 1.1.3. ushtrimit të veprimtarisë afariste në territorin e Komunës;
- 1.1.4. pronësisë së mjeteve motorike në territorin e Komunës;
- 1.1.5. ndërtimit, rrënimt të objekteve dhe ndërhyrjeve në infrastrukturë komunale në territorin e Komunës; dhe
- 1.1.6. shfrytëzimit të objekteve, hapësirës apo të mirave tjera publike në territorin e Komunës.

1.2. **Taksë qendrore** – nënkupton taksat që përcaktohen nga Qeveria e Republikës së Kosovës, të cilat mblihen nga Komuna;

1.3. **Vit fiskal** - nënkupton periudhën nga data një (1) janar deri më datën tridhjetë e një (31) dhjetor të të njëjtut vit;

1.4. **Gjobë** – nënkupton sanksionin kundërvajtës që i shqiptohet personave juridik dhe fizik për shkelje të dispozitave të kësaj Rregulloreje

1.5. **Person** – nënkupton personin fizik dhe juridik;

1.6. **Person fizik** – nënkupton personin fizik jo afarist që nuk ka të regjistruar aktivitet biznesi; dhe personi fizik afarist që ka të regjistruar biznes në bazë të legjislacionit në fuqi dhe që zhvillon aktivitet të rregullt afarist;

1.7. **Person juridik** – nënkupton një shoqëri ose një organizatë tjetër biznesi që ka statusin e një personi juridik sipas legjislacionit në fuqi për shoqëritë tregtare dhe çdo legjislacion tjetër të aplikueshëm në Kosovë;

1.8. **Pano reklamuese** – nënkupton tabelën apo shenjën reklamuese me qëllim të reklamimit të mallrave apo shërbimeve, i vendosur në një objekt statik apo lëvizës;

1.9. **Shoqëri Tregtare** – nënkupton termin e përgjithshëm që përfshin çfarëdo lloji të shoqërisë tregtare të themeluar në Kosovë sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare apo ndonjë ligji tjetër, duke përfshirë bizneset individuale, ortakëritë e përgjithshme, ortakëritë e kufizuara, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionare.

KAPITULLI II

KORNIZAT E PËRGJITHSHME TË TAKSAVE KOMUNALE

Neni 4

Parimet e përgjithshme të taksave komunale në Komunë

1. Të gjitha taksat komunale përcaktohen me këtë Rregullore dhe me ndonjë Rregullore tjetër komunale.
2. Të gjitha taksat komunale përcaktohen marrë parasysh parimin e jo diskriminimit dhe të proporcionalitetit, sipas dispozitave ligjore në fuqi.
3. Taksat komunale që rezultojnë si pasojë e ndonjë veprimi apo shërbimi të kryer nga organet e Komunës, bazohen në koston e atij veprimi që i është shkaktuar Komunës.
4. Asnjë taksë komunale që nuk është e përcaktuar me këtë Rregullore apo në ndonjë Rregullore tjetër komunale nuk mund të kërkohet që të paguhet.

Neni 5

Pagesa e taksave komunale

1. Të gjitha pagesat e taksave komunale që duhet të kryhen sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje, bëhen sipas shumave të përcaktuara në këtë Rregullore dhe paguhet në valutën euro (€).
2. Të gjitha pagesat mbi 10€ (dhjetë euro) sipas kësaj Rregulloreje bëhen nëpërmjet bankave apo institucioneve financiare të licencuara, nëpërmjet një urdhër-pagese të pranuar nga zyrtari përkatës komunal, në xhirollogarinë e Komunës të përcaktuar me vendimin e Kryetarit të Komunës.
3. Të gjitha pagesat deri në 10€ (dhjetë euro) sipas kësaj Rregulloreje bëhen pranë institucioneve përkatëse komunale.
4. Për pagesat e realizuara sipas paragrafit 3 të këtij neni, Komuna lëshon vërtetim përkatës.
5. Të gjitha pagesat e realizuara sipas paragrafit 3 të këtij neni deponohen në xhirollogarinë e Komunës deri në fund të ditës së pranimit

6. Pagesat e bëra nëpërmjet kioskave elektronike (e-kiosku), deponohen në xhirollogarinë e Komunës çdo tre muaj.

Neni 6 Lirimet nga taksat komunale

1. Të gjitha kategoritë e liruara nga pagesa e taksave komunale sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje, përcaktohen me këtë Rregullore.
2. Për çdo lloj liri nga taksat komunale të përcaktuara me këtë Rregullore, personat që përfitojnë nga ky lirim ofrojnë dokumentacionin përkatës që dëshmon përkatësinë e tyre për të përfituar nga lirimet.
3. Për çdo lloj liri nga taksat komunale të përcaktuara me këtë Rregullore zyrtari përgjegjës i Komunës ia bashkëngjit lëndës shkresën me bazën ligjore për lirim nga pagesa.
4. Nëse ndonjë procedurë, ku kërkohet pagesa e taksave komunale, është filluar me kërkesë të më shumë se një personi, ku jo të gjithë janë të liruara nga pagesa e taksave komunale, atëherë taksa komunale paguhet nga ai person i cili nuk është i liru nga pagesa.

KAPITULLI III

DREJTORIA PER ADMINISTRATE TAKSA KOMUNALE PËR LËSHIMIN E CERTIFIKATAVE DHE DOKUMENTEVE ZYRTARE

Neni 7 Lartësia dhe pagesa e taksës për lëshimin e certifikatave dhe dokumenteve zyrtare

1. Të gjithë personat që pajisen me certifikata zyrtare dhe dokumente tjera zyrtare nga Komuna, paguajnë taksë komunale, si në vijim:

Nr.	Kategoria	Prop nga Ministria	Ekzist.	Prop. Kuvend
1	Certifikata e lindjes	1 €		
2	Ekstrakti i lindjes	1 €		
3	Certifikata e shtetësisë	1 €	2€	
4	Certifikata e martesës	1 €		
5	Certifikata e vendbanimit apo e vendqëndrimit	2 €		
6	Certifikata e gjendjes martesore	1 €	5€	3€
7	Certifikata e vdekjes	1 €		
8	Certifikata e bashkësisë familjare	2 €	5€	2€
9	Akti i vdekjes	5 €		
10	Deklaratë për mbajtës të familjes	10 €	10€	
11	Vërtetim për afërsinë familjare	1 €		
12	Vërtetim mbi mjetet e jetesës	2 €		
13	Vërtetim mbi marrëdhëniet familjare	1 €		
14	Vërtetim që personi është në jetë	1 €		
15	Vërtetim që personi nuk është banor i komunës	1 €		
16	Vërtetimi mbi konfirmimin e identitetit	1 €		
17	Vërtetim për lajmërim apo ç'lajmërimin e vendbanimit	2 €		

18	Vërtetim që personi nuk është banor i komunës	1 €		
19	Vërtetimi që personi nuk është regjistruar në regjistrat civil	1 €		
20	Vërtetimi që personi nuk është në marrëdhënie pune	1 €		
21	Vërtetimi për gjendjen ekonomike	1 €		
22	Vërtetim mbi kombësinë	1 €		
23	Vërtetim i arkivës	1 €		
24	Procesverbal i atësisë dhe i amësisë	10 €	10 €	5€
25	Kopja e certifikatave dhe vërtetimeve të lëshuara më parë	0.50 €		1€

2. Paga sipas paragrafit 1 të këtij neni bëhet para pranimit të certifikatës apo dokumenteve zyrtare.

2.1. Pa dëshmi të pagesës nuk mund të merret certifikata apo dokumenti zyrtar.

3. Për pagesat e bëra sipas paragrafit 1 të këtij neni Komuna lëshon dëshminë përkatës dhe ky vërtetim është i vlefshëm brenda gjithë vitit fiskal, kërkesa për marrje të certifikatave dhe dokumenteve zyrtare nuk mund të dorëzohet pas pagesës së taksës.

Neni 8

Lirimet nga pagesa e taksës për lëshimin e certifikatave dhe dokumenteve zyrtare

1. Nga pagesa e taksës për lëshimin e certifikatave dhe dokumenteve zyrtare sipas nenit 7 të kësaj Rregulloreje janë të liruara kategoritë si në vijim:

1.1. Veteranët e luftës - bashkëshortja dhe fëmijet deri në moshën 18 vjeçare (dëshmi kartela valide);

1.2. Invalidët e luftës së UÇK-së - bashkëshortja dhe fëmijet deri në moshën 18 vjeçare; (dëshmi kartela valide)

1.3. Familjarët e dëshmorëve - prindërit dhe bashkëshortja/i; (dëshmi kartela valide)

1.4. Familjarët e të zhdukurve të luftës - prindërit dhe bashkëshortja/i; (dëshmi nga organi kompetent)

1.5. Familjarët e viktimave civile (martirëve) - prindërit dhe bashkëshortja/i; (dëshmi nga organi kompetent)

1.6. Personat e verbër;

1.7. Personat paraplegjik dhe tetraplegjik (me aftësi të kufizuar);

1.8. Përfutuesit e skemave sociale (dëshmi kartoni social me afat);

1.9. Pensionistet, shoqata dhe Sindikata e Pensionisteve; (dëshmi letërnjoftimi);

1.10. Studentët (ID Kartela studentore me afat);

1.11. Ish të burgosurit politik (dëshmi librezë);

1.12. Viktimat e dhunës seksuale të luftës;

1.13. Familjet strehuese;

1.14. Pensionistët invalidor të parakohshëm të punës.

Neni 9

Detyrimi lidhur me të dhënat

1. Të gjithë personat që kërkojnë të pajisen me certifikatat e parapara nga nën paragrafi 1.1 deri në paragrafi 1.8 të paragrafit 1 të nenit 7 kësaj Rregulloreje, duhet të ofrojnë të dhënat lidhur me regjistrin civil me kohë dhe t'i përditësojnë ato brenda afatit të përcaktuar ligjor.

2. Të gjithë personat që kërkojnë të pajisen me vërtetimet e parapara nga nën paragrafi 1.9 deri te nën paragrafi 1.25 të nenit 7 kësaj Rregulloreje, duhet të ofrojnë informata të sakta lidhur me gjendjen përkatëse për të cilën pajisen me vërtetim.

KAPITULLI IV TAKSAT KOMUNALE ADMINISTRATIVE

Neni 10

Lartësia dhe pagesa e taksave komunale administrative

1. Të gjithë personat që pranojnë shërbime të caktuara komunale nga Komuna të paraparë në këtë nen, paguajnë taksë komunale administrative, si në vijim:

Nr.	Kategoria	Prop nga Ministria	Ekzist	Prop. Kuvend
1	Parashtrimi i kërkesave	1€		
2	Kurorëzimi brenda objektit të komunës, brenda orarit të punës	10 €	10€	
3	Kurorëzimi brenda objektit të komunës, jashtë orarit të punës	20 €	20€	
4	Kurorëzimi jashtë objektit të komunës, brenda orarit të punës	25 €		
5	Kurorëzimi jashtë objektit të komunës, jashtë orarit të punës	50 €	50€	
6	Kurorëzimi me shtetas/se të huaj	50 €	50€	
7	Korrigjimi emrit personal (gërmëzimi)	3 €		
8	Ndryshimi i emrit dhe mbiemrit personal	5 €	20€	10€
9	Ndërrimi i mbiemrit pas anulimit të martesës	5 €		
10	Anulimi i dyfishtë i regjistrimit në gjendjen civile	5 €	5€	
11	Konfirmimi i deklaratës me dy dëshmitarë	2 €		
12	Pajisje me dokumente nga arkiva (për një faqe)	0.50 €		
13	Konfirmimi i vërtetësisë së nënshkrimit	1 €		
14	Konfirmimi i vërtetësisë së fotokopjes (për një faqe A4)	0.15 €		
15	Konfirmimi i vërtetësisë së fotokopjes (për një faqe A3)	0.25 €		
16	Lëshimi i certifikatës së përdorimit	20 €		

2. Pagesa sipas paragrafit 1 të këtij neni bëhet para pranimit të shërbimit komunal dhe pa dëshmi të pagesës nuk ofrohet shërbimi.
3. Kërkesat në emër të këshillave (kryetarëve) të fshatrave dhe lagjeve urbane lirohen nga pagesa e taksës administrative nga pika 1 e paragrafit 1 të këtij neni.

KAPITULLI V DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE

Neni 11

1. Taksa mbi shërbimet shëndetësore sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 04/2007 – Mbledhja dhe Shfrytëzimi i mjeteve nga bashkëpagesat e shfrytëzuesve të shërbimeve shëndetësore dhe të hyrave vetanake të institucioneve shëndetësore.

Nr.	Kategoria	Taksa Qëndrore
1	Egzaminimi mjekësor i mjekut në punkt, QMF ose në QKMF pa analiza laboratorike dhe pa procedura plotësuese diagnostike me aparaturë	1.00€
2	Ekzaminimi specialistik në QKM/QKMF me udhëzim të mjekut të familjes	2.00 €
3	Ekzaminimi specialistik në QKMF/QMF pa udhëzim të mjekut të familjes	5.00 €
4	Ekzaminimi në shtëpi, përpos në rastet emergjente	6.00 €
5	Medikamenti nga lista esenciale, ofruar në barnatoren publike	0.00 €
6	Ultrazëri standard	2.00 €
7	Radiografia	2.00 €
8	EKG	0.50 €
9	Analizat laboratorike-hemogrami dhe urina	1.0 €
10	Analizat laboratorike (komplet)	3.00 €
11	Caktimi i sheqerit në gjak me glikometër sipas kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve	1.0 €
12	Audiograma	1.0 €
13	Shpërlarja e veshit	1.0 €
14	Dhënia e injeksionit intramuskulor në shtëpi, përpos në rastet emergjente	1.0 €
15	Dhënia e injeksionit intravenoz në shtëpi, përpos në rastet emergjente	1.0 €
16	Përpunimi i plagëve me qepje dhe pastrimi deri në shërim të plagës (vetëm në vizitën e parë)	3.00 €
17	Trajtimi ditor me infuzione në institucionin shëndetësor	1.0 €
18	Certifikata për lejen e vozitjes e lëshuar nga konsiliumi i profesionistëve	18.00 €
19	Certifikata mjekësore e lëshuar sipas kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore për punësim	18.00 €
20	Certifikata mjekësore e lëshuar sipas kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore	18.00 €
21	Dhënia e raportit mjekësor, vërtetimit apo dokumentit tjetër në bazë të kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore	5.00 €
22	Ofrimi i shërbimeve shëndetësore gjatë aktiviteteve sportive – për një orë	25.00 €
23	Certifikata për adoptim të fëmijëve	50euro

2. Shërbimet stomatologjike të nivelit parësor

Nr.	Kategoria	Taksa Qëndrore
1	Vizita e parë stomatologjike	1.0 €
2	RTG i dhëmbit	1.50 €
3	Mbështetje e përhershme me amalgamë	4.00 €
4	Mbushje e përhershme me kompozitë	5.00 €
5	Shërimi biologjik i dhëmbit me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë)	5.00 €

6	Amputimi vital i pulpës me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë)	6.00 €
7	Ekstirpimi vital i pulpës me mbushje të përhershme të (amalgamë kompozitë)	6.00 €
8	Amputimi mortal i pulpës me mbushje të përhershme të (amalgamë apo kompozitë)	6.00 €
9	Ekstirpimi mortal i pulpës me mbushje të përhershme të (amalgamë apo kompozitë)	6.00 €
10	Terapia e kanalit të infektuar me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë)	6.00 €
11	Rindërtimi konservativ i dhëmbit me mbushje të përhershme	6.00 €
12	Revizioni i mbushjes së kanalit të rrënjës	1.0 €
13	Fluorizimi i dhëmbëve sipas seancave	1.0 €
14	Vulosja e fisurave	1.0 €
15	Mënjanimi i depozitimeve të buta	1.0 €
16	Mënjanimi i depozitimeve të (forta heqja e gurëve të dhëmbëve me ultratingull)	3.00 €
17	Kieretazha e xhepave paradonta (një dhëmbë)	1.0 €
18	Nxjerrja e dhëmbit	1.50 €
19	Incizimi infra dhe ekstra oral	1.50 €
20	Heqja e kurorës me anë të prerjes	1.0 €
21	Riparimi i protezës (ngjitja)	1.50 €

Neni 12

Lirimet nga pagesa e shërbimeve shëndetësore

1. Nga pagesa e shërbimeve shëndetësore sipas nenit 11 të kësaj Rregulloreje janë të liruar kategoritë si në vijim:
 - 1.1. Veteranët e luftës - bashkëshortja dhe fëmijët deri në moshën 18 vjeçare (dëshmi kartela valide);
 - 1.2. Invalidët e luftës së UÇK-së - bashkëshortja dhe fëmijët deri në moshën 18 vjeçare; (dëshmi kartela valide)
 - 1.3. Familjarët e dëshmorëve - prindërit dhe bashkëshortja/i; (dëshmi kartela valide)
 - 1.4. Familjarët e të zhdukurve të luftës - prindërit dhe bashkëshortja/i; (dëshmi nga organi kompetent)
 - 1.5. Familjarët e viktimave civile (martirëve) - prindërit dhe bashkëshortja/i; (dëshmi kartela nga organi kompetent)
 - 1.6. Personat e verbër;
 - 1.7. Personat paraplegjik dhe tetraplegjik (me aftësi të kufizuar);
 - 1.8. Përfutuesit e skemave sociale (dëshmi kartoni social me afat);
 - 1.9. Pensionistet, shoqata dhe Sindikata e Pensionistëve; (dëshmi leternjoftimi);
 - 1.10. Studentët - (studentat mbi moshën 25 vjeçare, dëshmi vërtetimi i semestrit);
 - 1.11. Ish të burgosurit politik (dëshmi kartela nga shoqata e të burgosurve);
 - 1.12. Familjet strehuese dhe fëmijët që janë të strehuar.
 - 1.13. Pensionistët invalidor të parakohshëm të punës.

Neni 13
Taksat për shërbimet Sociale (QPS)

Nr.	Kategoria	Taksa Ekzist	Prop QPS	Prop Kuvend
1	Vërtetim për humbjen e shtetësisë	5€	20€	
2	Vërtetim për fitimin e shtetësisë së Kosovës	5€	10€	
3	Vërtetim që nuk i është hequr zotësia e veprimit për armëmbajtje	3€	20€	10€
4	Vërtetim që nuk i është hequr zotësia e veprimit për punësim		10€	2€
5	Pëlqim për martesë para moshës madhore	5€	10€	
6	Caktimi i emrit personal	3€	10€	
7	Kërkesë për regjistrim të mëvonshëm të fëmijëve	5€		
8	Vërtetim që pala nuk është në përkujdesjen e kujdestarit të përkohshëm ligjor	5€		
9	Vendim për caktimin e kujdestarit për raste të veçanta	10€		5€
10	Pëlqim për udhëtim jashtë vendit për fëmijë, prindërit e të cilëve jetojnë ndaras jashtë shtetit	5€		
11	Anamneza sociale, (konstatim i gjendjes faktike) dhe shërbimet tjera	3€	5€	
12	Vërtetim që nuk është përfitues i ndihmës sociale	3€	5€	3€

KAPITULLI VI
DREJTORIA PËR ARSIM

Neni 14

1. Taksa për vijimin dhe përfundimin e arsimit dhe aftësimin për të rritur sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 11/2011 për Partecipim të Vijuesve të Arsimit dhe Aftësimin për të Rritur

Nr.	Kategoria	Taksa Qëndrore	Taksa Ekzis	Prop Kuvend
1	Për regjistrim të vitit - për një klasë	100 €		
2	Për praktikë profesionale	50 €		
3	Provimi diferencial	10 €		
4	Për provimet përfundimtare të klasës – certifikata	30 €		
5	Për diplomë të përfundimit të shkollimit	20 €		
6	Qëndrimi ditor i fëmijës në qerdhe për 1 muaj		30€ Prop 40€	30€
7	Qëndrimi gjysmëditor i fëmijës në qerdhe për 1 muaj		15€ Prop 20€	15€
8	Pagesa për diplomat duplikat		1 €	
9	Pagesa për dëftesa duplikat		0.50 €	

2. Çdo person që shfrytëzon objektet komunale komerciale apo për qëllime tjera, paguan taksë komunale si në vijim:
 - 1.1. Shfrytëzimi i sallave të sportit për qëllime komerciale dhe jo komerciale në shkolla – 10 € (dhjetë euro) për një orë;
3. Përfshirë nga paragrafi 1 i këtij neni, shfrytëzimi i objekteve komunale për qëllime edukative, arsimore, shkencore dhe për qëllim të ngjashme sociale është i liruar nga pagesa.
4. Pagesa e taksës komunal për shfrytëzimin e përkohshëm të objekteve komunale sipas paragrafit 1 të këtij neni bëhet para marrjes në shfrytëzim të objektit.

KAPITULLI VII DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

Neni 15

Lartësia dhe pagesa e taksës komunale mbi mjetet motorike

1. Çdo person fizik cili është banor i Komunës dhe ka në pronësi mjet motorik dhe çdo person juridik që ka seli në Komunë dhe ka në pronësi mjet motorik, paguan taksën vjetore mbi pronësinë e mjetit motorik, si në vijim:

Nr.	Kategoria	Taksa Qëndrore	Taksa Ekzist	Prop Kuvend
1	Motoçikletë	10€	00€	5 €
2	Automobil për udhëtarë	20 €	10€	
3	Automobil transportues për udhëtar mbi 3.5 ton	25 €	20€	
4	Kamionet deri në 3.5 ton	25 €	10€	
5	Kamionet mbi në 3.5 ton	30 €	20 €	
6	Kombibus dhe autobusë për transportim të udhëtarëve deri në 30 ulëse	30 €	20 €	
7	Autobusë për transportim të udhëtarëve mbi 30 ulëse	35 €	20 €	25€

2. Personat e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, taksën e paguajnë para regjistrimit të mjetit motorik sipas legjisalcionit në fuqi.

Neni 16

Lirimet nga taksa komunale mbi mjetet motorike

1. Nga pagesa e takës komunale mbi mjetet motorike janë të liruar mjetet motorike në pronësi të:
 - 1.1. institucioneve publike të Republikës së Kosovës;
 - 1.2. institucioneve ndërkombëtare dhe përfaqësitë diplomatike, përfshirë edhe stafin e huaj;
 - 1.3. Kryqit të Kuq të Kosovës;
 - 1.4. Veteranet e UCK-se;
 - 1.5. Invalidet e UCK-se; dhe
 - 1.6. Familjet e Deshmorëve, prindrit, bashkeshortja dhe fëmijet;
 - 1.7. Mjetet motorike tjera si rimorkojo, mekanizmat motorik bujqësore lirohen nga taksa komunale
 - 1.8. Shoqatat për persona me aftësi të kufizuara.

KAPITULLI VIII
DREJTORIA PËR EKONOMI, ZHVILLIM DHE TURIZËM

Neni 17

Lartësia dhe pagesa e taksës komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste

Nr.	Emertimi	Taksa Ekzist	Prop Kuvend
1	Vendimi mbi ndërrimin e pronarit, emrit të biznesit (lokali i njëjtë)	20€	
2	Vendimi për vazhdimin e orarit në hotel, restaurant dhe sallonet e dasmave për 1 natë	30€	
3	Vendimi për leje pune në ditët e festave për 1 ditë	20€	
4	Leje të posaçme të ndërmarrjeve ndërtimore/ në rastet e jashtëzakonshme për shkak të natyrës së punëve deri në ora 23h (1 ditë)	20€	
5	Të gjitha veprimtaritë për oraret e zgjatura të çfarëdo veprimtarie për 1 ditë	20€	
6	Vendim për leje pune në ditët e festave për (1 vit)	100 €	
7	Vendimi për vazhdimin e orarit të punës në hotel, restaurant dhe sallonet e dasmave për një (1) muaj, vetëm për dasma dhe ahengje familjare	600 €	
8	Dhënia e vërtetimit, dëshmi për kontributin e sigurimit pensional, invalidor, për bizneset e regjistruara para luftës	1€	

Neni 18

Çmimi fillestar i dhënies së pronës komunale në shfrytëzim (Ankand Publik)

Nr .	Emertimi	Ekzist	Prop nga DEZHT	Prop Kuvend
1	Dhënia e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim - lokaleve afariste (Zona e parë) – me qera (çmimi fillestar)	2€/m ² mujore	4€/m ² mujore	2€/m ² mujore
2	Dhënia e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim të depove të Matrexit në Xërxe me qera (Çmimi fillestar)	0.50€/m ² mujore	0.60€/m ² mujore	
3	Dhënia e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim të depove të Matrexit në Xërxe – hapësira e jashtme – me qera (Çmimi fillestar)	0.10€/m ² mujore	0.20€/m ² mujore	
4	Dhënia e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim - lokaleve afariste (Palestra Sportive) me qera - (Çmimi fillestar)	0.00	4€/m ² mujore	
5	Dhënia e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim të tregjeve (Qytet) me qera - Çmimi fillestar	0.20€/m ² mujore	0.20€/m ² mujore	
6	Dhënia e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim të tregjeve me qera (Fshat) - Çmimi fillestar	0.10€/m ² mujore	0.10€/m ² mujore	

Neni 19

Taksa për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme të komunës – Zona Ekonomike – Parku Industrial – Opterushë (Taksa Vjetore)

Nr	Emërtimi	Taksa e propozuar nga DEZHT	Propozimi Kuvendi
1	Siperfaqja nga 1 deri ne 2000 m ²	0,08€	
2	Siperfaqja nga 2000 deri ne 5000 m ²	0,06€	
3	Siperfaqja nga 5000 deri ne 10,000 m ²	0,05€	
4	Siperfaqja nga 10,000 deri ne 20,000 m ²	0,03€	

Neni 20

Çmimet fillestare për dhënien në shfrytëzim të tokës komunale (me ankand publik) – Taksa mujore

- Qiraja për shfrytëzimin e tokës komunale nëpër vendbanime dhe vise tjera rurale të komunës së Rahovecit është si në vijim:
 - Çmimi i qerasë mujore për zonën e parë që përfshin pronat komunale që shtrihen përgjatë rrugëve magjistrale është 0.20€/m²;
 - Çmimi i qerasë mujore për zonën e dytë që përfshin pronat komunale në periferi të rrugëve magjistrale është 0.10€/m²;
 - Çmimi i qerasë mujore për zonën e tretë që përfshinë pronat komunale kodrinore – malore është 0.05€/m²;
- Qiraja për shfrytëzimin e tokës komunale me qëllim të vendosjes apo ndërtimit të objekteve të përkoshme për aktivitete biznesore është si në vijim:
 - Çmimi i qerasë mujore për zonën e parë është ----- 0.50€/m²;
 - Çmimi i qerasë mujore për zonën e dytë është ----- 0.30€/m²;
 - Çmimi i qerasë mujore për zonën e tretë është ----- 0.20€/m²;
- Qiraja duhet paguar në baza mujore dhe pagesa duhet të kryhet në bazë të kontratës.

Neni 21
Minierat dhe guroret

1. Çdo shoqëri tregtare e regjistruar në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës (ARBK) që ndodhet brenda Komunës, paguan takse vjetore komunale në emër të ushtrimit të veprimtarisë afariste profesionale, për aktivitetet ekonomike të zhvilluar si në vijim:

Nr.	Kategoria	Taksa Qëndro	Taksa Ekzist	Prop DEZH T - Kuvend
0811	Gurthyerja e gurit ornamental dhe ndërtimor, gëlqeres, gipsit, shkumësit dhe rrasave	300 €	500 €	
0812	Operimi i puseve të zhavorrit dhe rërës; miniera e argjilave dhe kaolinit	300 €	500 €	
089 9	Minierat dhe gurëthyesit tjerë p.k.t.	300 €	300€	500€
1061	Prodhimi i produkteve të miellit të drithit	80 €	200€	
1729	Prodhimi i artikujve të tjerë prej letre dhe kartuçi	100 €	200€	
1813	Shërbimet e përgatitjes për shtyp dhe botim	60 €	50€	
2361	Prodhimi i produkteve të betonit për qëllime të ndërtimtarisë	250 €	0€	500€
236 3	Prodhimi i betonit të përzier të gatshëm	250 €	500€	
3312	Riparimi dhe mirëmbajtja e makinerise	100 €		100€
3513	Distribucioni i rrymës	500 €	500 €	2000€
352 2	Distribucioni i lëndëve të gazit përmes stacioneve shpërndarës	400 €	400 €	100€
360 0	Grumbullimi i ujit, trajtimi dhe furnizimi	200 €	300€	
370 0	Kanalizimi	200 €	150€	250€
3811	Grumbullimi i mbeturinave jo të rrezikshme	200 €	200 €	100€
3812	Grumbullimi i mbeturinave të rrezikshme	300 €	300 €	100€
3831	Çmontimi i mbeturinave të metala	250 €	250 €	100€
4110	Zhvillimi i projekteve ndërtimore	300 €	300 €	100€
4120	Ndërtimi i objekteve banesore dhe jo banesore	400 €	150€	200€
4211	Ndërtimi i rrugëve dhe autostradave	400 €	400 €	300€
4311	Demolimi i objekteve	300 €	300 €	100€
4321	Instalimi elektrik	350 €	350 €	200€
4331	Suvatimi	200 €	100€	
433 4	Lyerja dhe lustrimi	200 €	200 €	100€
4511	Shitja e veturave dhe mjeteve të lehta motorike	250 €	250 €	150€
4519	Shitja e mjeteve tjera motorike	200 €	200 €	100€
452 0	Mirëmbajtja dhe riparimi i mjeteve motorike	200 €	100€	
4531	Shitja me shumicë e pjesëve dhe aksesoreve të mjeteve	300 €	300 €	200€

	motorike			
453 2	Shitja me pakicë e pjesëve dhe aksesorëve të mjeteve motorike	200 €	200 €	100€
4631	Shitja me shumicë e frutave dhe perimeve	200 €	200 €	100€
463 2	Shitja me shumicë e mishit dhe produkteve të mishit	300 €	300 €	150€
4641	Shitja me shumicë e tekstileve	150 €	150 €	100€
464 3	Shitja me shumicë e aparateve elektrike shtëpiake	180 €	180 €	200€
464 5	Shitja me shumicë e parfumeve dhe kozmetikës	200 €	200 €	100€
4661	Shitja me shumicë e makinerisë bujqësore, pajisjeve dhe furnizimeve	300 €	200€	
4671	Shitja me shumicë e produkteve të ngurta, lëngat dhe lëndëve djegëse të gazta etj	250 €	300€	
467 3	Shitja me shumicë e drurit, materialeve ndërtimore dhe pajisjeve sanitare	250 €	200€	
467 5	Shitja me shumicë e produkteve kimike	300 €	100€	
467 7	Shitja me shumicë e mbeturinave dhe hekurishteve	200 €	100€	
472 2	Shitja me pakicë e mishit dhe produkteve të mishit në shitore të specializuara	100 €	150€	
473 0	Shitja me pakicë e karburanteve motorike në shitore të specializuara	200 €	250€	
4741	Shitja me pakicë e kompjuterëve, njësive periferike dhe softuerëve në shitore të specializuara	100 €	100€	
474 2	Shitja me pakicë e pajisjeve të telekomunikimit në shitore të specializuara	100 €	100 €	100€
475 2	Shitja me pakicë e artikujve metalik, bojërave dhe qelqit në shitore të specializuara	100 €	100 €	100€
475 3	Shitja me pakicë e qilimave, tapicerisë së murit dhe materialit të dyshemeve në shitore të specializuara.	100 €	100 €	100€
475 4	Shitja me pakicë e elektrike shtëpiake në shitore të specializuara	100 €	200€	
475 9	Shitja me pakicë e mobileve, pajisjeve të ndriçimit dhe artikujve tjerë shtëpiak në shitore të specializuara	100 €	300€	
4771	Shitja me pakicë e rrobave në shitore të specializuara	80 €	100€	
477 3	Farmacisti shpërndarës në shitore të specializuara (Barnatoret)	150 €	150€	
477 6	Shitja me pakicë e luleve, bimëve, farërave, plehrave artificial, kafshëve përkëdhelëse dhe ushqimi i tyre në shitore të specializuara	70 €	70 €	100€
477 7	Shitja me pakicë e orëve dhe argjendarisë në shitore të specializuara	70 €	70 €	100€
493 9	Transporti tjetër tokësor i pasagjerëve.	100 €	50€	

4941	Transporti i mallrave përmes rrugëve	100 €	50€	
5210	Magazinimi dhe deponimi	100 €		100€
522 9	Aktivitetet tjera përkrahëse të transportit	100 €	100€	
5310	Aktivitetet postare sipas obligimit të shërbimit universal	100 €	300€	
5510	Hotelet dhe akomodimi i ngjashëm	150 €	200€	
559 0	Akomodimi tjetër	100 €	300€	
5610	Restorante dhe aktivitetet tjera shërbyese të ushqimit	150 €	150€	
5621	Aktivitetet e furnizimit të rastësishëm të ushqimit	100 €	300€	
602 0	Aktivitetet e programimit dhe transmetimit televiziv	250 €	200€	
6110	Aktivitetet e telekomunikimit kabllor	250 €	1000€	
6312	Web portalet	300 €	300 €	150€
6419	Ndërmjetësime tjera monetare	600 €	600 €	150€
649 2	Ndihma tjera kreditore financiare	600 €	500€	
649 9	Aktivitetet tjera shërbyese financiare, përveç financimit të sigurimit dhe pensional p.k.t.	500 €	1000€	
6511	Sigurimi jetësor	600 €	500€	
6512	Sigurimi jo- jetësor	600 €	600 €	500€
6910	Aktivitetet ligjore (Përveq Avokaturave)	200 €	200 €	100€
692 0	Aktivitetet e kontabilitetit, mbajtjes së librave dhe të auditimit; konsultim mbi taksat	200 €	200 €	100€
7111	Aktivitetet arkitekturale	200 €	200 €	100€
7112	Aktivitetet inxhinierike dhe të konsultimit teknik	200 €	100€	
7120	Testimi dhe analiza teknike	200 €	500€	
743 0	Aktivitetet e përkthimit dhe interpretimit	200 €	100€	
7510	Aktivitetet veterinare	150 €	50€	
7711	Qiradhënia dhe lizingu i veturave dhe automjeteve të lehta motorike	300 €	300 €	100€
7712	Qiradhënia dhe lizingu i kamionëve	350 €	350 €	100€
7911	Aktivitetet e agjencionit turistik	200 €	200 €	100€
8010	Aktivitetet e sigurimit privat	250 €	250 €	100€
8121	Pastrimi i përgjithshëm i ndërtesave	150 €	150 €	100€
855 3	Aktivitetet e auto shkollave	300 €	100€	
8610	Aktivitetet spitalore	500 €	200€	
862 3	Aktivitetet e praktikës dentale	400 €	150€	
869 0	Aktivitete tjera të shëndetit njerëzor	400 €	100€	
960 2	Sallonet e floktarisë dhe trajtimet tjera të bukurisë	200 €	200 €	100€
960 4	Aktivitetet e mirëqenies fizike	200 €	50€	

2. Komuna i dërgon faturat për pagesën e taksës për ushtrimin e veprimtarisë afariste shoqërive tregtare më së largu deri më 31 (tridhjetenjë) mars të vitit aktual. Nëse Komuna nuk ka arritur të dorëzojë faturën brenda këtij afati, obligohen shoqëritë tregtare ta kërkojnë faturën nga Komuna.
3. Shoqëritë tregtare e paguajnë taksën vjetore për ushtrimin e veprimtarisë afariste deri më 15 (pesëmbëdhjetë) dhjetor të vitit aktual fiskal.
4. Taksa komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste përcaktohet në bazë të aktivitetit të regjistruar në ARBK.

Neni 22

Pagesa e pjesshme e taksës komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste

1. Në qoftë se shoqëria tregtare është shuar gjatë vitit fiskal, pagesën e taksës komunave e bën si në vijim:
 - 1.1. Nëse shoqëria tregtare është shuar nga data 1 (një) janar deri më datën 31 (tridhjetenjë) mars të vitit fiskal, paguan 30 % (tridhjetë për qind) të vlerës së taksës;
 - 1.2. Nëse shoqëria tregtare është shuar nga data 31 (tridhjetenjë) mars deri më datën 31 (tridhjetenjë) gusht të vitit fiskal, paguan 70 % (shtatëdhjetë për qind) të vlerës së taksës; dhe
 - 1.3. Nëse shoqëria tregtare është shuar nga data 31 (tridhjetenjë) gusht deri në datën 30 (tridhjetë) nëntor të vitit fiskal, paguan 90 % (nëntëdhjetë për qind) të vlerës së taksës; dhe
 - 1.4. Nëse shoqëria tregtare është shuar pas datës 30 (tridhjetë) nëntor të vitit fiskal, paguan taksën e plotë.
2. Shoqëritë tregtare të regjistruar në territorin e komunës që kryejnë veprimtari në 2 (dy) apo më shumë njësi, për çdo njësi tjetër paguajnë vlerën prej 50% (pesëdhjetë për qind) të taksës komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste.
3. Shoqëritë tregtare që gjatë vitit fiskal kanë qenë pasive dhe nuk kanë ushtruar veprimtari, lirohen me dëshmi të pasqyrës financiare nga ATK.
4. Me qëllim të zbatimit të paragrafëve 1 deri në 3 të këtij neni, përfaqësuesit e shoqërive tregtare duhet t'i ofrojnë Komunës dëshmi përkatëse nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) dhe/apo nga institucionet tjera përkatëse.
5. Shoqëritë tregtare që janë të regjistruara jashtë territorit të komunës, për çdo njësi që vepron në territorin e Komunës paguajnë vlerën e plotë të taksës komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste.

Neni 23

Lirimet nga taksa komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste

1. Çdo shoqëri tregtare në vitin e parë të themelimit/regjistrimit të saj, pa marrë parasysh datën e regjistrimit/themelimit, lirohet nga pagesa e taksës komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste.
2. Nga pagesat e taksës komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste janë të liruar kategoritë si në vijim:
 - 2.1. Bashkësitë fetare, në ushtrimin e aktivitetit ekonomik për vetë qëndrueshmëri financiare; dhe
 - 2.2. Organizatat jo qeveritare të angazhuar në aktivitet ekonomik me qëllim të mbështetjes së aktivitetit të saj jofitimprurës.
 - 2.3. Përjashtohen nga pika 2.2 organizatat jo qeveritare të cilat lëshojnë kredi me kamata fitimprurese (institucionet mikro financiare).

KAPITULLI IX
DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Neni 24
Taksa komunale lejet për ndërtim dhe rrënim

1. Çdo person i cili synon të bëjë ndërtim apo rrënim të objekteve, paguan takës komunale për pajisjen me leje ndërtim apo për rrënim, si në vijim:

Nr.	Emertimi	Ekzist	Prop Drejt - Kuvend
1	Leje ndërtimi për një metër katror (€/m ²);	1.70€/m ²	
2	Leje rrënimi	5€	
3	Vendim për vazhdimin e lejes së ndërtimit	10€	
4	Leje për shfrytëzimin e tokës ndërtimore (vendosja e objekteve të përkoshme	10€	
5	Miratimi i vendimeve dhe pelqimeve	5€	
6	Vërtetimet Sipas Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) (lloji i destinimit të tokës- industrial)		100€
7	Vërtetimet Sipas Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) (lloji i destinimit të tokës- bujqësore)		20€
8	Taksa ndërtimore për ndërtimin e shtallave		1€ /m ² ose 60% e vlerës së taksës bazë
9	Ndërtimi i objekteve banesore kolektive mbi tri banesa – sipas vlerës së taksës bazë	70%	
10	Ndërtimi i bodrumit – sipas vlerës së taksës bazë	40 %	
11	Ndërtimi i nënkulmit për banim – sipas vlerës së taksës bazë	60%	
12	Për objektet që ndërtohen në themelet e mëparshme (ekzistuese) dhe me sipërfaqe të njëjtë – sipas vlerës së taksës bazë	40%	
13	Hapësirat e lira të shfrytëzuara – sipas vlerës së taksës bazë	20%	
14	Hapësirat e mbuluara të shfrytëzuara – sipas vlerës së taksës bazë	40%	
15	Ballkonet, terasat dhe loxhat – sipas vlerës së taksës bazë	40%	

3. Taksa për dhënie e lejes mjedisore sipas Udhëzimit Administrativ MMPH - Nr. 01/2017 për Dhënie e Lejes Komunale Mjedisore,

Nr.	Leja mjedisore	Taksa
1	Leja mjedisore komunale për projektet në vlerë investive deri në 25.000 €	50.00 €
2	Leja mjedisore komunale për projektet në vlerë investive mbi 25.000 €	0.2% e vlerës së projektit

4. Lista e aktiviteteve që i nënshtrohen Lejes Mjedisore Komunale:

- 4.1 Autoserviset;
- 4.2 Autolarjet;
- 4.3 Stacionet e karburanteve të benzinës me kapacitet 50 m³;
- 4.4 Pikë shitjet e gasit (GLN) deri ne 5 m³;
- 4.5 Sharre për lëndë drunore;
- 4.6 Fabrikë për përpunimin e drurit, mobileri, etj., deri ne 1000 m³/vit;
- 4.7 Fabrika për përpunimin dhe ambalazhimin e ujit natyral, me kapacitet deri ne 1 m³/dit;
- 4.8 Fabrika për prodhimin e lëngjeve të frutave, pije freskuese, pije alkoolike me kapacitet deri në 1 m³/dite;
- 4.9 Furra për prodhimin e bukës dhe produkteve tjera nga mielli;
- 4.10 Rrjeti i kanalizimit të ujërave të zeza dhe rehabilitimi i tij në gjatësi deri ne 5 km;
- 4.11 Rehabilitimi i rrjetit të ujës-jellës ekzistues, në gjatësi deri ne 5 km;
- 4.12 Riparimi i rrugëve ekzistuese dhe ndërtimi i akseve të reja rrugore (me gjatësi deri në 2 km);
- 4.13 Fabrika për përpunim të qumështit dhe produkteve të tij deri në 1000 l/ditë;
- 4.14 Fabrika për prodhimin e vajrave bimore, etj., me kapacitet 500 kg/ditë;
- 4.15 Thertore me kapacitet deri në 3 gjedha/ditë;
- 4.16 Fabrika për përpunim të pemëve dhe perimeve me kapacitet deri në 100 kg/ditë;
- 4.17 Prodhimi i gelqeres (shuarja) deri në 100 ton/vit;
- 4.18 Prodhimi i betonit dhe elemnteve parafabrikate, pllakave, etj., me kapacitet deri në 50 m³/ditë;
- 4.19 Magazina e lubrifikantëve të ambalazhuara në vend prodhim;
- 4.20 Qendra per grumbullimin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi, për komunat të cilat kanë më pak se 60 000 banorë;
- 4.21 Prodhimi i këpucëve dhe aksesorëve të tjerë të ngjashëm, pa proces kimik (qepje, ngjitje, montim, etj.);
- 4.22 Prodhimi i kartonit dhe ambalazheve të tjerë me kapacitet deri në 500 kg/ditë;
- 4.23 Rritja artificiale e peshkut në hurdha, me siperfaqe deri në 300 m³;
- 4.24 Punishtet e vogla për përpunim të mermerit me siperfaqe totale – objekti deri në 200 m³;
- 4.25 Ndërtimi i objekteve të banimit kolektiv dhe të shërbimeve (hoteliere, tregtare, komerciale, afariste, etj.) me siperfaqe bazë ndërtimi më të madhe se 600 m³;
- 4.26 Veprimtaria e prodhimit të kompostit me sasi totale përpunimi deri 100 m³ ose 40 ton/vit;
- 4.27 Depoja për plehëra kimik dhe pesticide, me kapacitet magazinues deri ne 10 ton;
- 4.28 Objektet shërbyese për ushqime të shpejta;
- 4.29 Vendet ku deponohen më pak se 10 ton mbeturina inerte;
- 4.30 Impiantet për riciklimin dhe prodhimin e plastikës, me kapacitet deri në 100 ton/vit;
- 4.31 Impiantet për rritjen intensive të shpezëve, derrave, bagëtime të imëta dhe të mëdha që kanë më pak se 3000 shpend, 150 derra, 30 gjedha, 300 bagëti të imeta;
- 4.32 Pajisjet për shfrytëzimin e fuqisë së erës për prodhimin e energjisë me fuqinë instaluese deri në 100 KW/h;
- 4.33 Sistemi solar dhe sistemet fotovoltaike të prodhimit të energjisë/avullit deri në 100KW/orë.

Neni 25

Lirim nga taksat komunale të ndërtimit dhe rrënimit

1. Nga pagesa e taksës së ndërtimit, rrënimit, ndikimit në infrastrukturë dhe rritjes së densitetit janë të liruar kategoritë ndërtimore si në vijim:

- 1.1. ndërtimet të cilat financohen nga Buxheti i Republikës së Kosovës;
- 1.2. ndërtimet të cilat financohen përmes donacioneve apo grantëve për interes të publikut në pajtim me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e financave publike;
- 1.3. ndërtimet për banim individual për përfituesit e skemës së ndihmës sociale;
- 1.4. rindërtimet e ndërtimeve të shkaktuara si rezultat i luftës, trazirave shoqërore ose forcës madhore; dhe
- 1.5. ndërtimet e objekteve fetare dhe të objekteve që kanë karakter social.

Neni 26

Pagesat e taksave komunale të ndërtimit, rrënimit, ndikimit në infrastrukturë dhe rritjes së densitetit

1. Pagesa e taksave komunale të ndërtimit, rrënimit, dhe rritjes së densitetit bëhet sipas Udhëzimit Administrativ Nr. MMPH Nr. 06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushtet ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrërimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të ndërtimeve, apo çdo legjilacion pasues.

2. Pagesa e taksave komunale të ndikimit në infrastrukturë në vlerë deri në vlerë dyzet mijë euro (40.000 €) paguhet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e aprovimit të kërkesës së lejes përkatëse dhe asnjë veprim për ndërtim dhe rrënim nuk mund të realizohet pa pagesën e kësaj takse komunale.

3. Pagesa e taksave komunale të ndërtimit, rrënimit, ndikimit në infrastrukturë dhe rritjes së densitetit, shuma e të cilave tejkalon shumën prej dyzet mijë euro (40.000 €) mund të paguhet në tre (3) kështe për një periudhë 12 mujore, duke filluar nga data e marrjes së lejes së ndërtimit, si në vijim:

- 3.1. kësti i parë - pagesa prej dyzetë për qind (40 %) të taksës;
- 3.2. kësti i dytë - pagesa prej tridhjetë për qind (30%) të taksës; dhe
- 3.3. kësti i tretë - pagesa prej tridhjetë për qind (30%) të taksës.

4. Pagesa e taksave komunale të ndërtimit, rrënimit, ndikimit në infrastrukturë dhe rritjes së densitetit, shuma e të cilave tejkalon shumën prej njëqind mijë euro (100.000 €) mund të paguhet në katër (4) kështe për një periudhë 24 mujore, duke filluar nga data e marrjes së lejes së ndërtimit, si në vijim:

- 4.1. kësti i parë - pagesa prej tridhjetë për qind (30 %) të taksës;
- 4.2. kësti i dytë - pagesa prej njëzet e pesë për qind (25%) të taksës;
- 4.2. kësti i tretë - pagesa prej njëzet e pesë për qind (25%) të taksës; dhe
- 4.3. kësti i katërt - pagesa prej njëzetë për qind (20%) të taksës.

5. Për zbatimin e paragrafëve 3 dhe 4 të këtij neni, Komuna lidh marrëveshjes të veçantë me aplikuesin e lejes ndërtimore para autoritetit noterial ku përcaktohen që pagesa e kështit të parë të bëhet brenda një (1) muaji nga data e lidhjes së marrëveshjes dhe aplikuesi i lejes ndërtimore siguron një garancionin bankar për Komunën, për pagesën e kështeve tjera.

6. Në rast të mos pagesës së kështit të parë sipas marrëveshjes së lidhur në bazë të paragrafit 4 të këtij neni, aplikuesi i lejes:

6.1 Komuna nuk ia lëshon aplikuesit lejen ndërtimore apo të rrënimit; ose

6.2. Komuna realizon shumën e tërësishme të papaguar nga aplikuesi nëpërmjet garancionit bankar dhe më pas e lëshon lejen ndërtimore apo të rrënimit.

KAPITULLI X DREJTORIA PËR GJEODEZI, KADASTËR DHE PRONË

Neni 27

1. Taksat e Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastrë dhe Pronë të përcaktuara sipas udhëzimeve Administrative, për Tarifat e Produkteve Kadastrale të Ofruara nga Zyrat Kadastrale Komunale dhe Tarifat për Shërbimet e Gjeodetëve dhe Kompanive Gjeodete të Licencuara.

Nr.	Kategoria	Taksa
NDËRRIMI I KULTURAVE TË PARCELAVE		
1	Përgatitja e raportit për ndërrimin e kulturës së një parcele pa matje gjeodezike	10 €
PUNËT E VEÇANTA GJEODEZIKE		
2	Bartja - piktimi në terren i të dhënave nga planet urbanistike për objekt individual	1.00 € për m ²
3	Bartja – piktimi në terren i të dhënave nga planet urbanistike për objekte banimi kolektiv apo afarist	1.50€ për m ²
4	Identifikimi i njësive kadastrale në zyrë	10 €
5	Identifikimi i njësive kadastrale në terren	30 €
6	Konsulta profesionale	10€ për një orë
DHËNIA E INFORMATAVE NGA SISTEMI I INFORMACIONEVE KADASTRALE TË TOKAVE TË KOSOVËS NGA ZKK		
7	Vërtetimet e ndryshme	3 €
8	Certifikata e pronësisë (deri në dhjetë faqe shënime të shtypura)	4 €
9	Certifikata e pronësisë (mbi dhjetë faqe shënime të shtypura)	20 €
10	Kopja e planit	4 €
11	Kopje në formatin A3 me ortofoto (bardhë e zi)	4 €
12	Kopje në formatin A3 me ortofoto (kolor)	5 €
13	Historiati për një njësi kadastrale	20 €
BAZAGJEODEZIKE		
14	Pikat trigonometrike: Koordinatat Y, X, H, me përshkrim	5 €
15	Pikat lidhëse: Koordinatat Y, X, H, me përshkrim	4 €
16	Pikat poligonale: Koordinatat Y, X, H, me përshkrim	3 €
17	Pikë e nivelimit: Koordinatat Y, X, H, me përshkrim	5 €
18	Pikat në linjë: Koordinatat Y, X, H	2 €
19	Pikat e detajit Y, X,	1 €
TË DHËNAT NË FORMËN DIGJITALE		
20	Parcela në format digjital (shpfile, dwg, gml, ili) deri në 1 ha-sipas kërkesës së palës (pronarit, të autorizuarit, gjeodeti i licencuar apo kompania gjeodete e licencuar)	10 €
21	Parcela në format digjital (shpfile, dwg, gml, ili) mbi 1 ha deri 2 ha- sipas kërkesës së palës (pronarit, të autorizuarit, gjeodeti i licencuar apo kompania gjeodete e licencuar)	20 €

22	Parcela në format digjital (shpfile, dwg, gml, ili) mbi 2 ha deri 5 ha- sipas kërkesës së palës (pronarit, të autorizuarit, gjeodeti i licencuar apo kompania gjeodete e licencuar)	40 €
23	Parcela në format digjital (shpfile, dwg, gml, ili) mbi 5 ha- (sipas kërkesës së palës, pronarit, të autorizuarit, gjeodeti i licencuar apo kompania gjeodete e licencuar)	60 €
24	5. Ndërtesa në format digjital (shpfile, dwg, gml, ili) sipas kërkesës së palës (pronarit, të autorizuarit, gjeodeti i licencuar apo kompania gjeodete e licencuar)	5 €
25	6. CD—kompakt disku	0.50 €
26	7. Kontrollimi dhe rregjistrimi në regjistër të të dhënave nga tereni – për njësi kadastrale	20€

2. Taksat për shërbimet pronësore sipas Udhëzimit Administrativ MMPH - Nr. 08/2014 për Tarifat e Shërbimeve për Regjistrimin e të Drejtave të Pronës së Paluajtshme nga Zyrat Kadastrale Komunale

Nr.	Shërbimi	Taksa
Regjistrimi i pronës, posedimit në bazë të transaksioneve (shitblerjes), përfshirë edhe dhurimin e pronës së paluajtshme ku dhuratëmarrësi nuk është anëtar i familjes apo pasardhës i dhuratëdhënësit		
1	Për vlerën e transaksionit deri në 10.000 €	20.00 €
2	Për vlerën e transaksionit prej 10.000 € e deri në 30.000 €	30.00 €
3	Për vlerën e transaksionit prej 30.000 € e deri në 50.000 €	35.00 €
4	Për vlerën e transaksionit prej 50.000 € e deri në 100.000 €	50.00 €
5	Për vlerën e transaksionit prej 100.000 € e deri në 150.000 €	80.00 €
6	Për vlerën e transaksionit prej 150.000 € e deri në 200.000 €	110.00 €
7	Për vlerën e transaksionit prej 200.000 € e deri në 250.000 €	140.00 €
8	Për vlerën e transaksionit prej 250.000 € e deri në 300.000 €	170.00 €
9	Për vlerën e transaksionit prej 300.000 € e deri në 350.000 €	200.00 €
10	Për vlerën e transaksionit prej 350.000 € e deri në 400.000 €	230.00 €
11	Për vlerën e transaksionit prej 400.000 € e deri në 450.000 €	260.00 €
12	Për vlerën e transaksionit prej 450.000 € e deri në 500.000 €	290.00 €
13	Për vlerën e transaksionit mbi 500.000 €	300.00 €
14	Për transaksionet e pa vlerësueshme tjera	70.00 €
15	Për transaksionet e pa vlerësueshme për dhurimin e pronës së paluajtshme ku dhuratëmarrësi nuk është anëtar i familjes apo pasardhës i dhuratëdhënësit	80.00 €
Regjistrimi i pronësisë, posedimit në bazë të dokumentit mbi dhuratën ku dhuratëmarrësi është anëtar i familjes ose pasardhësi i dhuratëdhënësit		
16	Për vlerën e transaksionit deri në 10.000 €	6.00 €
17	Për vlerën e transaksionit prej 10.000 € e deri në 30.000 €	9.00 €
18	Për vlerën e transaksionit prej 30.000 € e deri në 50.000 €	10.50 €
19	Për vlerën e transaksionit prej 50.000 € e deri në 100.000 €	15.00 €
20	Për vlerën e transaksionit prej 100.000 € e deri në 150.000 €	24.00 €
21	Për vlerën e transaksionit prej 150.000 € e deri në 200.000 €	33.00 €
22	Për vlerën e transaksionit prej 200.000 € e deri në 250.000 €	42.00 €
23	Për vlerën e transaksionit prej 250.000 € e deri në 300.000 €	51.00 €
24	Për vlerën e transaksionit prej 300.000 € e deri në 350.000 €	60.00 €

25	Për vlerën e transaksionit prej 350.000 € e deri në 400.000 €	69.00 €
26	Për vlerën e transaksionit prej 400.000 € e deri në 450.000 €	78.00 €
27	Për vlerën e transaksionit prej 450.000 € e deri në 500.000 €	90.00 €
28	Për vlerën e transaksionit mbi 500.000 €	87.00 €
29	Për transaksionet e pa vlerësueshme	50.00 €
Regjistrimi i pronësisë, posedimit në bazë të dokumentit të organeve administrative dhe gjyqësore mbi njohjen e të drejtës së pronësisë – posedimit		
30	Regjistrimi i të drejtave mbi pronën e paluajtshme e cila fitohet në bazë të Vendimit të organit administrativ apo gjyqësor	50.00 €
Regjistrimi i pronësisë, posedimit në bazë të pjesëtimit (ndarjes) të pronës në bashkëpronësi		
31	Regjistrimi i pronësisë, i posedimit në bashkëpronësi për aktin juridik me të cilin është vendosur bashkëpronësia	20.00 €
32	Regjistrimi i pronësisë, posedimit në bazë të pjesëtimit (ndarjes) të pronës në bashkëpronësi për secilin person që bëhet pronar – posedues.	20.00 €
33	Regjistrimi i pronës së përbashkët të bashkëshortëve për aktin juridik me të cilin është vendosur prona e përbashkët	20.00 €
34	Regjistrimi i pronësisë së përbashkët të ndërtesave në bashkëpronësi me të gjithë pronarët me pjesët e veçanta	100.00 €
Regjistrimi i pronësisë, posedimit, në bazë të trashëgimisë dhe të shkëputjes së bashkësisë familjare		
35	Regjistrimi i pronësisë, posedimit në bazë të trashëgimisë - për çdo trashëgimtar	10.00 €
36	Regjistrimi i pronësisë, posedimit në bazë të shkëputjes së bashkësisë familjare - për çdo anëtarë të familjes që bëhet pronar, posedues	10.00 €
Regjistrimi i pronësisë, posedimit, në bazë të ndërrimit të pronës së paluajtshme		
37	Regjistrimi i pronësisë, posedimit, në bazë të ndërrimit të pronës së paluajtshme - për secilin pronar – posedues.	20.00 €
Regjistrimi i hipotekave		
38	Kërkesë (kredia) në vlerë deri në 10000 €	10.00 €
39	Kërkesë (kredia) në vlerë prej 10000 € e deri në 30.000 €	20.00 €
40	Kërkesë (kredia) në vlerë prej 30.000 € e deri në 50.000 €	30.00 €
41	Kërkesë (kredia) në vlerë prej 50.000 € e deri në 100.000 €	80.00 €
42	Kërkesë (kredia) në vlerë prej 100.000 € e deri në 200.000 €	110.00 €
43	Kërkesë (kredia) në vlerë prej 200.000 € e deri në 300.000 €	140.00 €
44	Kërkesë (kredia) në vlerë prej 300.000 € e deri në 400.000 €	170.00 €
45	Kërkesë (kredia) në vlerë prej 400.000 € e deri në 500.000 €	200.00 €
46	Kërkesë (kredia) në vlerë prej 500.000 € e deri në 600.000 €	230.00 €
47	Kërkesë (kredia) në vlerë prej 600.000 € e deri në 700.000 €	260.00 €
48	Kërkesë (kredia) në vlerë prej 700.000 € e deri në 800.000 €	290.00 €
49	Kërkesë (kredia) në vlerë prej 800.000 € e deri në 900.000 €	320.00 €
50	Kërkesë (kredia) në vlerë prej 900.000 € e deri në 1000.000 €	350.00 €
51	Kërkesë (kredia) në vlerë prej 1000.000 € e deri në 1.100.000 €	380.00 €
52	Kërkesë (kredia) në vlerë prej mbi 1.100.000	400.00 €
Ndryshimi dhe fshirja e hipotekës		
53	Ndryshimi i hipotekës së regjistruar	30.00 €
54	Fshirja e hipotekës në regjistrin e të drejtave	10.00 €

Regjistrimi i servituteve		
55	Regjistrimi i servituteve në regjistrin e të drejtave mbi pronën e paluajtshme	50.00 €
56	Fshirjen e servitutit nga regjistri i të drejtave	20.00 €
Regjistrimi i të drejtës së shfrytëzimit		
57	Regjistrimi i drejtës së shfrytëzimit – qira mbajtje me kohë zgjatje prej 3 deri në 10 vite	50.00 €
58	Regjistrimi i drejtës së shfrytëzimit – qira mbajtje me kohë zgjatje prej 10 deri në 25 vite	150.00 €
59	Regjistrimi i drejtës së shfrytëzimit – qira mbajtje me kohë zgjatje prej 3 deri në 99 vite	500.00 €
60	Ndryshimi apo fshirja e regjistrimit të drejtës së shfrytëzimit – qira mbajtje me kohë zgjatje prej 3 deri në 10 vite	10.00 €
61	Ndryshimi apo fshirja e regjistrimit të drejtës së shfrytëzimit – qira mbajtje me kohë zgjatje prej 10 deri në 25 vite	30.00 €
62	Ndryshimi apo fshirja e regjistrimit të drejtës së shfrytëzimit – qira mbajtje me kohë zgjatje prej 3 deri në 99 vite	100.00 €
Regjistrimi i barërave dhe ngarkesave tjera		
63	Regjistrimi i barrës në tatimin mbi pronën e paluajtshme	20.00 €
64	Regjistrimi i barrës tatimore	30.00 €
65	Regjistrimi i masës së sigurisë (masa e përkohshme) që procedura gjyqësore ose një procedurë tjetër është udhëhequr më kërkesë private të palës	50.00 €
Korrigjimi i të Dhënave në regjistr		
66	Korrigjimi i të dhënave nëse të dhënat që duhet të korrigjohen janë futur në regjistr sipas dokumentacionit të dorëzuar nga pala	20.00 €
Regjistrimi i të drejtave tjera		
67	Regjistrimi i të drejtave, ngarkesave, barrës pronësore të tjera mbi pronën e paluajtshme	40.00 €

KAPITULLI XI DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE

Neni 28

Taksa komunale për ndërhyrje në infrastrukturën komunale

1. Çdo person që ndërhyr në infrastrukturën komunale sipas veprimeve të përcaktuara në këtë nen obligohet ta kthejë atë infrastrukturë në gjendjen të mëparshëm dhe paguajë taksë si në vijim:

Nr.	Emërtimi	Ekzist	Prop Kuvend
1	Groposja për kyçe në rrjetin e kanalizimit, të ujësjellësit dhe çdo rrjet tjetër nëntokësor në rrugë të asfaltuar prej 0-10 m ²	90€	
2	Groposja për kyçe në rrjetin e kanalizimit, të ujësjellësit dhe çdo rrjet tjetër nëntokësor në rrugë të asfaltuar prej 10-20 m ²	70	
3	Groposja për kyçe në rrjetin e kanalizimit, të ujësjellësit dhe çdo rrjet tjetër nëntokësor në rrugë të asfaltuar prej 20-50 m ²	60	
4	Groposja për kyçe në rrjetin e kanalizimit, të ujësjellësit dhe çdo rrjet tjetër nëntokësor në rrugë të asfaltuar mbi 50 m ²	50	

5	Groposja për kyçje në rrjetin e kanalizimit, të ujësjellësit dhe çdo rrjet tjetër nëntokësor në rrugë të kubëzuar prej 0-10 m ²	40	
6	Groposja për kyçje në rrjetin e kanalizimit, të ujësjellësit dhe çdo rrjet tjetër nëntokësor në rrugë të kubëzuar prej 10-50 m ²	60	
7	Groposja për kyçje në rrjetin e kanalizimit, të ujësjellësit dhe çdo rrjet tjetër nëntokësor në rrugë të kubëzuar mbi 50 m ²	100	
8	Groposja për kyçje në rrjetin e kanalizimit, të ujësjellësit dhe çdo rrjet tjetër nëntokësor në rrugë të pa asfaltuar apo pa kubëzuar me zhavor makadam deri 50 m ²	3	
9	Groposja për kyçje në rrjetin e kanalizimit, të ujësjellësit dhe çdo rrjet tjetër nëntokësor në rrugë të pa asfaltuar apo pa kubëzuar me zhavor makadam mbi 50 m ²	3	
10	Groposja (shpuarje) e rrugës, trotuareve etj.	5	

2. Taksa sipas paragrafit 1 të këtij neni paguhet para ndërhyrjes në infrastrukturën komunale.

3. Leje pune për auto-taxi, leje pune për kombibus-taxi dhe vërtetimi i orarit të udhëtimeve për autobus dhe minibusë paguajnë taksë si në vijim:

Nr.	Emertimi	Ekzist	Prop Kuvend
1	Leje pune për auto-taxi tarifa – vjetore	35€	
2	Vazhdimi i lejes për auto-taxi, tarifa vjetore	30€	
3	Leje pune për kombibus-taxi, tarifa vjetore	50€	
4	Vazhdimi i lejes për kombibus-taxi, tarifa vjetore	45€	
5	Leje pune dhe vërtetimi i rendit të udhëtimeve për autobusa dhe minibus vajtje ardhje, tarifa vjetore	1€	

Neni 29

Taksa mbi vendosjen e panove reklamuese

1. Çdo shoqëri tregtare që ekspozon pano reklamuese mbi 2 m² në pronën e tij private apo të marrë në shfrytëzim apo me qira, paguan taksë vjetore, si në vijim:

Nr.	Emertimi	Ekzist	Prop Drejtori - Kuvend
1	Për panot reklamuese nga 0 – 4 m ²	150€	
2	Për panot reklamuese nga 4 – 6 m ²	75€	
3	Për panot reklamuese nga 6 – 8 m ²		80€
4	Për panot reklamuese nga 8 – 10 m ²		100€
5	Për panot reklamuese nga 10 – 15 m ²		150€
6	Për panot mbi 15 m ² (pesëmbëdhjetë metër në katror)		200€

2. Çdo shoqëri tregtare që ekspozon pano reklamuese në hapësirën publike, paguan si në vijim:

Nr.	Emertimi	Ekzist	Prop Drej- Kuvend
1	Për panot reklama (Lampost) të vendosura nëpër shtyllat e ndriçimit publik deri në 1m ² – Taksë Mujore		2€/cop
2	Për panot reklama të ndryshme afariste në hapësirën tokësore me sipërfaqe deri në 4 m ² - Taksë Mujore	150€	

3	Për panot reklama të ndryshme afariste (Bilborda dhe Citylight) në hapësirën tokësore me sipërfaqe më të madhe se 4m ² - Taksë Mujore	150€	
4	Për panot reklama të ndryshme afariste (Bilborda dhe Citylight) në hapësirën tokësore me sipërfaqe deri në 2 m ² dhe më të vogël se (12.m ²) - Taksa Vjetore	75€/cop	
5	Vendosja e transparentëve reklamuese për m ² - Taksë Mujore	15€	
6	Vendosja e shpalljeve dhe publikimeve të përkohshme, në muret dhe objektet tjera - Taksa Vjetore (Propozim i drejtorise)	25€	

3. Llogaritja e taksës sipas paragrafit 2 të këtij neni bëhet duke shumëzuar totalin e madhësisë së panos reklamuese me taksën komunale mujore.

4. Çdo shoqëri tregtare obligohet që të njoftojë Komunën për vendosjen një panoje sipas dispozitave të këtij neni, përveç atyre të paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, brenda 60 (gjashtëdhjetë) dite nga data e vendosjes, duke specifikuar llojin dhe madhësinë e panos së vendosur.

5. Pagesa e taksës komunale për vendosjen e panove sipas këtij neni bëhet si në vijim:

5.1. Për panot e vendosura sipas paragrafit 1 të këtij neni, pagesa vjetore bëhet deri më datën tridhjetë (30) shtator të vitit aktual; dhe

5.2. Për panot e vendosura sipas paragrafit 2 të këtij neni, pagesa bëhet para datës së vendosjes së panos.

Neni 30

Taksa komunale mbi parkimin e automjeteve

1. Çdo person që shfrytëzon hapësirat komunale të destinuara për parkim të veturave, paguan taksë komunale sipas dispozitave të këtij neni.

2. Taksa komunale për parkimin e automjeteve paguhet si taksë mujore ose si taksë për shfrytëzimin e përkohshëm me orë qëndrimi të veturës.

3. Taksa komunale mujore për parkimin e automjeteve është si në vijim:

Nr.	Emertimi	Ekzist	Prop Dejt-Kuvend
1	Për personat juridik në Zonën I	35€	
2	Për personat fizik në Zonën I		30€
3	Për personat juridik në Zonën II		25€
4	Për personat fizik në Zonën II		15€

4. Taksa komunale për parkim të përkohshëm për qëllim të ngarkimit apo shkarkimit të mallrave është 10€ (dhjetë) në muaj. (nuk ka ekzistuar);

5. Taksa komunale për shfrytëzimin e përkohshëm të parkingut komunal është si në vijim:

Nr.	Emertimi	Ekzist	Prop Drejt-Kuvend
1	Për personat juridik në Zonën I – Cmimi për orë		0.50€
2	Për personat fizik në Zonën I - Cmimi për orë		0.40€
3	Për personat juridik në Zonën II - Cmimi për orë		0.40€
4	Për personat fizik në Zonën II - Cmimi për orë		0.30€

6. Pagesa sipas paragrafit 3 dhe 4 të këtij neni bëhet në baza mujore apo në baza disamujore, pas marrjes së pëlqimit nga organi përkatës komunal. Pagesa sipas paragrafit 5 të këtij neni bëhet pas marrjes së shërbimit.

Neni 31

Taksa komunale për vendosjen e përkohshme të objekteve të ndryshme në hapësirat publike

1. Çdo person që vendos objekte të ndryshme në hapësirat publike, paguan taksë komunale si në vijim:

Nr.	Emertimi	Ekzist	Prop Drejt-Kuvend
1	Vendosja e kiosqeve (barakave) ose objekteve tjera montuese për veprimtari tregtare për rajonin e ngushtë të qytetit të Rahovecit - Taksa Vjetore	10€	
2	Vendosja e kiosqeve (barakave) ose objekteve tjera montuese për veprimtari tregtare jashtë rajonit të ngushtë të qytetit të Rahovecit - Taksa Vjetore	8€	
3	Vendosja e garazheve ose objekteve tjera me material të fortë, për veprimtari ekonomike - Taksa Vjetore	80€	
4	Vendosja e garazheve ose objekteve tjera montazhe-demontazhë, për veprimtari ekonomike - Taksa Vjetore	60€	
5	Vendosja e tavolinave për shërbim para objektit ku ushtrohet veprimtaria ekonomike në sipërfaqen e hapur publike deri (20m ²), në të cilën nuk pengohet lëvizja e lirë e këmbësorëve për shfrytëzim së paku per 3 (tre) muaj - Taksa Mujore	2.50€	
6	Vendosja e tavolinave për shërbim para objektit ku ushtrohet veprimtaria ekonomike në sipërfaqen e hapur publike mbi (20/m ²), në të cilën nuk pengohet lëvizja e lirë e këmbësorëve për shfrytëzim së paku per 3 (tre) muaj - Taksa Mujore	2€	
7	Vendosja e mallrave për ekspozim para hapësirës ku ushtrohet veprimtaria ekonomike në sipërfaqen e hapur publike në të cilën nuk pengohet lëvizja e lirë e këmbësorëve për shfrytëzim së paku për 3 (tre) muaj - Taksa Mujore (Ndalohej ekspozimi i mallrave ushqimore)	2€/m ²	
8	Vendosja e standeve të hapura lëvizëse promovuese për veprimtari ekonomike në zonat e banimit - Taksa Ditore	5€/m ²	
9	Vendosja e standeve të hapura lëvizëse promovuese për veprimtari ekonomike jashtë zonave të banimit - Taksa Ditore	0.50€/m ²	
10	Vendosja e pajisjeve për akullore, pomfrit dhe të ngjashme për veprimtari tregtare - Taksa Ditore	0.10€/m ²	
11	Vendosja e automjetit lëvizës (dyqani mobil) për shitjen e ushqimit të shpejtë etj. - Taksa Ditore	0.10€/m ²	
12	Vendosja e tendave (çadrave) të hapura lëvizëse me mekanizëm - Taksa Mujore	8€/m ²	
13	Vendosja e tezgave para lokalit apo dyqanit - Taksa Ditore	0.10€/m ²	
14	Vendosjen e lojërave të fëmijëve Luna park etj. - Taksa Ditore	0.20€/m ²	
15	Vendosja e gjeneratorëve statik - Taksa Mujore	2.50€/m ²	
16	Vendosja e veturave për qëllime komerciale - Taksa Mujore	20€	
17	Vendosja e lojërave argëtuese - Taksa Mujore	20€	
18	Vendosja e kablllove të ndryshme në hapësirë për qëllime komerciale private – si pagesë e njëhershme	100€	

19	Vendosja e kabllave të ndryshme nën tokë për qëllime komerciale private – si pagesë e njëhershme	300€	
20	Shfrytëzimi i asetëve komunale nëntoksore (gypave për vendosjen e kabllave) - Taksa Vjetore	0.20€/m ²	
21	Vendosja e ormanëve (kutija, trafo, njësor –MDF)apo pajisjeve tjera shpërndarës - Taksa Vjetore	150€/m ²	
22	Vendosja e foltoreve telefonike - Taksa Vjetore	250€	
23	Vendosja e antenave PTK, IPKO, Kujtesa, RTK, KTV, RTV 21 etj, telekomunikuese - Taksa Vjetore për antenë	1000€	
24	Shfrytëzuesit e antenave PTK, IPKO, Kujtesa, RTK, KTV, RTV 21 në hapësirën publike mbi 100 m2 (pranë vendit ku vendosen antena) - Taksa Vjetore	0.10€/m ²	
25	Vendosja e bankomatëve nga institucionet financiare - Taksa Vjetore	250€	

2. Nëse toka komunale shfrytëzohet për vendosjen e objekteve të përkohshme në sipërfaqe deri në 15 m², qiraja mujore për tokë do të jetë 30€, kurse mbi 15 m² për çdo m² paguhet nga 1€ (është bartur nga Drejtoria për Ekonomi).

Neni 32

Taksa komunale për bllokimin e rrugëve sekondare

1. Çdo person i cili pas marrjes së lejes përkatëse bën bllokimin e rrugëve sekondare të Komunës, paguan taksat si në vijim:

Nr.	Kategoria	Taksa
1	Bllokimi i rrugës sekondare nga personat fizik deri në 6 orë	5 €
2	Bllokimi i rrugës sekondare nga personat fizik nga 6 deri 12 orë	10 €
3	Bllokimi i rrugës sekondare nga personat fizik nga 12 deri 24 orë	20 €
4	Bllokimi i rrugës sekondare nga personat fizik mbi 24 orë – për çdo ditë	20 €
5	Bllokimi i rrugës sekondare nga personat juridik deri në 6 orë	15 €
6	Bllokimi i rrugës sekondare nga personat juridik nga 6 deri 12 orë	30 €
7	Bllokimi i rrugës sekondare nga personat juridik nga 12 deri 24 orë	50 €
8	Bllokimi i rrugës sekondare nga personat juridik mbi 24 orë - për çdo ditë	50 €
9	Bllokimi i pjesshëm i rrugëve sekondare për qëllime të ndërtimit – në ditë	10 €

2. Pagesa e taksës sipas paragrafit 1 të këtij neni paguhet para bllokimit të rrugës sekondare.

Neni 33

Taksa komunale për shfrytëzimin afatgjatë dhe afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale

Të gjithë personat që marrin në shfrytëzim pronën komunal ë përputhje me dispozitat ligjore në fuqi për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, varësisht nga lloji i pronës së paluajtshme dhe klasifikimi, paguajnë taksën komunale mujor apo vjetore të shfrytëzimit, sipas kontratës përkatëse të shfrytëzimit të pronës së paluajtshme komunale.

KAPITULLI XII DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL

Neni 34

Taksa komunale për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore

1. Çdo person që kërkon të bëjë ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, paguan taksë komunale si në vijim:

Nr	Emërtimi	Ekzistues
1	Për tokat bujqësore të klasës 1 deri 4	1€/m ²
2	Për tokat bujqësore të klasës 5 deri 6	0.75€/m ²
3	Për tokat bujqësore të klasës 7 deri 8	0.50€/m ²

2. Për ndërrimin e përkohshëm të tokës bujqësore, personat paguajnë vetëm 20% (njëzetë për qind) të vlerës së paraparë në paragrafin 1 të këtij neni.

3. Taksa e paraparë në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni paguhet para ndërrimit të destinimit të tokës bujqësore dhe ky ndërrim nuk mund të realizohet pa e paguar këtë taksë.

4. Taksa komunale në Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural janë:

Nr.	Emërtimi	Ekzist
1	Vlerësim i dëmeve në bujqësi nga komisioni	10,00 €
2	Dhënia e pëlqimit për shfrytëzimin e tokave pyjore për qëllime bujqësore	25,00 €
3	Dhënia e vërtetimit për shitjen e prodhimeve bujqësore vetanake	2,00 €
4	Vërtetimi për dëshmi që është prodhues bujqësor	2,00 €
5	Parashtrimi i ankesave nga palët	2,00 €
6	Lëshimi i Certifikatës së Regjistrimit të Fermerit (NIF)	1,00 €

5. Taksa për dhënien e tokës komunale me qira për qëllime bujqësore është si vijon:

Nr	Emërtimi	Vlera pa ujitje	Vlera me ujitje
1	Kategoria e tokës / Klasa I-II	Ekzistuese 3.5 €/ari - / propozim 2.0€	Ekzistuese 5.0 €/ari- / propozim 3.0€
2	Kategoria e tokës / Klasa III-IV	Ekzistuese 3.0 €/ari - / propozim 2.0€	Ekzistuese 4.0 €/ari - / propozim 2.5€
3	Kategoria e tokës / Klasa V-VI	Ekzistuese 2.0 €/ari - / propozim 1.0€	Ekzistuese 3.0 €/ari - / propozim 1.0€
4	Kategoria e tokës / Klasa VII-VII	Ekzistuese 1.0 €/ari - / propozim 0.5€	Ekzistuese 2.0 €/ari - / propozim 1.0€

Është rënë dakord që të mbetet Taksa e propozuar nga Drejtoria

Neni 35

Taksa komunale për shfrytëzimin afatgjatë dhe afatshkurter të pronës së paluajtshme komunale

Të gjithë personat që marrin në shfrytëzim pronën komunale në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, varësisht nga lloji i pronës së paluajtshme dhe klasifikimi, paguajnë taksën komunale mujor apo vjetore të shfrytëzimit, sipas kontratës përkatëse të shfrytëzimit të pronës së paluajtshme komunale.

KAPITULLI XIII DREJTORIA PËR INSPEKTIM

Neni 36 Taksat komunale të Drejtorisë për Inspektim

1. Taksat komunale të drejtorisë për Inspektim në Komunën e Rahovecit janë si vijon:

Nr.	Kategoria	Ekzistuse
1	Inspektime të ndryshme me kërkesë të personave fizik	10 €
2	Inspektime të ndryshme me kërkesë të personave juridik	20 €
3	Kërkesa për pëlqim pune	15 €
4	Kërkesa për asgjësim mallërash	15 €
5	Kërkesa për dalje në terren për PTK dhe KEDS	100 €
6	Kërkesa për dalje në terren për KRU Gjakova, Ambienti (Ekoregjioni), etj	50 €
7	Kontroll të therrjeve të gjedheve (inspektor veterinar) në therrtore të licencuara nga AUV për krerë	5 €
8	Lëshimi i pëlqimeve dhe dokumenteve tjera në fushën e higjienës dhe sanitarisë	15€
9	Lëshimi i pëlqimeve dhe dokumenteve tjera në fushën emergjencës (është bartur nga Drejtoria e Administratës)	15€

Neni 37 Taksa komunale për rrënimin e objekteve pa leje

- Për çdo ndërtim pa leje i cili duhet të rrënohet sipas legjislacionit në fuqi, pronari i objektit paguan taksë komunale për rrënim 2€/m² (dy euro per meter katror).
- Taksa e paraparë në paragrafin 1 të këtij neni paguhet më së largu 3 (tre) ditë para datës së përfundimit të rrënit.

KAPITULLI XIV DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Neni 38 Taksat Komunale në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport

- Taksat komunale për shfrytëzimin e sallave, stadioneve (terreneve sportive), teknikës, biletat dhe antarësimi në bibliotekë janë si vijon:

Nr.	Kategoria	Ekzistuse	Prop Drejtori Kuvend
1	Dhënia në shfrytëzim të sallës së madhe në Shtëpinë e Kulturës	50€	
2	Dhënia në shfrytëzim të hapësirës së galerisë	20€	
3	Shfrytëzimi i sistemit të zërimit jashtë objektit	50€	
4	Shfrytëzimi i sallës së madhe për shfaqjet e ndryshme me pagesë	20% e biletave	

5	Shfrytëzimi i terreneve sportive per klubet jashtë komunës pagesa	50% e biletave	30% e biletave
6	Dhënia e skenës mobile për 1 ditë	300€	200€
7	Anëtarësimi në bibliotekë për leximin e librave për 1 vit	1€	
8	Subjektet politike	Të lira	50€

2. Hapësira sportive mund të shfrytëzohet pa pagesë nga klubet jashtë komunës së Rahovecit për stërvitje deri në 2 (dy) orë.
3. Lirohen nga pagesa e taksave komunale të cekura në paragrafi 1 të këtij neni këto subjekte si në vijim:
 - 3.1. Tubimet me karakter përkujtimore publik;
 - 3.2. Tubimet e organizuara nga Komuna e Rahovecit;
 - 3.3. Aktivitetet e drejtorisë për DKRS;
 - 3.4. Shoqatat e personave me aftësi të kufizuara (pika 1, 2 dhe 7);
 - 3.5. Shoqata e të burgosurve politik (pika 1, 2 dhe 3);
 - 3.6. Personat shfrytëzues të skemes sociale (pika 7);
 - 3.7. Organizatat/Shoqatat e dala nga Lufta;
 - 3.8. Organizatat Joqeveritare me karakter kulturor, rinor, sportiv, edukativo-arsimor dhe fetar;

KAPITULLI IX GJOBAT LIDHUR ME TAKSAT KOMUNALE

Neni 39

Gjobat lidhur me mps paraqitjen e lindjes dhe vdekjes

1. Çdo preson fizik përgjegjës i cili nuk paraqet lindjen e fëmijës në territorin e Komunës në afatin prej 30 (tridhjetë) ditësh nga data e lindjes kryen kundërvajtje të lehtë dhe nga Komuna i shqiptohet gjobë në vlerë prej 50€ (pesëdhjetë euro).
2. Çdo person fizik përgjegjës i cili nuk e lajmëron vdekjen personit të regjistruar me vendbanim në Komunë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e vdekjes së personit brenda Republikës së Kosovës, apo brenda 60 (gjashtë) ditëve për vdekjet e ndodhura jashtë Republikës së Kosovës, kryen kundërvajtje të lehtë dhe nga Komuna i shqiptohet gjobë në vlerë prej 80€ (tetëdhjetë euro).
3. Çdo drejtues i spitalit, burgu, institucionit të riedukimit dhe institucioneve tjera përkatëse, i cili nuk e lajmëron vdekjen e personit të regjistruar me vendbanim në Komunë brenda 5 (pesë) ditëve nga data e vdekjes së ndodhur në institucionet e tyre, kryen kundërvajtje të lehtë dhe Komuna i shqipton gjobë prej 70€ (shtatëdhjetë euro).

Neni 40

Gjobat lidhur me vendbanimin dhe vendqëndrimin

1. Çdo person fizik që ka vendbanim apo vendqëndrim në Komunë dhe i cili nuk i ndërmarr verimet e paraparë në këtë paragraf, kryen kundërvajtje të lehtë dhe Komuna i shqipton gjobë në vlerë prej 80€ (tetëdhjetë euro):
 - 5.1. nuk e lajmëron ndryshimin vendbanimin dhe vendqëndrimin brenda territorit të komunës, brenda 8 (tetë) ditëve nga ky ndryshim;

5.2. nuk e lajmëron largimin nga Republika Kosova, me qëllim të qëndrimit për më shumë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë; dhe

5.3. nuk e lajmëron kthimin në Republikën e Kosovë, me qëllim të qëndrimit për më shumë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë.

Neni 41

Gjobat lidhur me mos pagesën e taksës për ushtrimin e veprimtarisë afariste

1. Çdo shoqëri tregtare që vepron si biznes individual, i cili nuk e paguan taksën vjetore në emër të ushtrimit të veprimtarisë afariste brenda afatit të përcaktuar me këtë Rregullore, kryen kundërvajtje të lehtë dhe Komuna i shqipton gjobë në vlerë prej 50€ (pesëdhjetë euro).

2. Çdo shoqëri tregtare që nuk vepron si biznes individual, i cili nuk e paguan taksën vjetore në emër të ushtrimit të veprimtarisë afariste përcaktuar me këtë Rregullore, kryen kundërvajtje të lehtë dhe Komuna i shqipton gjobë në vlerë prej 100 € (njëqind euro).

Neni 42

Gjobat lidhur mos pagesën e taksës komunale mbi mjetet motorike

1. Çdo person fizik i cili nuk e paguan taksën komunale për mjetin motorik brenda afatit të përcaktuar në këtë Rregullohet, kryen kundërvajtje të lehtë dhe Komuna i shqipton gjobë në vlerë prej 20€ (njëzet euro).

2. Çdo shoqëri tregtare që vepron si biznes individual, e cila nuk e paguan taksën vetore për mjetin motorik brenda afatit të përcaktuar në këtë Rregullohet, kryen kundërvajtje të lehtë dhe Komuna i shqipton gjobë në vlerë prej 40€ (dyzet euro).

3. Çdo shoqëri tregtare apo person tjetër juridik i cili nuk vepron si biznes individual, që nuk e paguan taksën vjetore për mjetin motorik brenda afatit të përcaktuar në këtë Rregullohet, kryen kundërvajtje të lehtë dhe Komuna i shqipton gjobë në vlerë prej 100€ (njëqind euro).

Neni 43

Gjobat për mos pagesën e taksës komunale për ndërhyrje në infrastrukturë komunale dhe taksës komunale për rrënim të objekteve pa leje

1. Çdo person i cili nuk e paguan taksën komunale për ndërhyrje në infrastrukturë komunale dhe taksës komunale për rrënim të objekteve pa leje sipas afatit të përcaktuar në këtë Rregullore, kryen kundërvajtje të lehtë dhe Komuna i shqipton gjobë si në vijim:

1.1. për personin fizik – 100€ (njëqind euro);

1.2. për personi fizik që ushtron biznes individual – 200€ (dyqind euro); dhe

1.3. për personin juridik – 300€ (treqind euro).

Neni 44

Gjobat lidhur me mos pagesën e taksës komunale për vendosjen e panove reklamuese

1. Çdo shoqëri i cili nuk paguan takës komunale mbi vendosjen e panove reklamuese e cila kalon vlerën prej 100€ (njëqind euro) sipas afateve të përcaktuar nga kjo Rregullore kryen kundërvajtje të lehtë dhe Komuna i shqipton gjobë si në vijim:

1.1. Shoqëritë tregtare të regjistruara si biznes individual – 50€ (pesëdhjetë euro); dhe

1.2. Shoqëritë tregtare tjera – 100€ (njëqind euro).

Neni 45

Gjjobat lidhur me taksat komunale për vendosjen e objekteve të në hapësirat publike

1. Çdo person i cili nuk e paguan taksën komunale për vendosjen e objekteve të ndryshme në hapësirën publike sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje, e cila kalon vlerën mbi 100€ (njëqind euro), kryen kundërvajtje të lehtë dhe Komuna i shqipton gjobë si në vijim:
 - 1.1. Individët dhe shoqëritë tregtare të regjistruara si biznes individual – 50€ (pesëdhjetë euro); dhe
 - 1.2. Shoqëritë tregtare tjera – 100€ (njëqind euro).

Neni 46

Gjjobat për mos pagesë taksës komunale për bllokimin e rrugëve sekondare

1. Çdo person i cili nuk e paguan taksën komunale për bllokimin e rrugëve sekondare sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje kryen kundërvajtje të lehtë dhe Komuna i shqipton gjobë si në vijim:
 - 1.1. Personat fizik dhe shoqëritë tregtare të regjistruara si biznes individual – 30€ (tridhjetë euro); dhe
 - 1.2. Personat juridik – 100€ (njëqind euro).

Neni 47

Pagesat e gjjobave dhe çështjet tjera mandatorë

1. Gjjobat të përcaktuara me këtë Rregullore paguhën brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga datat e shqiptimit të tyre, por jo më vonë se 90 (nëntëdhjetë) ditë nga data e shqiptimit të tyre.
2. Në rast të pagimit të gjobës së shqiptuar me këtë Rregullore brenda afatit 30 (tridhjetë) ditësh, i dënuari lirohet nga pagimi i 50% (pesëdhjetë përqind) të shumës së gjobës së shqiptuar.
3. Presoni ndaj të cilit shqiptohet gjobë sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje ka të drejtën e ankesës, sipas afateve dhe procedurave të parapara në legjislacionin në fuqi për procedurën e përgjithshme administrative.
4. Procedurat kundërvajtëse zhvillohen nga Komuna në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet.

KAPITULLI X

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 48

Taksat Qendrore

1. Me qëllim të zbatimit të legjislacionit në fuqi të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, Komuna ofron shërbime të ndryshme të deleguar nga niveli qendror dhe mbledh taksë të përcaktuar nga ky nivel, si në vijim:
 - 1.1. Taksa për ofrimin e shërbimeve kadastrale të përcaktuara sipas Udhëzimit Administrativ MMPH Nr.XX/2019 (numri i saktë shënohet pas miratimit të këtij akti) për Tarifatat e Produkteve Kadastrale të Ofruara nga Zyrtat Kadastrale Komunale dhe Tarifatat për Shërbimet e Gjeodetëve dhe Kompanive Gjeodete të Licencuara (është në proces të konsultimit), apo çdo legjislacioni pasues;

- 1.2. Taksa për ofrimin e shërbimeve kadastrale të përcaktuara sipas Udhëzimit Administrativ MMPH - Nr. 08/2014 për Tarifatat e Shërbimeve për Regjistrimin e të Drejtave të Pronës së Paluajtshme nga Zyrtarë Kadastrale Komunalet;
 - 1.3. Taksa për dhënie të lejeve mjedisore të përcaktuara sipas Udhëzimit Administrativ MMPH - Nr. 01/2017 për Dhënie të Lejeve Komunalet Mjedisore, apo çdo legjislacioni pasues;
 - 1.4. Taksa për shërbimet shëndetësore të përcaktuara sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 04/2007 – Mbledhja dhe Shfrytëzimi i Mjeteve nga Bashkë Pagesat e Shfrytëzuesve të Shërbimeve Shëndetësore dhe të Hyrave Vetanake të Institucioneve Shëndetësore apo çdo legjislacioni pasues;
 - 1.5. Taksa për qasje në dokumente publike të përcaktuara sipas Rregullores Nr. 02/2012/MF për Tarifatat në Qasje në Dokumente Publike, apo çdo legjislacioni pasues;
 - 1.6. Taksa për vijim dhe përfundim të arsimit dhe aftësimit për të rritur të përcaktuara sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 11/2011 për Partecipim të Vjeshve të Arsimit dhe Aftësimit për të Rritur, apo çdo legjislacioni pasues;
 - 1.7. Taksa për shërbimet e ofruara për regjistrim të bizneseve, të përcaktuara sipas Udhëzimit Administrativ (MTI) Nr. 11/2018 për Përcaktimin e Taksave për Shërbimet e Ofruara nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve, apo çdo legjislacioni pasues;
 - 1.8. Taksa për lëshimin e dokumentacion arsimor duplikatë, të përcaktuar sipas Udhëzimit Administrativ 03/2013 – Lëshimi i Dokumenteve Duplikatë nga Institucionet Edukative – Arsimore dhe Universitare, apo çdo legjislacioni pasues; dhe
 - 1.9. Taksa për shfrytëzimin e kullosave të përcaktuar sipas Udhëzimit Administrativ MA-NR për Shfrytëzimin e Kullosave.
2. Çdo akt normativ tjetër i Qeverisë së Republikës së Kosovës apo ndonjë agjencie të pavarur që miratohet pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje që parashihet taksa qendrore, zbatohet nga Komuna, pa pasur nevojë që kjo Rregullore të ndryshojë.

Neni 49

Transparenca në taksat komunale

Kuvendi Komunal përditëson këtë Rregullore kurdo që Qeveria e Republikës së Kosovës apo ndonjë agjenci e pavarur ndryshon taksat ekzistuese qendrore apo përcakton ndonjë taksë tjetër.

Neni 50

Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Rregullorja Nr. 576 e datës 28.02.2017 për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale.

Neni 51

Publikimi

Kjo Rregullore publikohet në ueb faqen elektronike të Komunës dhe të Gazetës Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Neni 52

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më _____.

UDHËZUES SHPJEGUES PËR MODEL RREGULLOREN PËR TAKSA KOMUNALE

1. Hyrje

Model Rregullorja për Taksat Komunale e hartuar nga Asociacioni i Komunave të Kosovës ka për qëllim që të krijojë një model të përafërt për Komunitetet e Republikës së Kosovës, për trajtimin e taksave komunale. Nëpërmjet kësaj *Model Rregulloreje*, synohet të sigurohet një qasje më të harmonizuar për Komunitetet në përcaktimin e këtyre taksave, duke rregulluar më qartë këto taksa, duke përcaktuar gjopa për mos pagesën e tasave komunale, duke rritur transparencën në unifikimin e të gjitha llojeve taksave që mbledhet nga komuna në një dokument të vetëm, si dhe duke përmirësuar cilësinë e draftimit të këtyre Rregulloreve, në përputhshmëri me legjislacionin në fuqi dhe standardin përkatës të hartimit të akteve normative. Në anën tjetër, kjo *Model Rregullore* nëpërmjet një kornize të gjerë të krijuar dhe shpjegimeve të dhënë në këtë Udhëzues, e ka në konsideratë edhe ruajtjen e specifikave të Komunave të Republikës së Kosovës në trajtimin e taksave komunale.

Qëllimi i kësaj *Model Rregulloreje* nuk është vetëm t'i përmbledh taksat ekzistuese në një dokument të vetëm. Përtej kësaj, synimi është që të bëhet një filtrim ligjor sa i përket legjislacionit në fuqi dhe të ofrojë edhe perspektiva të reja për Komunitetet e Republikës së Kosovës për mundësinë e vënies së taksave të reja komunale, marrë legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës dhe përvojat më të mira ndërkombëtare.

Kjo *Model Rregullore* përbëhet gjithsej nga dhjetë kapituj. Në dy kapitujt e parë janë trajtuar dispozitat e natyrës së përgjithshme lidhur me taksat. Në gjashtë kapitujt vijues janë përcaktuar taksat komunale, sipas kategorizimit të bazuar kryesisht në Ligjin Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L-108 (këtu e tutje: LFPL) marrë parasysh edhe ndryshimet e fundit që kanë ndodhur në legjislacionin në fuqi që nga miratimi i këtij Ligji. Në kapitullin e nëntë të kësaj Rregulloreje janë përcaktuar gjopat komunale, që shqiptohen për mos zbatimin e dispozitave të kësaj Rregulloreje. Kapitulli i fundit trajton dispozitat përfundimtare të kësaj Rregulloreje dhe transparencën për qytetarët lidhur me taksat komunale dhe taksat qendrore.

2. Metodologjia dhe terminologjia

Me qëllim të hartimit të kësaj *Model Rregulloreje*, janë analizuar Rregulloret komunale përkatëse për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjopa komunale, si dhe Rregulloret tjera komunale që janë ndërlidhur me këtë fushë. Në anën tjetër, janë marrë konsideratë edhe ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi, për të siguruar harmonizimin e dispozitave të kësaj *Model Rregulloreje* me legjislacionin horizontal. Metodologjia e shkrimit ligjor të kësaj *Model Rregulloreje* është e bazuar në Rregulloren (MAPL) Nr. 01/2017 për Procedurat e Hartimit dhe Publikimit të Akteve Komunale. Si burim plotësues është marrë në konsideratë edhe Udhëzimi Administrativ Nr. 03/2013 për Standardet Hartimit të Akteve Normative të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ashtu siç parasheh edhe neni 11 të Rregullores Nr. 01/2017 të MAPL-së.

Sa i përket terminologjisë së shfrytëzuar nga Komunitetet e Republikës së Kosovës në titullin e këtyre Rregulloreve komunale, emërtimi i këtyre akteve normative kryesisht është titulluar si "*Rregullore për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjopa Komunale*". Në zbatim të këtyre nocioneve, vërejmë se termi "**taksë**", si term ligjor dhe akademik, kryesisht është sinonim i termit tatim. Tatimi, në kuptimin e saj ekonomik i cili është reflektuar edhe në legjislacionin tonë në fuqi, është një kontribut i detyrueshëm dhe i pakthyeshëm që i paguhet arkës së shtetit nga të ardhurat, nga posedimi i pronës

së paluajtshme apo ndonjë kategori tjetër ligjore; ose i vënë si kosto shtesë në mallra, shërbime dhe transaksione. Një përkufizim të përafërt njihet edhe LFPL në definimin e termit taksë. Në anën tjetër, termi **“tarifë”** në literaturën ekonomike si dhe në dokumentet ndërkombëtare më shumë shfrytëzohet për të definuar një pagesë e vënë për të mirat apo shërbimet në rast të importimit nga një shtet tjetër, nga autoritetet doganore, në rast të kalimit të kufirit. Kjo është e reflektuar në shumë dokumente ndërkombëtare si Marrëveshje e Përgjithshme mbi Tarifa dhe Tregti, Traktati e Lisbonës, si dhe në Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit të nënshkruar në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian. Në kontekstin e legjislacionit tonë, një përkufizim të tillë njihet edhe Kodi Doganor dhe i Akcizave të Republikës së Kosovës, por ka edhe raste të përdorimit të këtij termi nëpër akte nënligjore, në kuptim të lartësisë së një obligimi. Në anën tjetër, ndër rastet e rralla kur ky term përdoret si tarifë komunale është shembulli i Republikës Jugafrikane, për të identifikuar disa tarifa komunale lidhur me pagesat e shërbimeve publike. Krahësa këtyre termeve, termi **“ngarkesë”**, si i tillë nuk është një term që përdoret në literaturën dhe kjo zakonisht përkthehet edhe si tatim apo taksë. Por, në fjalorin e gjuhës shqipe ka një kuptim të gjerë dhe nuk është një ters që ka një trajtim të veçantë ekonomik. Si rrjedhojë, marrë parasysh terminologjinë e përdorur edhe në dispozitat LFPP-së, termi më i përshtatshëm për titullimin e këtyre akteve normative do të ishte **“Rregullore për Taksat Komunale”**, ku do të rregulloheshin taksat komunale dhe gjërat lidhur me ato, titull i cili është adoptuar në këtë *Model Rregullore*.

Model Rregullorja është e ndarë dhe e sistematizuar në bazë të fushëveprimit të taksave komunale, që burojnë nga LFPL dhe legjislacioni tjetër në fuqi. Në praktikën e Komunave të Republikës së Kosovës, në hartimin e këtyre akteve normative, sistematizimi ka qenë zakonisht bazuar në drejtoritë përkatëse të komunave. Por, marrë parasysh dallimin në numrin dhe emërtimet e drejtorive nëpër Komunitet të Republikës së Kosovës si dhe mundësinë e ristrukturimit të komunave, hartimi i kësaj *Model Rregulloreje* në bazë të fushëveprimit të taksave është vlerësuar që ofron një zgjidhje më afatgjatë. Por, në përpunimin e mëtejshëm të kësaj *Model Rregulloreje*, Komunitet mund të përcaktojnë obligime për drejtoritë përkatëse në secilin nen apo kapitull.

3. Baza ligjore

Bazuar në Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (LVL), Kuvendet Komunale të Republikës së Kosovës kanë të drejtë të miratojnë akte të ndryshme, përfshirë këtu edhe rregullore komunale, brenda fushës së kompetencave të tyre, në përputhje me sistemin kushtetues dhe ligjor të Kosovës. Konform kësaj, bazuar në LFPL, Komunitet kanë në diskrecion të caktojnë taksat si në vijim:

- Taksë komunale për lejen për ushtrimin e veprimtarisë afariste për shoqëritë tregtare, varësisht nga specifikat e shoqërisë tregtare por gjithnjë në mënyrë proporcionale dhe jo diskriminuese;
- Taksë komunale për ushtrimin e shërbimeve profesionale nga shoqëritë tregtare që kërkojnë leje për këtë veprimtari, për profesionet si kontabilistë, avokatë, mjek, stomatolog dhe profesione të tjera;
- Taksë për automjetet për personat fizik që janë banorë të komunës dhe shoqëritë tregtare dhe ndërmarrjet tjera që janë të vendosura në selinë e komunës, e cila caktohet varësisht nga fuqia motorike e mjetit dhe/apo lloji i tij;
- Taksë administrative komunale për shërbimet që u ofrohen personave, përfshirë këtu edhe inspektimet e ndërtimeve, konform koston e ofrimit të shërbimeve;
- Taksat për lejet e ndërtimit dhe rrënimin të ndërtësive dhe strukturave tjera, bazuar në madhësinë e sipërfaqes;
- Taksë për parkimin e mjeteve në pronën komunale;
- Taksë për shfrytëzimin e pronës komunale për rekreacion;

- Taksë për gjueti apo peshkim brenda kufijve të komunës;
- Taksë për marketing ose ekspozita tjera në pronën komunale;
- Taksë për ceremonitë ose funksionet që ushtrojnë zyrtarët komunal;
- Taksa për lëshimin e certifikatave dhe dokumenteve zyrtare – për lëshimin e dokumenteve origjinale, kopjes së këtyre dokumenteve, marrë parasysh koston e shërbimit;
- Tarifa për infrastrukturën komunale, me qëllim të përmirësimit të infrastrukturës komunale; dhe
- Taksa tjera që përcaktohen me legjislacionin komunal.

Krahas LFPL, edhe Ligji Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe akti nënligjor që ka derivuar nga ky Ligj, ka specifikuar më tej taksat ndërtimore. Në anën tjetër, nga miratimi i FPL kanë kaluar mbi një dekadë dhe ndërkohë janë miratuar ligje tjera që rregullojnë çështje të ndryshme që ndërlidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me fushëveprimin e taksave komunale. Këto specifika, që janë marrë parasysh në hartimin e kësaj *Model Rregulloreje*, duhet të merren parasysh gjatë hartimit të Rregulloreve Komunale për Taksat Komunale, si në vijim:

- Sipas nenit 12 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, procedura administrative për palën është pa pagesë, përveç nëse është përcaktuar ndryshe me ligj. Edhe në rast të një përcaktimi të tillë, ajo nuk duhet të jetë më e lartë se kostoja mesatare e nevojshme për zhvillimin e asaj procedure administrative dhe organi publik duhet të ketë parasysh gjendjen ekonomike të palës për të bërë lirime;
- Sipas nenit 17 të Ligjit Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave, lejet dhe licencat mund të përcaktohen vetëm me ligj;
- Sipas dispozitave të Ligjit Nr. 05/L-087 për Kundërvajtje, Kuvendi Komunal mund të përcaktojë veprimet që janë kundërvajtje dhe të caktojë gjoba (sanksione kundërvajtëse) brenda kufijve të caktuar në këtë Ligj dhe zhvillon procedurën e kundërvajtjes; dhe
- Sipas nenit 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi çdo person është i mbrojtur nga diskriminimi, ndër tjerash, edhe në bazë të shtetësisë dhe parasheh që çdo person duhet të ketë trajtim të drejtë dhe të barabartë edhe para të gjitha organeve të tjera që administrojnë drejtësinë.

4. Lirimet nga taksa komunale

Gjatë hartimit të kësaj *Model Rregulloreje* janë shqyrtuar edhe kategoritë që duhet të jenë të lira nga këto taksa komunale. Legjislacioni në fuqi ka papërcaktuar lirime në pagesën e taksave, tatimeve dhe detyrimeve doganore për kategoritë e caktuara. Këto lirime nuk janë unike dhe pjesërisht janë të vlefshme për taksat komunale, si në vijim:

1. Ligji Nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të Tyre, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-172, përcakton që familjarët e dëshmorëve dhe të zhdukurve të UÇK janë të liruar nga taksat administrative (neni 8, paragrafi 1.8) dhe invalidët e luftës janë të liruar nga taksat administrative (neni 9, paragrafi 1.13);
2. Ligji Nr. 04/L-092 për Personat e Verbër, parasheh që kjo kategori janë të liruar nga çdo lloj takse të drejtpërdrejtë (neni 6); dhe
3. Ligji Nr. 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, parasheh që kjo kategori lirohen nga taksat për dokumentet personale dhe certifikatat të gjendjes civile (neni 10, paragrafi 3);

Krahas këtyre lirimeve që domosdo duhet të jenë pjesë e Rregulloreve për Taksa Komunale, komunat mund të parashohin edhe lirime të veçanta, varësisht nga lloji i taksës komunale për kategoritë e caktuar siç mund të jenë për veteranët e luftës, personat me aftësi të kufizuar, ish të

burgosurit dhe të përndjekurit politik, organizatat jo qeveritare, bashkësitë fetare, organizatat tjera të veçanta. Një qasje e tillë është reflektuar edhe në *Model Rregulloren*, ku varësisht nga lloji i takës komunale janë paraparë lirime të veçanta.

5. Taksat komunale për lëshimin e certifikatave dhe dokumenteve zyrtare

Këto taksa bazohen në nenin 16 të LFPL sipas të cilës Komunitat e Republikës së Kosovës kanë në diskrecion të vendosin takse për:

- a) certifikatave ose dokumenteve të tjerë si certifikata e lindjes, kurorëzimit, shkuroëzimit, gjendjes ekonomike, sociale dhe certifikata të ngjashme; dhe
- b) kopje të këtyre certifikatave dhe dokumenteve origjinalë, përfshirë edhe kopjet e dokumenteve zyrtare të cilat duhet të vihen në dispozicion të publikut sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës.

Bazuar në këtë dispozitë në njëërë anë, dhe legjislacionin në fuqi për gjendjen civile dhe praktikën e Komunave të Republikës së Kosovës në hartimin e Rregulloreve për Taksa, është vërejtur që Komunitat në Republikën e Kosovës lëshojnë dy lloje të këtyre dokumenteve:

- a) dokumente që Komunita ka evidenca të saktë dhe vërtetësia e së cilës mund të konstatohet nga regjistrat përkatëse të gjendjen civile; dhe
- b) dokumente që Komunita nuk ka evidencë të saktë dhe konfirmohet një raport shoqëror për nevojat e personave.

Për qëllim të *Model Rregullos* dokumentet e kategorisë së parë janë emërtuar si “certifikata” dhe ato të kategorisë së dytë si “vërtetime”. Po ashtu, për të pasur informata të sigurta për këto kategori, kjo *Model Rregullore* ka paraparë dispozita që kërkon prej personave përditësimin dhe dhënien e informatave me kohë për certifikatat, dhe dhënien e informatave të sakta për vërtetimet. Pra, sipas kësaj *Model Rregulloreje*, lëshimi i vërtetimeve duhet të bazojë këto dokumente në deklaratat dhe faktet e ofruara nga personat që e kërkojnë dokumentin, dhe Komunitat duhet të kenë përgjegjësi të kufizuar në lidhje me këtë.

Dokumentet e paraparë në këtë pjesë të Projekt Rregullos duhet të ofrohen pa bërë dallime në lartësinë e taksës bazuar në statusin e personit, shtetësinë e dytë apo në përkatësinë etnike. Po ashtu, ashtu siç kërkon edhe paragrafi 2 i nenit 16 të LFPL-së, kostoja e dhënies së këtyre dokumenteve nuk duhet të kalojë koston për sigurimin e atij dokumenti. Në anën tjetër, kopja e certifikatave dhe dokumenteve zyrtare të ofruara bazuar në nenin 16 të LFPL duhet të ketë një trajtim të veçantë, meqë kjo nuk konsiston në kërkesën për qasje në dokumente zyrtare, meqë këto konsiderohen si dokumente zyrtare personale dhe qasja në këto dokumente është e kufizuar vetëm në personin apo në autorizuarin e tij, për shkak të privatësisë së të dhënave.

Procedura e pajisjes dhe pagesat lidhur me pagesat e taksave për lëshimin e certifikatave dhe dokumenteve zyrtare nuk i krijon ndonjë raport kontraktuar që mund të parashihen edhe gjopa. Por, marrë parasysh legjislacionin në fuqi lidhur me lajmërimin e lindjeve, vdekjeve, ndryshime të vendbanimit dhe vendqëndrimit, në këtë *Model Rregullore* janë paraparë disa gjopa për këto shkelje.

6. Taksat Administrative Komunale

Neni 13 i LFPL-së ka paraparë mundësinë e përcaktimit të një takse administrative nga Komunitat e Republikës së Kosovës, lidhur me shërbimet që i ofrojnë Komunitat e Republikës së Kosovës personave përkatës. Kjo dispozitë ligjore kërkon që kjo takse të përcaktohet duke marrë parasysh koston për ofrimin e shërbimeve, bazuar në punën dhe materialet e shpenzuara. Edhe pse në praktikën e Komunave të Republikës së Kosovës kjo takse kryesisht është trajtuar në një grup me taksën për lëshimin e certifikatave dhe dokumenteve zyrtare, ajo ka natyrë tjetër, ashtu siç parashihet edhe paragrafi 3 i nenit 3 të LFPL-së. Për qëllim të kësaj *Model Rregulloreje*, trajtimi i kësaj takse është në bërë në një kapitull të veçantë.

Lidhur me përcaktimin këtyre taksave, përveç dispozitave të LFPL duhet të kihet parasysh edhe legjislacioni përkatës në fuqi që rregullon marrëdhëniet shoqërore në këtë fushë. Kështu, Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative ka paraparë që procedura administrative të jetë pa pagesë, përveç nëse është përcaktuar ndryshe me ligj. Në këtë kontekst, dispozitat e LFPL-së kanë bërë një përcaktim ndryshe, por ky përcaktim ndërlidhet vetëm me shërbimet e ofruara dhe synon të mbulojë vetëm koston e shkaktuar. Rrjedhimisht, nuk mund të vendoset një taksë e tillë për ankesat apo kërkesat e ushtruara, për pjesëmarrjen në procedurë rekrutimi apo për çdo procedurë ku nuk krijohet kosto administrative për Komunat, dhe duhet të përcaktohet vetëm për shërbimet e ofruara, në mënyrë proporcionale. Shembull i mirë për këtë taksë e reflektuar në shumë Rregullore në fuqi është taksa mbi inspektimet e realizuara me kërkesën e personave fizik apo juridik apo taksa për procedurën e kurorëzimit të realizuar jashtë orarit të punës apo jashtë objekteve komunale, meqë në këto raste shkaktohen shpenzime shtesë për administratën. Marrë parasysh këtë parim, kjo *Model Rregullore* nuk ka inkuadruar një sërë taksash të tilla të përcaktuara në Rregulloret e ndryshme të Komunave të Republikës së Kosovës.

Në përcaktimin e kësaj takse po ashtu duhet të merret parasysh edhe Ligji Nr. 06/L-010 për Noterinë, ligji i cili noterëve u ka përcaktuar disa kompetenca të cilat veç janë reflektuar në shumë Rregullore Komunale për Taksa, siç janë vërtetimi i nënshkrimit, vërtetimi i kopjeve të dokumenteve origjinal, vërtetimi i datës, vërtetimi që personi është i gjallë dhe të ngjashme. Marrë parasysh që akoma kemi Komuna ku mungon shërbimi noterial, kjo *Model Rregullore* ka paraparë taksa për shërbime të tilla. Megjithatë, komunat të cilat në territorin e tyre kanë shërbim noterial rekomandohet që të mos ofrojnë këtë shërbim dhe, rrjedhimisht, të mos caktojnë taksa në këtë drejtim.

Një Ligj tjetër që duhet të merret parasysh në përcaktimin e kësaj takse është edhe Ligji Nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i cili ndër tjerash ndalon edhe diskriminimin në bazë të shtetësisë. Andaj, të gjitha taksat duhet të jenë të njëjta dhe nuk duhet përcaktuar taksa më të larta shtetasve të huaj, përveç nëse ka ndonjë justifikim tjetër ligjor për këtë veprim.

Marrë parasysh natyrën e taksës komunale administrative, *Model Rregullorja* nuk ka paraparë ndonjë dispozitë ndëshkimore për këto taksa.

7. Taksa komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste

Neni 10 i LFPL ka njohur diskrecionin e Komunave të Republikës së Kosovës për të përcaktuar taksë vjetore komunale për marrjen dhe mbajtjen e lejes për shoqëritë tregtare, për ushtrimin e veprimtarisë afariste. Sipas kësaj dispozite Komunitet e Republikës së Kosovës duhet të caktojnë lartësi të ndryshme të taksave për veprimtaritë e ndryshme dhe nuk duhet të jetë diskriminuese bazuar në numrin e punëtorëve, vëllimin e veprimtarisë, përmasat e hapësirave, lokacionin dhe profitin të realizuar nga shoqëritë tregtare. Kjo taksë mund të caktohet në secilin lokacion ku ushtronet një veprimtari afariste si dhe mund të caktohet edhe çdo njësi e shoqërisë tregtare që ushtron veprimtari afariste. Një rregullim të ngjashëm LFPL njeh edhe për taksën për marrjen dhe mbajtjen e lejes për ushtrimin e shërbimeve profesionale.

Në anën tjetër, me miratimin e Ligjit Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave dhe Ligji Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare, fushëveprimi i dispozitave të LFPL-së duhet të kuptohen në frymën e këtij legjislacioni. Fillimisht, me Ligjin për Sistemin e Lejeve dhe Licencave është paraparë që lejet dhe licencat të mund të parashihi vetëm me ligj dhe, së fundi, Ligji për Shoqëritë Tregtare nuk ka paraparë sistem të lejeve për regjistrimin e shoqërive tregtar, që do të ngarkonte Komunitet e Republikës së Kosovës. Përfundimisht nga kjo bëjnë ligjet e veçanta që kanë paraparë licenca të veçanta, organe që bëjnë licencimin dhe mjetet ku derdhen ato mjete (shembull është licencimi i avokatëve bëhet nga Oda e Avokatëve të Kosovës dhe mjetet janë të hyrat e kësaj organizate). Andaj, neni 10 i LFPL-së duhet të kufizohet vetëm në taksën për ushtrimin e

veprimtarisë së tyre, duke konsideruar të mirëqenë lejen e tyre, marrë parasysh edhe që ARBK shoqëritë tregtare i regjistrojnë nëpërmjet Komunave të Republikës së Kosovës. Marrë parasysh këtë argumentim, në këtë *Model Rregullore* janë përcaktuar vetëm taksa për ushtrimin e veprimtarisë afariste, por jo edhe për ushtrimin e shërbimeve profesionale, meqë shërbimet profesional të përcaktuara në nenin 11 të LFPL-së kanë një taksë tjetër të licencimit të përcaktuar me legjislacionin përkatës në fuqi.

Marrë parasysh zhvillimet në vitet e fundit në politikat e avancimit të ambientit të të bërit biznes që është reflektuar edhe në legjislacionin në fuqi, kjo taksë ka filluar të konsiderohet si jo e përshtatshme. Me qëllim të ofrimit të një ambienti më të favorshëm për biznes, disa Komuna kanë larguar këtë taksë dhe një numër i madh i Komunave zbatojnë vetëm për një pjesë të biznesit. Njashtu, marrë parasysh edhe efektivitetin e regjimit tatimor të përcaktuar me legjislacionin në fuqi, rekomandohet fuqishëm mos cakimi i taksës komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste. Megjithatë, për Komunat që akoma e zbatojnë këtë lloj të taksës komunale, kjo *Model Rregullore* ka paraparë një kapitull.

Bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.11/2013 për Implementimin e Standardit për Klasifikimin e Veprimtarive Ekonomike në Versionin NAVE-rev.2, e cila në nenin 3, paragrafi 1, parasheh që të gjitha institucionet publike në Republikën e Kosovës që kanë të bëjnë me regjistrimin e subjekteve ekonomike apo formave të ndryshme të organizimit shoqëror për qëllime të klasifikimit në bazë të veprimtarive ekonomike do të përdorin standardet ndërkombëtare NACE - Rev. 2., kjo *Model Rregullore* ka bërë një klasifikim të tillë të subjekteve afariste. Nga gjithsej rreth 700 aktivitetet ekonomike të përcaktuar sipas standardit NACE, nëpërmjet regjistrimit të ARBK-së është konstatuar se në Republikën e Kosovës janë themeluar shoqëri tregtare që ushtrojnë 674 forma të veprimtarisë ekonomike, si veprimtari kryesore. Në këtë *Model Rregullore* janë reflektuar të gjitha këto aktivitetet dhe janë përcaktuar taksat përkatëse për ushtrimin e veprimtarisë afariste, përjashtuar aktivitetet e lojërave të fatit që janë ndaluar me Ligjin Nr. 06/L-155 për Ndalimin e Lojërave të Fatit. Në zbatimin e mëtejshëm të kësaj liste, Komunat mund të largojnë tërësisht këtë kapitull apo mund të kufizojnë veprimtaritë që dëshirojnë të taksojnë, sipas politikave të tyre.

Po ashtu, *Model Rregullorja* ka paraparë edhe një sistem dinamik të pagesave të taksës për ushtrimin e veprimtarisë afariste, kategoritë e liruara dhe gjobat për mos pagesën brenda afatit të kësaj takse.

8. Taksat komunale mbi Mjetet Motorike

Neni 12 i LFPL i jep kompetencë Komunave të Republikës së Kosovës që të përcaktojnë një taksë vjetore për pronësinë e automjetit të vetëm personave fizik që janë banorët e Komunës përkatëse dhe shoqërive tregtare që kanë seli në atë Komunë. Kjo taksë, sipas kësaj dispozite, kërkohet që të përcaktohet në bazë të fuqisë motorike të automjetit apo llojit të automjetit dhe sugjerohet që nga kjo taksë të lirohen veturat e shërbimeve emergjente, të transportit të personave me aftësi të kufizuar dhe për qëllime tjera domethënëse shoqërore ose publike.

Marrë parasysh këtë dispozitë të LFPL dhe për dallim nga shumë Rregullore komunale të janë në fuqi, *Model Rregullore* ka përcaktuar 8 lloje të taksave komunale për mjetet motorike, duke u bazuar në fuqinë motorike dhe llojin e veturës. Po ashtu, në këtë pjesë janë rregulluar mënyrën e pagesës së kësaj takse dhe janë përcaktuar një gamë të gjerë të kategorive që përjashtohen nga pagesa e kësaj takse. Për mos pagesën me afat të kësaj takse, *Model Rregullorja* parasheh shqiptimin e gjobave.

Nëpërmjet kësaj takse, Komunat e Republikës së Kosovës mund të realizojnë edhe politika për mbrojtjen e ambientit, duke i përjashtuar nga pagesa apo përcaktuar pagesa më të ulëta për automjetet që punojnë me karburante më mjedisore.

9. Taksat Komunale Ndërtimore dhe Infrastrukturore

Sipas nenit 14 të LFPL-së Komunitat mund kërkojnë nga një preson që dëshiron të ndërtojë apo të rrënojë një ndërtesë që të pajiset me leje për këtë dhe të paguaj taksë për këtë leje, në bazë të sipërfaqes së ndërtesës. Në specifikim të mëtuqeshëm, Ligji Nr. 04/L-110 për Ndërtim, në nenin 19 ka përcaktuar komunitat lëshojnë leje ndërtimore për kategorinë I dhe II të ndërtimeve, pra për ndërtimet me rrezikshmëri të ulët dhe ndërtime me rrezikshmëri të mesme. Sipas nenit 22 të këtij Ligji, taksa e lejes ndërtimore përcaktohet nga organi kompetent (pra nga komuna për kategorinë I dhe II) në konsultim me Ministrinë, dhe kjo taksë duhet të jetë vjetore. Po ashtu, sipas nenit 23 të këtij Ligji, Komuna mund të vlerësojë një ngarkesë për aplikuesin për të rimbursuar koston e krijimit, përmirësimit, zgjerimit apo riparimit të infrastrukturës komunale vetëm aty ku është e autorizuar për të bërë këtë sipas nenit 17 të LFPL

Në zbatimin e dispozitave të Ligjit për Ndërtim, është miratuar Udhëzimi Administrativ MMPH Nr. 02/2018 për Taksat Administrative për Leje Ndërtimore, Leje Rrërimi dhe Tarifatat për Rregullimin e Infrastrukturës, ku është përcaktuar decidivisht që kjo kategori përfshin taksën mbi lejen e ndërtimit, rrënit, taksën mbi ndikimin në infrastrukturë dhe taksën komunale për ndikimin në densitet. Këto taksa janë reflektuar në *Model Rregullore*. Por, meqë kalkulimi i taksave sipas këtij Udhëzimit Administrativ bazohet në kriteret, metodologjinë dhe procedurat e përcaktuara në këtë akt nënligjor dhe bazuar në regjistrin e MMPH-së ku taksat ndryshojnë për çdo komunë, kjo *Model Rregullore* nuk ka përcaktuar shifra për këto taksa. Këto mbetet të caktojë Komunitat, në zbatimin të këtij Udhëzimi Administrativ.

Lidhur me pagesat e këtyre taksave, kjo *Model Rregullore* për shumatat e larta ka paraparë pagesa në këste, por të siguruara me një garancion bankar para autoritetit noterial. Në anën tjetër, taksat komunale për ndërhyrje në infrastrukturë dhe për rrënim të objekteve pa leje kanë një trajtim të veçantë dhe mos pagesa e tyre është paraparë që të konsistojë kundërvajtje të lehtë dhe të gjomit.

10. Taksa Komunale për Shfrytëzimin e Objekteve, Hapësirës dhe të Mirave Publike

Në këtë kategori janë përcaktuar një mori kategori taksash komunale që ndërlidhen me shfrytëzimin e të mirave në territorin e Komunitës. Në *Model Rregulloren* disa nga këto taksat janë kategorizuar edhe bazuar në zonat komunale. Kjo mund të jetë e vlefshme për një numër të madh të komunave, të cilët kanë bërë ndarjen e territorit komunal në zona. Për komunitat e vogla, mund të merren parasysh vetëm një taksë e tillë.

Ky Kapitull ka paraparë taksat si në vijim:

- 1) Taksa komunale mbi vendosjen e panove reklamuese në objektet private dhe hapësirat publike, varësisht nga madhësia e panos reklamuese;
- 2) Taksa komunale mbi parkimin e automjeteve në hapësirat komunale të destinuara për këtë qëllim;
- 3) Taksa komunale për vendosjen e objekteve të ndryshme në hapësirat publike që synon taksimin proporcional të aktiviteteve të ndryshme që shfrytëzojnë hapësirat publike në Komunë;
- 4) Taksa komunale për qëndrimin e veturave përjashtuara nga komunikacioni në parkingun e Komunitës;
- 5) Taksa komunale për bllokimin e rrugëve sekondare, ku bëhet diferencimi kur bëhet për nevojat e personave fizik apo juridik;
- 6) Taksa komunale për shfrytëzimin e përkohshëm të objekteve komunale ku bëhet një kategorizim të përgjithshëm për këtë qëllim. Komunitat, marrë parasysh specifikat e objekteve që kanë, mund të bëjnë një kategorizim më të hollësishëm për shfrytëzimin e këtyre objekteve.
- 7) Taka komuna për shfrytëzimin afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale si pasojë e

dhënie së pronës komunale në shfrytëzim. Edhe këtu trajtimi është i përgjithshëm dhe Komunat mund të bëjnë një trajtim më specifik, bazuar në pronat që i kanë.

- 8) Taksa komunale për qëndrim në institucionet parashkollore të fëmijëve;
- 9) Taksa komunale për mbajtjen kafshëve shtëpiake; dhe
- 10) Taksa komunale për kullosa.

1. Gjobat

Bazuar në dispozitat e Ligjit për Kundërvajtje, *Model Rregullorja* ka përcaktuar veprimet që konsistojnë kundërvajtje dhe ka përcaktuar gjoba, që ndërlidhen me mos pagesën e taksave komunale në afat të përcaktuar në këtë Rregullore. Lartësia e gjobave të përcaktuara janë në kuadër të kufijve që përcakton ky Ligj dhe mendohet se janë proporcionale me veprimet. Po ashtu, mundësia e pagesës së gjobës brenda një afati të shkurtët në vlerë prej 50% të gjobës së shqiptuar, synon eliminimin e procedurave ankimore lidhur me gjobat, të cilat janë të garantuara për palët.

2. Transparenca dhe efektiviteti

Për dallim nga shumë Rregullore Komunale, *Model Rregullorja* nuk ka paraparë që taksat e përcaktuara nga niveli qendror të jenë pjesë integrale të saj. Këto taksa janë listuar në Shtojcën Nr. 2 të këtij modeli dhe është paraparë që ky dokument të jetë i gjallë, nëpërmjet mekanizmit të përditësimit nga një vendim i Kryetarit të Kuvendit. Po ashtu, të gjitha taksat komunale janë listuar në Shtojcën Nr. 1 të *Model Rregullore* dhe kjo do të jetë ndihmesë për zyrtarët teknik që zbatojnë këto dispozita.



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit / Opština Oraovac / Municipality of Rahovec



**KORNIZA AFATMESME
BUXHETORE (KAB)
E KOMUNËS SË RAHOVECIT
2021-2023**

Drejtoria për Buxhet dhe Financa

2020

Përmbajtja:


Përmbajtja:.....	1
I. Hyrje	2
II. Strategjia Zhvillimore Komunale - Deklarata e Prioriteteve Afatmesme	3
1. Forcimi i ekonomisë komunale me mundësi për të gjithë përmes:.....	4
2. Forcimi i Sektorit të Bujqësisë	5
3. Përmirësimi i infrastrukturës shkollore dhe rritja e cilësisë në arsim	6
4. Përmirësimi i shëndetësisë dhe mirëqenies së qytetarëve	6
8. Përmirësimi dhe mbrojtja e mjedisit, planifikimi urban dhe shërbimet publike komunale	7
9. Përcaktim i përhershëm i yni është:.....	7
10. Rinia, kultura dhe sporti	7
III. Korniza Fiskale Komunale.....	8
3.1 Indikatorët ekonomik komunal	8
3.2 Të Hyrat Komunale dhe Parashikimi Afatmesëm 2021-2023	10
3.3 Tendencat e shpenzimeve komunale dhe parashikimi i tyre afat-mesëm 2021-2023	14
3.4 Analiza Gjimore	21

I. Hyrje

Korniza Afatmesme Buxhetore KAB që po prezantojmë është një dokument i cili miratohet në parim çdo vit nga Asambleja Komunale. Ky material siguron një analizë të hollësishme të shpenzimeve publike dhe përcakton parametrat dhe prioritetet kryesore për zhvillimin e vazhdueshëm të buxhetit vjetor komunal. Gjithashtu KAB siguron mekanizmat e nevojshëm për arritjen e objektivave prioritet, të identifikuar në dokumentet strategjike të komunës, përmes integritit sa më të mirë në procesin buxhetor.

Kuadri Ligjor: Hartimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore përbën një detyrim për institucionet buxhetore komunale të kërkuar nga Qarkoret Buxhetore Komunale 2021/01, të lëshuara nga Ministria e Financave në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP).

Ky dokument do të jetë bazë për përcaktimin e sektorëve prioritet të zhvillimit dhe identifikimin e prioritetëve të shpërndarjes së burimeve komunale për periudhën 2021-2023. Janë katër faza të përmbledhura për zhvillimin e KAB komunale dhe afatet kohore, si në figurën e mëposhtme:





III

Publikimi i Dokumentit të KAB-it 2021-2023

Fundi i Qershorit



IV

Procesi vjetor i buxhetit 2021

II. Strategjia Zhvillimore Komunale - Deklarata e Prioriteteve Afatmesme

Komuna e Rahovecit gjendet në pjesën jugore të Kosovës, në rajonin e Dukagjinit (gjegjësisht në subrajonin e Ana Drinit). Është njëra nga komunat e mesme me popullsi, pozita gjeografike që i mundëson asaj lidhje të mira me qendra të tjera të Kosovës dhe të rajonit. Komuna e Rahovecit ka gjithsej 33 fshatra dhe 2 vendbanime, dhe një qendër urbane e ndarë në 5 lagje, me një popullsi prej 56,208 banorë, sipas regjistrimit të vitit 2011, e organizuar në 8.028 ekonomi familjare.

Mbi 3684 biznese operojnë brenda komunës sonë, bazuar në të dhënat e Zyrës për Regjistrim të Bizneseve në komunën e Rahovecit, afërsisht gjysma e tyre (50%) merren me veprimtari tregtare, 15% në sektorin e shërbimeve, rreth 16% në prodhimtari, 19% me transport etj.

Administrata e komunës së Rahovecit është e organizuar përmes zyrave qendrore dhe zyrave lokale që ofrojnë shërbime në nivel të komunitetit, nga të cilat një është e vendosur në ndërtesën administrative të komunës dhe 8 të tjera në fshatra, gjithashtu Komuna e Rahovecit posedin edhe E-kiosku, një mundësi e mirë që qytetarëve ju mundëson vetë shërbimin me dokumente administrative (qertifikata të ndryshme).

Vizioni i mëposhtëm për komunën e Rahovecit, i definuar pas konsultimeve me akterët e rëndësishëm të jetës politike, ekonomike e sociale në komunë bazohet edhe në dokumentet afatmesme dhe afatgjatë strategjike, që ka zhvilluar komuna, siç janë: Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH) 2021-2023 të Qeverisë së Kosovës dhe prioriteteve bazë të saj, si dhe në Qarkorja Buxhetore Komunale 2021-2023 (I), të lëshuar nga Ministria e Financave e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Për tri vitet e ardhshme, vizioni i komunës së Rahovecit është: *të jetë qendër e zhvillimit ekonomik, me një bujqësi të zhvilluar, infrastrukture të rregulluar, me plane zhvillimore dhe urbane, shërbime shëndetësore efikase dhe cilësore, komunë e integruar në proceset rajonale dhe ndërkombëtare, e afirmuar si një qendër e kulturës, arsimit dhe jetës sportive. Po ashtu, një komunë e zhvilluar, e fortë dhe me shërbime publike, administrative që ofrojnë cilësi të mirë të jetesës për të gjithë qytetarët e saj.*

Atributet më të rëndësishme të çfarëdo dokumenti të planifikimit strategjik dhe vizionit të definuar janë, së pari lehtësia e komunikimit si dhe së dyti, llogaridhënia. Me qëllim të përmbushjes së këtyre dy attributeve të ndërlidhura njëra me tjetrën, prioritetet strategjike të komunës në periudhën afatmesme janë grupuar në pesë, e që do të mundësojnë realizimin e qëllimit e të vizionit tonë për komunën.

Këto prioritete janë:

1. Forcimi i ekonomisë komunale me mundësi për të gjithë përmes:

- Krijimit të zonave ekonomike dhe hapësirave për zhvillim.
- Lehtësira në të bërit biznes.
- Mbështetja direkte dhe indirekte e bizneseve.
- Mbështetja e turizmit dhe agroturizmit.
- Rritja dhe modernizimi i tregjeve
- Këshilla dhe sugjerime në të bërit biznes
- Investime në infrastrukturë publike, në zona potenciale për zhvillim ekonomik.

2. Forcimi i Sektorit të Bujqësisë

Zhvillimi dhe fuqizimi i sektorit të bujqësisë për të rritur bazën ekonomike dhe sociale në komunën tonë.

Fillimisht do të mundohemi të hartojmë Strategji të re për zhvillimin e bujqësisë

- Përkrahje bujqve dhe fermerëve me mekanizëm bujqësor, duke i klasifikuar për secilin sektor si:
 - a) Perimekulturë dhe Pemëtari - Mekanizëm bujqësor (motokultivator të vegjël, spërkatëse, frezë, plug, etj.), Komora ftohëse, makineri për tharje të bimëve mjekuese aromatike, inkubator etj.
 - b) Përkrahje me serra me sipërfaqe 3 ari, 5 ari, 7 ari e deri në 10 ari, do të shohim mundësinë që kjo sipërfaqet të rritet në vazhdimësi
- Përkrahje fermerëve me farëra, pleh kimik, pajisje bujqësore dhe me inpute bujqësore,
- Sektori i blegtorisë - përkrahje në makina mjelëse, stalla dhe ferma të vogla, shërbime veterinare (vaksinimi, kontrolla e kafshëve, repelimi etj.)
- Marrja e mostrave të tokave bujqësore për analiza
- Sektori i bletarisë - koshere për bletë, pajisje për trajtim dhe ruajtje të mjaltit, centrifugë etj.,
- Sektori i vreshtarisë - inventar për trajtim të rrushit pas vjeljes,
- Sektori i verëtarisë- pajisje për prodhuesit dhe inventar.

Një theks i veçantë për këtë sektor do të bie në: këshillime dhe hartim të projekteve për fermerët, në sigurim të tregut për fermerë etj.

- Fuqizimi i qendrave grumbulluese dhe përpunuese të pemëve dhe perimeve,
- Fuqizimi dhe përkrahje e bodrumeve për përpunimin e rrushit,
- Hapjen e tregjeve të reja në lokalitete të komunës sonë si: funksionalizim i tregjeve në Krushë të Madhe, Ratkoc, kushte më të mira në tregun ekzistues në Xërxë, ndërtimin e 2 tregjeve të reja në qytetin e Rahovecit, poashtu vazhdimin e fazës së tretë të projektit "Infrastruktura e tregut të rrushit" - te Shtëpia e Verës
- Në bashkëpunim me zyrën këshillimore, që operon në kuadër të MBPZHR-së organizimin e trajnimeve për të gjithë sektorët e bujqësisë në komunën tonë
- Mbrojtjen e tokave bujqësore nga degradimi - erozioni
- Fuqizimi i qendrave grumbulluese të qumështit, stimulimi i tyre.

Prioritetet i kemi edhe në:

- Ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve fushore.
- Ndërtimin e kanaleve të kullimit në zonat ku paraqiten vërshimet që rrezikojnë tokat bujqësore,
- Pastrimin dhe zgjerimin e përrenjve që krijojnë probleme të vazhdueshëm për fermer
- Drenazhimi i tokave bujqësore,
- Rrjeti sekondar i sistemit të ujitjes në lokacione ku ekziston rrjeti primar
- Krijimin e fondit për Emergjencë etj.

Në sektorin e pylltarisë, do t'i jepet prioritet pyllëzimit të hapësirave të reja në tërë territorin e komunës. Toka e cila është nën menaxhim të Agjensionit Pyjor të Kosovës (APK) do të trajtohet me shumë kujdes dhe nuk do të lejohet degradimi dhe keqpërdorimi i saj.

3. Përmirësimi i infrastrukturës shkollore dhe rritja e cilësisë në arsim

- Investime në përmirësimin e kushteve infrastrukturore të shkollave në funksion të rritjes së cilësisë në arsim dhe ndërtimi i shkollave të reja.
- Efiçienca e energjisë në shkolla, sipas nevojave.
- Investime në mjete konkretizimi, laboratorë, teknologji informative dhe furnizime të bibliotekave shkollore me libra.
- Funkcionalizimi i përhershëm dhe bashkëveprimi i organeve drejtuese të shkollave, Këshillave Drejtuese të Shkollave, Këshillave të Prindërve dhe Këshillave të Nxënësve.
- Angazhimi i shërbimeve profesionale pedagogjike dhe psikologjike në shkolla.
- Angazhimi në ofrimin e trajnimeve profesionale të mësimeve në funksion të rritjes së cilësisë në arsim.
- Ndërtimi i çerdheve për fëmijë.

4. Përmirësimi i shëndetësisë dhe mirëqenies së qytetarëve

- Riorganizimi i QKMF-së, për më shumë funksionalitet.
- Subvencionim për rastet e sëmundjeve për personat pa të ardhura/të ardhura të ulëta.
- Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore, ofrimi i shëndetësisë mobile.
- Ndërtimi i qendrave të reja shëndetësore etj.
- Krijimi i kushteve më të mira për stafin shëndetësor.
- Kujdesi paliativ, kujdesi shtëpiak.
- Parandalimi i sëmundjeve ngjitëse dhe jo ngjitëse.
- Parandalimi i sjelljeve të këqija si: droga, duhani dhe alkooli.
- Ofrimi i shërbimeve për të gjithë qytetarët në mënyrë të barabartë.
- Shtimi i personelit shëndetësor.
- Vizitat sistematike shëndetësore të nxënësve në shkolla. Rritja e shërbimeve laboratorike (shtimi i llojeve të analizave në QKMF).
- Rritja e shërbimeve specialistike në QKMF - këshilldhënëse.
- Rehabilitimi i pacientëve me sëmundje mentale dhe ndihma për qytetarët për të pasur jetë të shëndetshme dhe aktive në komunitetin e tyre.
- Trajtimi i rasteve me covid-19, dhe përkujdesja ndaj tyre në bashkëpunim me IKSHP-në dhe kliniken infektive.
- Ofrimi i shërbimeve mjeksore gjatë kohës së Pandemis COVID-19 nga ekipet tona mjeksore në pikat kufitare.
- Dezenfektimin dhe Dezinsektimin dhe deratizimin të objekteve Shëndetësore dhe Administratës Komunale dhe hapsirat publike.

- Krijimi i hapsirave për karantin, objekti i QMF-së (në rast nevojë).

1. Përmirësimi dhe mbrojtja e mjedisit, planifikimi urban dhe shërbimet publike komunale

- Ndërtimi i rrugëve dhe trotuareve.
- Përmirësimi dhe rigjenerimi i infrastrukturës rrugore (sinjalizimi horizontal e vertikal, ndriçimi publik, mirëmbajtja dhe numërimi).
- Krijimi i shesheve të reja, parkingjeve dhe mirëmbajtja e tyre.
- Kolektori dhe impianti për trajtimin e ujërave të zeza.
- Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit.
- Eficienca e energjisë në objekte të sektorit publik.
- Menagjimi i integruar i mbeturinave dhe riciklimi i tyre.
- Hartimi i planeve zhvillimore dhe urbane, hartimi i projekteve të tjera dhe mbikëqyrja e punimeve.
- Përkushtim dhe mirëmbajtje ndaj komplekseve përkujtimore, shtatoreve, varrezave dhe busteve të dëshmorëve, varrezave të martirëve dhe atyre civile.
- Përmirësimi i standardeve mjedisore.
- Përmirësimi dhe zgjerimi i ujit të pijshëm.
- Ofrimi i më shumë hapësirave të gjelbëruara dhe mirëmbajtja e tyre.
- Përmirësimi i gjendjes së lumenjve dhe përrrenjve dhe trajtimi i shtretërve të tyre.
- Përkushtim ndaj të pastrehëve dhe familjeve në nevojë.
- Mbjellja e më shumë drunjëve dekorativ dhe mirëmbajtja.

2. Përcaktim i përhershëm i yni është:

- Qeverisje komunale e cila ofron shërbime efikase dhe që ju përgjigjet kërkesave të qytetarëve.
- Përmirësimi i vazhdueshëm i shërbimeve ndaj qytetarëve.
- Qasja sa më e afërt dhe e lehtë e qytetarëve në administratë.
- Ndërtimi dhe mirëmbajtja e zyrave komunale/gjendjes civile.
- Zgjerimi i sporteleve në zyrat e gjendjes civile.
- Sistemimi i zyrtarëve të zyrës së pranimit, kadastrës dhe arka, në një hapësirë të përbashkët, që kanë për qëllim shkurtimin e kohës për palët.
- Funkcionalizimi i sporteleve të veçanta për mërgatën.

3. Rinia, kultura dhe sporti

- Mbështetja e sektorit të rinisë dhe kulturës (përkrahja e grupeve dhe OJQ-ve të ndryshme).
- Krijimi i rrjetit të OJQ-ve dhe mbështetje për to.
- Funkcionalizimi i kuvendit të rinjve dhe mbështetje e tij.
- Krijimi i Teatrit të Qytetit.
- Promovimi i projekteve për rini dhe kulturë.
- Intervenimi dhe restaurimi në monumentet kulturo-historike dhe mirëmbajtja e tyre.
- Pasurimi i fondit librar në bibliotekat e komunës sonë.
- Trajtimi dhe mirëmbajtja e palestrave të sporteve, fushave sportive dhe ndërtimi i terreneve të reja sportive.
- Ngritja dhe mbështetja e të gjitha klubeve sportive etj.

III. Korniza Fiskale Komunale

3.1 Indikatorët ekonomik komunal

Ndonëse komuna nuk udhëheqë drejtpërdrejtë politikën makroekonomike (kjo është kompetencë e qeverisë qendrore), mjedisi i përgjithshëm ekonomik ndikon në pasqyrën fiskale komunale dhe si i tillë do të trajtohet si vijon, shih tabelën 1. Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës është në përputhje me kornizën makroekonomike të Kosovës dhe sipas dokumentit Korniza Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2021-2023 të përpiluar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Komponentët e politikës makroekonomike siç janë: Bruto Produkti Vendor, inflacioni dhe demografia duhet konsideruar dhe marrë parasysh. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2021-2023 e Qeverisë së Kosovës bazuar në të dhënat historike si dhe në zhvillimet e fundit ekonomike, nënvizon faktin se do të ketë ecuri pozitive të rritjes ekonomike në vitet e ardhshme, më saktësisht në periudhën 2021-2023 ku parashihet një rritje reale vjetore, 5.40 % në vitin 2020, ndërsa rritja reale e Bruto Produktit të Vendi në 2021 - 2023 parashihet të jetë 4.10 %, respektivisht 4.00 %.

Natyrisht se rritja ekonomike ndryshe përkthehet edhe në krijimin e vendeve të reja të punës dhe zbutjen e papunësisë në komunë, që në periudhën afatmesme ulet me 1.65 %, nga niveli i përgjithshëm i papunësisë që llogaritet të jetë i lartë.

Komuna nga ana e saj do të adaptojë legjislacionin përkatës në funksion të krijimit të ambientit më të mirë për sektorin privat dhe rritjes së të ardhurave të tyre, rrjedhimisht rritjes së të hyrave buxhetore komunale.

Aktualisht financimi komunal përfshin: **1. Të hyrat vetanake dhe 2. Grandet qeveritare.** Komunitat po ashtu janë pranues të grave të donatorëve të jashtëm dhe të brendshëm (me mbulim të plotë apo si pjesë të bashkëfinancimeve), si dhe kanë mundësinë e huamarrjes sipas kushteve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi. Komuna Rahovecit në periudhën afatmesme buxhetore 2020-2022, nëse krijohen rrethanat, planifikon të marrë hua nga institucionet financiare për të financuar projektet e saj në projektet për menaxhimin e ujërave të zeza, për të cilën hua garantuese do të jetë Qeveria e Republikës së Kosovës, siç e ka lejuar Ligji për Financat Publike dhe Llogaridhënie.

Tabela 1: Indikatorët ekonomik komunal


Përshkrimi	2020	2021	2022 (vlerësimet)	2023 (vlerësimet)
Indikatorët makroekonomik në Kosovë				
Rritja reale e BPV në %	-2.10	5.4	4.1	4.00
Inflacioni në %	0.90	2.00	1.70	1.70
BPV për kokë banori, në euro	7.114	7.033	7.561	8.003
Indikatorët ekonomik komunal				
Popullsia e Komunës	56.208	56.208	56.208	56.208
Numri i bizneseve të regjistruara	2450	3684	3780	3800
Numri i nxënësve	10.841	9,839	9,839	9,839

Burimi: Korniza Afatmesme e Shpenzimeve, Qeveria e Kosovës, 2020-2023

3.2 Të Hyrat Komunale dhe Parashikimi Afatmesëm 2021-2023

Të hyrat e Komunës së Rahovecit nga dy burimet e saj kryesore – grandet qeveritare si dhe të hyrat vetanake komunale kanë shënuar rritje nga viti në vit.

Paraqitja grafike 1: Buxheti Total i Komunës në vitet (2021 – 2023), milion Euro:



Në bazë të planifikimit të bërë nga viti 2020 Grandet qeveritare për Komunën e Rahovecit si tërësi do të shënojnë një rrënjë (zvogëlim) prej -1,27 %. në vitin 2021, zvogëlim të Grandit Qeveritar do të jetë -1.38 % në vitin 2021 në krahasim me 2020, ndërsa të hyrat vetanake në vitin 2021 do të jetë i njëjti në krahasim me 2020.

Nga viti 2021-2023 parashihet një rritje prej 13.05 % në tersi, sipas të dhënave të prezantuara në tabelën 2 më poshtë, në Grandin qeveritar parashihet të ketë rritje prej 12.49 % ndërsa në të hyrat vetanake 19,67 % kjo rritje kryesisht bazohet në të dhënat e përgjithshme për rritjen buxhetore që planifikohet në nivel të Qeverisë Nationale, siç parashihet me qarkoren 2021/01 (KASH 2021-2023).

Tabela 2: Planifikimi i të hyrave vetanake komunale sipas burimit për periudhën 2021-2023, në Euro

Burimi i të hyrave	2020	2021	2022	2023
Totali i buxhetit	14,735,819.00	14,548,823.00	16,168,363.00	16.659.419.00
Granti qeveritar	13,578,978.00	13,391,982.00	14,856,388.00	15.275.054.00
Granti i përgjithshëm	5,843,393.00	5,670,142.00	6,017,246.00	6.396.041.00
Granti i Shëndetësisë	1,889,703.00	1,951,048.00	2,590,376.00	2,603,328.00
Granti i Arsimit	5,820,978.00	5,745,764.00	6,223,738.00	6,250,657.00
Huamarrja në Arsim	-			
Këshilli i Hoçës së Madhe	24,904.00	25,028.00	25,028.00	25,028
Huamarrja në Shëndetësi	-			
Të hyrat vetanake	1,156,841.00	1,156,841.00	1,311,975.00	1,384,365.00
Buxhet dhe Financa	626,673.00			
Tatimi në Pronë	390,333.00			
Tatimi në Tokë	150,840.00			
Taksa tjera administrative	500.00			
Taksat rrugore	85,000.00			
Administrata dhe Personeli	97,568.00			
Taksa Çertifikatat e lindjes	72,500.00			
Taksa Çertifikatat e kurorëzimit	3,500.00			
Taksa Çertifikatat e vdekjes	1,200.00			
Taksa Çertifikatat tjera ofiqarie	1,168.00			
Taksa tjera administrative	19,000.00			
Takse per pjesemarrje ne tender	200.00			
Ekonomia dhe Zhvillim	163,600.00			
Licenca te lira individuale	900.00			
Licenca tjera per afazem	100.00			
Takse për ushtrimin e veprimtarisë	87,500.00			
Qiraja nga objektet publike	75,000.00			
Taksa tjera administrative	100.00			
Kulturë, Rini, Sport	3,800.00			
Shitja e sherbimeve(Bibloteka)	3,800.00			
Urbanizmi	22,450.00			
Taksa komunale për leje ndërtimi	200.00			
Taksa tjera administrative	4,200.00			
Taksa për demolim	550.00			
Taksa për legalizimin e objekteve	-			
Shfrytëzimin e pronës publike	-			
Inspektimi respektimi i planit urbanistik	17,500.00			

Kadaster dhe Gjeodezia	71,250.00			
Taksa për regjistrimin e trashëgimisë	23,250.00			
Taksa tjera administrative	25,000.00			
Taksa për matjen e tokës në terren	23,000.00			
Shërbime Publike	63,300.00			
Taksa për leje gërmime				
Taksa tjera administrative	800.00			
Te hyrat nga shitja e mbeturinave	47,000.00			
Shfrytëzimi i pronës publike	12,000.00			
Qiraja nga vendosja e objekteve tregtare	500.00			
Qiraja nga objektet publike	3,000.00			
Inspekcioni	2,000.00			
Taksa tjera administrative	1,000.00			
Gjobat nga inspektoriati	1,000.00			
Bujqësia dhe zhvillimi rural	55,300.00			
Taksa tjera administrative	800.00			
Taksa -të hyrat nga pyjet	500.00			
Shfrytëzimi i pronës publike(Qiraja e tokës bujqësore)	1,000.00			
Participimet në Bujqësi	52,000.00			
Taksa për nderimin e destinimit të shfrytëzimit të tokës	1,000.00			
Arsimi dhe Shkencë	9,900.00			
Participimet -qerdhja e fëmijëve	9,500.00			
Taksa tjera administrative	200.00			
Participim për arsim joformal	200.00			
Shëndetësia dhe mirëqeniet sociale	41,000.00			
Participimi nga shëndetësia	40,000.00			
Taksa tjera administrative	1,000.00			
Mbrojtje dhe siguri civile				
Gjobat në trafik	-			
Gjobat në trafik nëpërmjet gjykatave	-			

Komuna e Rahovecit vazhdon të dominohet në buxhetin total të saj nga transferet qeveritare të cilat edhe në tri vitet e ardhshme do të përbëjnë afërsisht 90 % të buxhetit total të komunës.

3.2.1 Donatorët e jashtëm (ndërkombëtarë)

Financimi nga donatorët e jashtëm dhe të brendshëm do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2021-2023 në shumë fusha si në arsim, infrastrukturë, menaxhimin e mbeturinave, ujërave të zeza etj.

3.2.2 Politikat e reja

Komuna e Rahovecit në tri vitet e ardhshme do të bëjë përpjekje në mobilizimin e resurseve komunale me qëllim të adoptimit të politikave të reja që ka iniciuar Qeveria Nacionale e Republikës së Kosovës, por edhe të atyre të inicuar në nivelin e qeverisë komunale.

Fillimisht, ndonëse ende nuk është pjesë e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të Qeverisë së Kosovës 2021-2023, sugjerimit të Qeverisë së Kosovës janë që shuma e Grandit të Përgjithshëm të Komunave që aktualisht është dhjetë përqind (10%) e të hyrave totale të buxhetore të Qeverisë Qendrore, (duke përfshirë të hyrat nga shitja e aseteve, të hyrat tjera të jashtëzakonshme, të hyrat e dedikuara vetanake dhe të hyrat nga huamarrja) do të reduktohet në 9%, në vitet e ardhshme. Projektionet e bëra për 2021 dhe 2023 në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve të Kosovës, nuk reflektojnë ende në këtë politikë. Për komunën e Rahovecit kjo do të vazhdojë të jetë një risk që duhet trajtuar në të ardhmen dhe duke menduar strategjitë që duhet ndjekur me qëllim të mbulimit të asaj difference që do të shkaktonte ulja e nivelit të Grandit të Përgjithshëm, për komunën.

Së dyti, në rast se në periudhën afatmesme Qeveria e Kosovës do të ndryshojë formulën shtetërore të ndarjes së grandit të arsimit për komuna, ndarje kjo që pretendohet të bëhet në bazë të normës e jo të numrit të nxënësve, atëherë kjo do të ketë ndikim të dukshëm në buxhetin e Komunës, ulë grandin e arsimit, sidomos duhet pasqyruar se ky grand përbën pjesën më të madhe të buxhetit komunal. Komuna nuk ka informatat e nevojshme për të bërë analizën e im paktit të kësaj politike.

Së treti, komuna e Rahovecit ka mirëpritur deklaratimet e Qeverisë Nacionale, që në të ardhmen, sa i përket fleksibilitetit të shpenzimeve në të gjitha kategoritë ekonomike, përveç pagave, të kenë mundësi këtë ta bëjnë edhe nga Grandi i Përgjithshëm si shtesë, përveç se nga të hyrat vetanake komunale.

Ndërsa sa i përket të hyrave të tjera të Komunës, apo të hyrave vetanake, sërish Qeveria Nacionale ka shtyrë drejt politikave të reja që do të orientonin komunën drejt avancimit të tatimeve me potencial të mirë dhe zbehjes, eventualisht eliminimit të atyre taksave e ngarkesave komunale që rëndojnë ambientin biznesor komunal. Edhe në të ardhmen barra kryesore në realizimin e hyrave vetanake bie mbi tatimin në pronë dhe në tatimin në tokë.

3.3 Tendenca e shpenzimeve komunale dhe parashikimi i tyre afat-mesëm 2021-2023

Sipas rekomandimeve të Misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar të komunikuara përmes Qarkores Buxhetore komunale 2021/01 komunat do të kenë edhe në të ardhmen fleksibilitet në shpërndarjen e të hyrave vetanake komunale në strukturën e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike për vitin 2021, duke përfshirë kategorinë Paga dhe Mëditje.:

Projeksionet e shpenzimeve buxhetore për vitin 2021 do të paraqesim sipas kategorive ekonomike :

- Pagat dhe mëditjet
- Mallrat dhe Shërbimet
- Shpenzimet Komunale
- Subvencionet dhe Transferet
- Shpenzimet Kapitale

TOTAL

3.3.1 Pagat dhe Mëditjet**3.3.2 Mallrat dhe Shërbimet**

%.

3.3.3 Subvencionet

%.

3.3.4 Investimet Kapitale

%.




Tabela 3: Korniza Buxhetore Komunale 2020-2023, në euro.

	Përshkrimi	2020	2021	2022	2023
			(plani)	(vlerësimet)	(vlerësimet)
1	TË HYRAT TOTALE KOMUNALE	14,735,820.00	14.548.823.00	16.168.363.00	16.658.419.00
	Të hyrat vetanake	1,156,841.00	1.156.841.00	1.311.975.00	1.384.365.00
	Grandet dhe transferet qeveritare	13,578,979.00	13.391.982.00	14.856.388.00	15.275.054.00
2	SHPENZIMET TOTALE KOMUNALE	14,735,820.00			
	Shpenzimet rrjedhëse	10,830,050.00			
	Pagat dhe mëditjet	8,644,220.00			
	Mallrat dhe shërbimet	1,594,330.00			
	Shpenzimet komunale	280,500.00			
	Subvencionet	311,000.00			
3	Shpenzimet Kapitale	3,905,770.00			
	Huamarrja e jashtme	0.00			

Tabelat në vijim janë një pasqyrë e shpërndarjes së shpenzimeve në komunë në bazë të programeve apo kategorive funksionale si dhe në bazë të kategorive ekonomike. Shpenzimet në vijim (tabela 4) janë ato aktualet të vitit 2020, planifikimi për vitin 2021-2023 si dhe projeksionet përgatitjes në (Tabela 4-5-6-7).

Tabela 4: Shpenzimet në vitin 2020, të shpërndara në kategori ekonomike në programe dhe nën programe:

Programe	Paga	Mallra dhe shërbime	Shërbime komunale	Subvencione	Investime Kapitale	Totali
Zyra e Kryetarit	169,542	55,000		90,000		314,542
Administrata	242,719	155,076			20,000	417,795
Barazia gjinore	6,475	2,000				8,475
Inspekcioni	82,663	20,500				103,163
Zyra e Kuvendit K.	211,701	23,500				235,201
Buxhet dhe financa	96,817	108,000			40,000	244,817
Shërbime publike	29,963	378,554	136,000		980,025	1,524,542
Zjarrfikësit	145,601	35,000				180,601
ZLK	64,143	25,000			20,000	109,143
Bujqësia	69,563	40,000		60,000	1,016,000	1,185,563
Ekonomia	50,441	18,000		20,000	60,000	148,441
Kadastra	71,671	18,000			30,000	119,671
Urbanizmi	44,268	18,000			525,000	587,268
Shëndetësia	1,257,109	222,700	60,000	61,000	350,000	1,950,809
QPS	99,225	15,000	4,500			118,725
Kulturë, Rini, Sport	78,748	60,000		80,000	199,745	418,493
Arsim dhe Shkencë	5,923,571	400,000	80,000		665,000	7,068,571
TOTAL	8,644,220	1,594,330	280,500	311,000	3,905,770	14,735,820

Tabela 5: Shpenzimet për 2021, të shpërndara në kategori ekonomike në programe dhe nën programe:

Programe	Paga	Mallra dhe shërbime	Shërbime komunale	Subvencione	Investime Kapitale	Totali
Zyra e Kryetarit						0
Administrata						0
Barazia gjinore						0
Inspekcioni						0
Zyra e Kuvendit K.						0
Buxhet dhe financa						0
Shërbime publike						0
Zjarrfikësit						0
ZLK						0
Bujqësia						0
Ekonomia						0
Kadastra						0
Urbanizmi						0
Shëndetësia						0
QPS						0
Kulturë, Rini, Sport						0
Arsim dhe Shkencë						0
TOTAL	0	0	0	0	0	0

Tabela 6: Shpenzimet , projeksionet 2022, të shpërndara në kategori ekonomike në programe dhe nën programe:

Programe	Paga	Mallra dhe shërbime	Shërbime komunale	Subvencione	Investime Kapitale	Totali
Zyra e Kryetarit						0
Administrata						0
Barazia gjinore						0
Inspekcioni						0
Zyra e Kuvendit K.						0
Buxhet dhe financa						0
Shërbime publike						0
Zjarrfikësit						0
Zyra për Komunitete						0
Bujqësia						0
Ekonomia						0
Kadastra						0
Urbanizmi						0
Shëndetësia						0
QPS						0
Kulturë, Rini, Sport						0
Arsim dhe Shkencë						0
TOTAL	0	0	0	0	0	0

Tabela 7: Shpenzimet, projeksionet 2023, të shpërndara në kategori ekonomike në programe dhe nënprograme :

Programe	Paga	Mallra dhe shërbime	Shërbime komunale	Subvencione	Investime Kapitale	Totali
Zyra e Kryetarit						0
Administrata						0
Barazia gjinore						0
Inspekcioni						0
Zyra e Kuvendit K.						0
Buxhet dhe financa						0
Shërbime publike						0
Zjarrfikësit						0
Zyra për Komunitete						0
Bujqësia						0
Ekonomia						0
Kadastra						0
Urbanizmi						0
Shëndetësia						0
QPS						0
Kulturë, Rini, Sport						0
Arsim dhe Shkencë						0
TOTAL	0	0	0	0	0	0

Kategoria Ekonomike – Investimet Kapitale - e prezantuar në detaje më lartë paraqet një komponentë të rëndësishme të buxhetit të komunës e cila ndonëse nuk përfaqëson pjesën më të madhe të shpenzimeve të përgjithshme buxhetore, mbetet me rëndësi të posaçme në aspektin e planifikimit për komunën e Rahovecit. Kjo kategori e shpenzimeve në kuadër të shpenzimeve të rregullta buxhetore ka potencialin më të madh për të nxitur rritjen ekonomike. Prandaj, kjo kategori e shpenzimeve, edhe gjatë periudhës së ardhshme afatmesme, do të vazhdojë të jetë në funksion të krijimit të ambientit më të favorshëm për ngritje të pjesëmarrjes së sektorit privat, përmes përmirësimit të vazhdueshëm të infrastrukturës. Përderisa ndikimi i këtyre investimeve në punësim dhe konsum është relativisht i shpejtë, ndikimi i plotë i tyre në ekonomi do të mund të realizohet vetëm në periudhën afatmesme. Në këtë kontekst përmirësimi i infrastrukturës do të pozicionojë ekonominë e komunës së Rahovecit në një rrugë të rritjes më të shpejtë dhe të qëndrueshme ekonomike në periudhën afatgjatë.

3.4 Analiza Gjimore

Komuna nuk ka përgatitur një buxhet të përgjegjshëm gjinor të detajuar, por jemi përpjekur për të vlerësuar se si shpenzimet në paga dhe mëditje janë ndarë për të adresuar planifikimin e ardhshëm buxhetor. Ne kemi analizuar numrin e grave dhe burrave, djemve dhe vajzave të punësuar në kuadër të komunës, dhe i paraqesim këtë informacion në tabelën e mëposhtme:

Sqarim: Tabela e mëposhtme bazohet në shifrat sipas listës së Pagave dhe Mëditjeve të Qershorit 2019 dhe numrin aktual të të punësuarve.

Tabela 8: Struktura e të punësuarve sipas gjinisë

Tabela 1. Numri i punëtorëve në Organizatën
Buxhetore
Emri i institucionit

Viti	Numri total i stafit	Numri total i stafit që janë gra	Numri i stafit që janë burra	Paga dhe mëditje/Shuma për gra	Paga dhe mëditje/Shuma për burra
2019					
2020					
Planifikimi 2021					

Tabela 2. Planifikimi për vitin 2021 Nivelet e pagave në Organizatën Buxhetore

Emri i institucionit

Niveli i pagave	Numri i total i stafit në këtë nivel të pagave	Numri i burrave në këtë nivel	Shuma e shpenzuar për burra në këtë nivel	Numri i grave në këtë nivel	Shuma e shpenzuar për gra në këtë nivel
201-400					
401-600					
600+					

Tabela 3. Numri i përfituesve të subvencioneve apo edhe të shërbimeve ofruara nga organizata buxhetore të drejtorive përkatëse (ku është e aplikueshme)

Viti	Buxheti total i shërbimit/subvencionit të caktuar	Numri total i përfituesve	Numri total i përfituesve e grave	Numri total i përfituesve për burra	Buxheti për gra	Buxheti i për burra
2019						
2020						
Planifikimi 2021						

Komuna do të përdor më pas të dhënat specifike gjinore që janë në dispozicion për të vlerësuar ndikimin gjinor në paga dhe mëditje në buxhetet e vitit 2019 për të përgatitur buxhetin në të ardhmen duke respektuar buxhetin e përgjithshëm gjinor. Tek investimet kapitale, kur një projekt është për një qytet të caktuar apo të një fshati, për një rrugë, gypat e ujësjellësit, qendër shëndetësore etj. ne do të përdorim të dhënat e ndarjes së popullsisë në mes të grave, burrave, vajzave dhe djemve për atë zonë; Kur një projekt është për një shkollë të veçantë ne do të përdorim numrat e nxënësve: meshkuj dhe femra; Kur një projekt ndikon në tërë komunën (duke përfshirë projektet për administratën komunale) ne përdorim analizën e përgjithshme të popullsisë nga viti 2011.

Drejtori për Buxhet dhe Financa

Kryetari i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Rahovec

Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **29.05.2020**, me fillim në ora **10:00**. Mbledhjen e kryesoi: Kryesuesi i Kuvendit z. **Afrim Dina**. Konstatohet se kuorum, për mbajtjen e mbledhjes kemi:

Kryesuesi – Fillimisht më lejoni t'iu përshëndes, i nderuar Kryetar i Komunës z. Smajl Latifi, nënkryetar i Komunës z. **Fatmir Iska**, të nderuar kuvendarë, drejtor të drejtorive Komunale, përfaqësues të mediave dhe ju gjithë të pranishëm.

Të nderuar kuvendarë, për këtë mbledhje sot propozojmë këtë :

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për bartjen e tejkallimit të të hyrave vetanake nga viti 2019,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatgjatë,
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për dhënien e pronës së paluajtshme – lokaleve afariste të Komunës në shfrytëzim personave juridik,
6. Shqyrtimi i raportit të DKA-së për ecurinë e zhvillimit të mësimi online/ në distancë

Kryesuesi – Të nderuar kolegë kuvendarë, a jeni për këtë rend dite. Konstatohet se unanimisht aprovohet rendi

i ditës. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Ali Morina – Faleminderit kryesues, i nderuar kryetar, nënkryetar, drejtorë të drejtorive, kolegë asambleistë, përfaqësues të mediave. E kam një vërejtje të vogël, faqe 10 të fjalimi im konkretisht të rreshti i tretë, kur kam thënë se në 3-mujorin e dytë të këtij viti do të kemi pak vështirësi për shkak të pandemisë, ku kam thënë pak vështirësi në realizimin e të hyrave për shkak të pandemisë pra vetëm ky përmirësim të bëhet. Faleminderit

Fehmi Cena – Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë. Edhe unë kam një ndërhyrje në faqe 11, mendoj se kanë ndodhur 2 apo 3 gabime teknike tek fjalimi im, tek rreshti im, po e lexoj fjalinë, tek tatimi në pronë mendoj se është element shumë i rëndësishëm sepse të hyrat nga tatimi në pronë është më obligatorë, e që duhet të jetë me indikatorë me i mirë që e vlerësoj punën e qeverisë lokale. Faleminderit!

Sali Sallteku – Siç e thanë edhe para folësit më parë, unë e di që tash ka edhe lektor, mendoj se ka shumë gabime dhe kjo nuk duhet të ndodh por megjithatë pasi e keni lektorin është mirë me pas një kontrollë më të detajizuar pasi është një dokument dhe duhet ruajtur pak më mirë edhe me u shkruajt më mirë, nuk po dua me kritikua procesmbajtësin mirëpo seriozisht janë fjalitë pa kuptim. Faleminderit shumë!

Rasim Fazliu – Përshëndetje kryesues, kryetarin, nënkryetarin, drejtorët dhe gjithë pjesëmarrësit në sallë. Në faqe 19, është një gabim i vogël teknik që me siguri e humb kuptimin e fjalisë, tek diskutimi im është fjalia e dytë ku thotë do të ishte mirë të kishim ardhur të përgatitur në këtë mbledhje sepse jemi të, duhet me qenë papërgatitur kurse këtu është e shkruar të përgatitur pra do të ishte mirë të ishim ardhur të përgatitur në këtë mbledhje sepse jemi të (pa)përgatitur. Faleminderit!

Kryesuesi – Atëherë se pari unë do të ju kërkoj falje pasi mbledhjen e kaluar e kemi mbajtur në sallën e Shtëpisë së Kulturës „Mensur Zymberaj“, dhe ka pas mundësi që gjatë incizimit nuk është dëgjuar mirë për shkak të mungesës së zërimit, kur dihet se incizimi është bërë me telefon dhe kjo ka shkaktuar shumë probleme. Sigurisht edhe sekretaria duhet me krye procesverbalin me kohë, në mënyrë që lektorimi me përfundua me kohë. Faleminderit për vërejtjet, sigurisht që do t'i përmisojnë gjitha vërejtjet e bëra. Atëherë nëse nuk kemi tjerë të lajmëruar rreth procesverbalit, e qesim në votim. Konstatoj se unanimisht aprovohet pika e parë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve.

Fehmi Hoxha – Faleminderit shumë kryesues, përshëndetje për ju, kryetarin, nënkryetarin, drejtorët e ekzekutivit, kolegë asamblistë, media dhe gjithë ju të pranishëm. Unë vazhdimisht jam duke kërkuar qysh në seancën e tretë disa informata dhe nuk po kam ashtu siç jemi dakorduar se duhet të përgatiten. Unë besoj se drejtori i Zhvillimit Ekonomik e ka përgatitë informatën të cilën e kam kërkuar para tri seancave kryesisht edhe në seancën e kaluar për bizneset të cilët kanë pas të ndaluar në bazë të vendimit të Qeverisë ose Ministrive përkatëse që ka qenë një vendim antikushetues mirëpo në bazë të asaj nuk kanë punuar bizneset. Po ashtu edhe një informatë, të formohet një komision edhe të dalin me pa se sa lokale afariste n'fakt kafiteritë, frizeret, zejtarët të cilët nuk kanë pasur të drejtë me punua edhe që kemi kërkuar, fakt e kam hapur si temë që ta diskutojmë bashke edhe të marrim një vendim në bazë të mundësive që Kuvendi Komunal me marr një vendim se bashku me kryetarin dhe t'i subvencionojmë ata. Një të tillë është mirë nëse drejtori e ka edhe me dal me na tregua që aktualisht komisioni është deshtë të formohet dhe me shkuar prej lokalit në lokal me pa sa janë ata por jo sa janë të regjistruar sepse aty janë kode të ndryshme dhe kurrë nuk mundemi me bo një statistikë të atillë edhe me marr ndonjë raport të atillë, kjo ishte e para. E dyta, në seancën e kaluar kërkoja që në këtë seancë të hyj në rend të ditës duke marr për bazë që komuna po keq klasifikohet në bazë të borgjeve të painkasuara, pasi kemi shumë biznese të cilat janë të regjistruara dhe janë të shuara dhe kërkoja atëherë që të merret këtu një vendim që bashkë ta diskutojmë dhe të marrim një vendim që të çlirojmë edhe komunën edhe bizneset „ekzistuese“, bizneset që janë vetëm të regjistruara dhe të ju falim atyre, njëkohësisht propozova që 50% të bizneseve ekzistuese që kanë obligime t'iu falim edhe ne të inkasojmë rreth gjysmë milioni euro, që n'fakt mbi 1 milion kanë borxh dhe asnjë centë nuk kemi dhe pasqyra jonë e klasifikimit të del pozitive. Nëse nuk keni pasur kohë me u përgatitë, ju lutem që ta përgatiteni dhe të dilni me një propozim pasi kam të drejtë si kuvendarë edhe në bazë të rregullores se Kuvendit me propozua, kështu që qitni propozimin në votim dhe nëse nuk kalon atëherë nuk ka problem.

Nuk po kërkoj për këtë seancë me qitë por servona të gjitha informatat dhe të shohim se çka mundemi me bo. Faleminderit!

Florida Bajraktari – Faleminderit kryesues, përshëndetje për te gjithë pranishmit. Unë desha me bo një pyetje rreth ndërtimit të serave. Pra në buxhetin e miratuar për vitin 2020, njëri prej kodeve buxhetore ka qenë edhe ndërtimi i serave me participim ku janë paraparë 200,000 euro. Desha të di se çka është bërë me serat pasi jemi gati në fillim të qershorit dhe desha me pyet se a do të munden t' i shfrytëzojnë përfituesit serat për vitin 2020, kur dihet se buxheti është ndarë për këtë vit e jo për vitin 2021. Kërkoj nga drejtori të na jep sqarime se kur do të filloj ndërtimi i serave edhe a është shpallë tenderi për ndërtimin e serave me participim?

Fehmi Cena – Unë po dua me shtrua një çështje që ka të bëjë me fushën e shëndetësisë në komunën tonë, për komunën e Rahovecit. Është fjala për punëtorët shëndetësor me kontratë të përkohshme sipas marrëveshjes Caritas Kosova me Komunën e Rahovecit. Sipas kësaj marrëveshjeje në komunën e Rahovecit në shëndetësi janë punësuar rreth 45 punëtorë shëndetësorë mjek, infermier. Problemi është se ata nuk janë paguar për 3 muaj pra mars, prill dhe tash maj, që shumica prej tyre kanë punuar edhe gjatë periudhës së pandemisë me Corona virus Covid-19 me punëtorët e tjerë të rregullt të shëndetësisë. Ata kanë filluar ta shprehin me të drejtë shqetësimin e tyre për mos pagesë nga Komuna. Unë si këshilltarë i këtij kuvendi e ndaj shqetësimin me këta profesionistë shëndetësorë për mos pagesë për punën e tyre 3 muajore për këtë vit. Kujtoj se Komuna përmes këtij Kuvendi Komunal ka ndarë për këtë projekt një shumë të buxhetit afër 200,000 euro apo me saktësisht 195,198,00 euro. Mendoj se këta punëtorë i kanë plotësuar të gjitha parakushtet për tu kompensuar për punën e bërë. Pyetja ime, është si qëndron puna me këta punëtorë, pse nuk janë kompensuar për këtë periudhë kohore për punën e tyre të kryer, pse nuk kanë kontrata. Faleminderit?

Artan Asllani – Faleminderit kryesues, i nderuar kryetar, nënkryetar, kuvendarë, kolegë drejtorë. Në pyetjen të cilën e ngriti si shqetësim i nderuari kuvendari Fehmi Hoxha është e vërtetë mirëpo nuk kemi mundur me marr informata të sakta, për arsye se ne i kemi informatat e sakta se sa biznese i ka komuna e Rahovecit, po ashtu e kemi edhe listën që e kemi marr nga Ministria e Tregtisë kryesisht nga departamenti i ARDK-se mirëpo nuk mundemi me ditë në detaje pa formimin e një komisioni i cili del në vend ngjarje dhe bën verifikimin e bizneseve që nuk kanë pasur të drejtë. Ne kemi bërë një raport për shqyrtimin dhe faljen e obligimeve në taksa dhe qira. Bizneset që nuk punojnë dhe janë të ngarkuara me takse komunale janë gjithsej 480 biznese, pra bizneset që punojnë dhe që janë të liruar prej taksës komunale me vendim të kuvendit të komunës së Rahovecit janë 849 biznese, po ashtu kemi edhe bizneset të cilët realisht kanë mbetur në obligime ndaj taksës komunale mirëpo që nuk punojnë për një arsye apo tjetër janë të mbyllur, që gjithsej janë 661 biznese. Besoj që për këtë pikë në muajin qershor në Kuvend do të dalim me një propozim dhe të merret vendimi nga ana juaj për faljen apo mundësinë e shqyrtimit të faljes së këtyre obligimeve të mbetura. Te nderuar kuvendarë, besoj që pas raportit që na vjen nga ana e komisionit për vlerësimin e dëmeve të krijuara gjatë pandemisë, do të dalim të diskutojmë rreth kësaj mundësie.

Fehmi Hoxha – Krejt në rregull është kjo, edhe unë po besoj që do të kryhet kjo brenda një muaji mirëpo edhe njëherë po e potencoj që të jem i qartë, e thash edhe më herët, mundësitë tona sa janë masandej bashke do ta diskutojmë këtu. Ju duhet të formoni një komision edhe pastaj e këqyrim, sa ka lokale të cilët janë të regjistruar pasi ka edhe lokale që punojnë ilegalisht pra edhe në qytet edhe në komunë të Rahovecit. Pra ata që janë taksapagues edhe i nënshtrohen ligjeve të Republikës së Kosovës, pra një komision se sa janë ato lokale që kanë pasur të ndaluar e aty janë kafiteritë, frizeret edhe disa tjerë që unë nuk e di, e që ju me siguri e dini, pra le të bëhet kjo tani. Faleminderit!

Kryetari – Përshëndetje për anëtarët e kuvendit të komunës, kryesuesin, nënkryetarin, drejtorët e drejtorive, përfaqësues të mediave dhe gjithë juve që jeni prezentë në sallë. Florida Bajraktari ka bërë një pyetje sa i takon çështjes së ndërtimit të serave të reja të cilat ju dedikohen përfituesve 5 ari dhe 3 ari. Pra janë të ndara në dy lote, që realisht janë duke u marrë dy kompani, që kanë për detyrë me ekzekutua kontratën. Raporti i pjesëmarrjes për përmbushjen e këtij projekti është 80 me 20, pra 80% investon komuna kurse 20% investon apo merr pjesë fermeri. Është një kontratë e madhe edhe besoj që numri i përfituesve mund të jete mbi 300 përfitues, interesimi për serra ka qenë jashtëzakonisht i madhe dhe do të jete kontratë kornizë që me pas mundësi pastaj edhe sipas ligjit edhe 30% me i përmbush edhe ankesat që kanë mundur me i bo fermerët që nuk kanë mbërri me përfitua edhe me i shtua edhe njëherë me atë 30% që sipas ligjit është shtesë. Pra tenderi është i shpallur me shume se dhjetë ditë apo dy javë edhe presim zhvillimin dhe përfundimin e procedurave në lidhjen e kontratave, besoj që do të filloj sa ma shpejt që është e mundur ekzekutimi i projektit. Ne sot e kemi një raport, e kam të gatshëm raportin e evidentimit dhe vlerësimit profesional të dëmeve reale financiare që i kanë fermerët tanë, që janë të dëmtuar nga reshjet intensive të shiut dhe breshëri. Ky raport sot do të i dërgohet Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural kuptohet edhe Kryeministrisë dhe natyrisht ne kemi kërkuar edhe kërkojmë kompensimin dhe dëmshpërblimin e fermerëve të dëmtuar nga reshjet e fundit që brenda 48 orëve kanë prekur Komunën tonë dhe dëmet janë mbi 2 milion e gjysmë euro në perimekulturë dhe në vreshta. Raporti i dëmeve nga pandemia, dëmeve në ekonomi, dëmeve në bujqësi, dëmeve në biznese të vogla të mesme dhe të mëdha, shpresoj që do të jetë gati brenda një periudhe optimale, një afati të arsyeshëm dhe do të sjellët në kuvendë si informacion se cilat ishin humbjet e qytetareve tanë, bizneseve posaçërisht ekonomive familjare, të gjitha kategoritë e veprimtarive ekonomike biznesore, do të ketë një raporte profesional sepse ne do të kemi të angazhuar ekip profesional që ndoshta është edhe jashtë komunës tonë, edhe raporti do të jetë i certifikuar dhe i licencuar, edhe besoj që kompetentët nga niveli qendror do ta kenë parasysh që në pakon për rimëkëmbje ekonomike të përfshihen patjetër edhe bizneset e komunës së Rahovecit pra gjithë ata që kanë humbur përfshirë edhe kategorinë e fermerëve dhe bujqëve. Po ashtu kemi bërë edhe një raport për vlerësimin e dëmeve në amvisëri dhe ne ekonomi familjare nga reshjet e fundit dhe fatbardhësisht nuk është ndonjë vlerë e madhe afërsisht 27,000 euro edhe pse kemi menduar me shume por në bujqësi është shume më i madhe. Për sa i takon faljes së borxheve do ta kemi një propozim konkret të bazuar në standarde të cilat i vlerësojmë i diskutojmë dhe i vendosim bashkë sepse ekziston një perceptim se nëse ne shkojmë me falje të borxheve ndaj kompanive që për një arsye ose arsye tjetër për neglizhencë nuk kanë dashur ose nuk kanë pasur mundësi të i përgjigjen obligimeve që i kanë në raport me komunën e Rahovecit e që është në kundërshtim me ato kompani të cilave ju kam përgjigjur edhe janë kredibile dhe funksionale rentabile në ekonomi. Pra nuk duhet të japim mesazhe se veç falim borxhe, gjithmonë flasim për borxhe të cilat nuk mund të inkasohen kurrë pra për ato po mirëpo duhet të caktojmë edhe periudhën pra duhet të bëjmë bashkërisht një standard, nëse është nevoja duhet me krijua edhe një komision të kuvendit të komunës qemë qenë më të saktë dhe preciz edhe ne mënyrë që kur të merret vendimi që ta arsyetojmë seriozisht mirë edhe mesazhi të jetë i mirë sepse neve na thonë bizneset sepse ka disa biznese që na thonë se ne vazhdimisht paguajmë se ashtu jemi mësuar dhe e kemi shprehur ndërsa disa të tjerë që ngurrojnë me i krye obligimet që ju takojnë sipas ligjit, atëherë e dinë se një ditë i falë kuvendi i komunës. Pra ne jemi për inkasimin e atyre borxheve që s'janë aktive fare ose nuk mundet të inkasoj komuna fare edhe auditori i jashtëm vazhdimisht e nxjerr si keq. Pra besoj që edhe Fehmin jemi dakord në këtë pikë pasi tani nuk i kam të gjitha por po besoj që kur të vjen radha ne qershor pra edhe unë jam pro asaj që me i fal këto borxhe, që vazhdimisht na shkruhen si borxhe të painkasuara edhe ashtu nuk mundem me u inkasue sepse janë borxhe të vjetra mbi 20 vjetë që ose janë të ndërruara bizneset ose nuk ekzistojnë fare dhe tash duhet me bo diçka

sepse vazhdimisht po na shkruhen si borxhe nga Auditori i Jashtëm dhe po na bien si barrë e rende që s'po korrigjohen nga ana e komunës së Rahovecit, pra është rasti me i falë borxhet dhe jemi pro kësaj. Tek pyetja e Fehmi Cenës, rreth mos pagesës së punëtorëve të cilët kanë punuar me Caritas Kosoven. Kontrata e punëtorëve të angazhuar me Caritas Kosova ka përfunduar në muajin shkurt dhe Drejtoria e Shëndetësisë bashkë me Drejtorin e QKMF-së i ka ftuar që deri në lidhjen e kontratës së re, të nënshkruajnë një dokument i cili nënkupton punë vullnetare deri në kontratën e re. Procedurat e kontratës së re janë kryer dhe është lidhur dhe për atë muaj kanë qenë në dijeni se kanë me punua pa pagesë ndërsa në muajin e dytë ishte nga pandemia dhe menjëherë Drejtori i Shëndetësisë në emër të QKMF-së pra në emër të këtyre shërbimeve ka dërguar shkresë në Ministrinë Shëndetësisë, në Ministrinë e Financave që të kompensohen shërbimet që ata kryejnë dhe ende nuk ka ndodhur pra nuk kemi ende përgjigje pozitive dhe janë diku 300 persona në shkallë republike që punojnë me shërbime me Caritas dhe që nuk e kanë marr kompensimin e që e kanë marr punëtorët e tjerë pra fjala është për punëtorët e rregullt shëndetësorë si mjek, stomatolog, infermierë pra këta të rregullt i kanë marrë mirëpo nuk i kanë marr këta që janë me shërbime me Caritasin. E vërteta është se diku ka ndërhyje vet Caritasi që i ka cilësuar punëtorë të vet direkt dhe kanë mundur me marr ndonjë pagesë mirëpo në rastin konkret ata kur është shkëput kontrata në neve pra pasi ka përfundua kontrata atëherë me gjasë i ka mbete vetëm komunës konkretisht Drejtorisë së Shëndetësisë me bo kërkesën sikur e kanë bërë edhe komunat tjera dhe shpresojmë që të kompensohen sepse e meritojnë po aq sa të tjerët që janë të rregullt sepse nuk e kanë lëshua frontin për asnjë minutë. Pra unë jam dakord me Fehmi Cenën që ata duhet me u kompensua. Komuna nuk mund t'i kompensoj përveçse prej këtij muaji ata do të marrin pagesë pasi që kemi kontratë pra është lidhur kontrata me kompaninë që merret me rivitalizimin pra është i njëjti kodë por është kompania që ka kontratë tani me komunën e Rahovecit edhe besoj që ata kanë me i bo pagesat edhe kontratat të gjithë ata që kanë punuar të ju vazhdohet kontrata por për këtë një muaj që janë pa pagesë, shpresoj në një zgjidhje që do të na jep qeveria e Kosovës sepse edhe këta pothuajse janë sjellë apo kanë punuar si punëtorë të rregullt. Pra në nuk kemi mundësi me paguar sepse nuk na lejon ligji, nuk na lejon procedura dhe nuk kemi mundësi si kuvend me nda shumë për me i pagua për shkak se që një muaj që janë pa pagesë me ju dhanë ne si kuvend i komunës sepse edhe nuk kemi mjete por nëse i kompensojmë qeveria në pakon emergjente atëherë shpresojmë do të bëhet mirë. Por unë besoj që ata janë dakord sepse edhe viteve tjera kanë punuar edhe ka 2 apo 3 muaj për shkak se janë ndërpre kontratat dhe deri sa janë lidhë kontratat e reja, edhe këtë vite duhet të kenë pak durim pasi ne i respektojmë shumë për gjithë punën që kanë bërë dhe vazhdojnë me bo por tani përcillet mesazhi që prej kësaj kohe do të fillon më mirë për shërbimet që i kanë, por atë ne nuk mundemi të kompensojmë por presim që do të na ndihmon qeveria nga pako emergjente. Faleminderit

Sali Sallteku – Për bujqit kjo është bërë një problem i madhë pasi kjo është një e keqe, që me punua një vit pasi është deshtë me u krye, tani pasi ndihma e duhur është deshtë të kryhet tani, pasi një gabim i tillë është përcjelle vazhdimisht dhe nuk është vetëm i juaji. Dëmet në bujqësi janë shumë të mëdha dhe përveç asaj i kanë bllokuar pothuajse të gjitha pasi e kanë ndaluar me shitë fidanë, me krijua tregun apo edhe me punua.

Kryetari – Për shkak të gjendjes së pandemisë, së pari është miratuar me vonesë Buxheti i Republikës së Kosovës dhe këtë e dini, e dyta pandemia ka shkaktuar një situatë të re pasi Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik nuk ka lejuar hapje të procedurave pra ka pasur afat që nuk ke pasur të drejtë me hap procedura. Tash ne jemi në fund të muajit maj dhe besoj që në momentin kur ne e kemi pasur rastin ku na është dhënë e drejta për me operua me buxhetin d.m.th. veç është përgatitur koncepti është bërë shpallja dhe tash unë e di serrat më së miri është me i pasur ne pranverë por nuk kemi pasur mundësi me operua dimrit pasi kontrata e vjetër ka përfunduar edhe jam dakord plotësisht për atë që po e thua ti pasi ju kish

deshtë më herët por i nevojiten edhe tash verës nëse bëhet serra dikush nëse është punëtorë edhe mundet me shfrytëzua. Ne jemi të interesuar me ndodhë punë sa më shume punë sivjet edhe me serra. Ju e dini se fermerët, ne po kërkojmë kompensim edhe unë jam i bindur se ka me ndodh kompensimi sepse vlera mbi 1 miliard euro pa i përfshije pemët sepse raporti veçse po kompletohet dhe mund me shkua rreth 3 milion dhe unë po kërkoj pasi edhe zyrtarisht edhe publikisht kam kërkuar pasi e kam pasur edhe Ministrin, këtë e din edhe zyra e Kryeministrit edhe krejt opinionin publik se fermerët meritojnë një dëmshpërblim pra fermerët e Rahovecit pasi unë nuk mundem me than për fermerët e Mamushës, të Suharekës apo të Prizrenit por më shumë se fermerët e Rahovecit në këtë periudhë, nuk është dëmtuar askush. Në qoftëse ne e kemi një fond të fatkeqësive natyrore që është i Ministrisë së Bujqësisë prej 3 milion eurove madje ne kemi kërkuar me rrit atë fond edhe me ju nda fermerëve, sepse e keni parë se fermerët janë goditë edhe për shkak se ende nuk i kanë përfshire në pako emergjente, por, shpresojmë që me i përfshi në pakon e rimëkëmbjes ekonomike, edhe mos me i kompensua tash dëmet edhe me ju ndalua tash tregu, pasi ne po e dimë tash se në çfarë gjendje jemi. Unë jam duke luftuar edhe ne emër tuajin që me ndodhë kompensimi dhe me u futë në pakon emergjente po ashtu edhe ne pakon e rimëkëmbjes ekonomike edhe ato serra me i ndërtua sa ma shpejt që është e mundur ne momentin kur kemi leje me ekzekutua kontratën.

Fehmi Cena – Për çështjen që e propozova, kryetari dha disa sqarime që në rregull është kjo, mirëpo megjithatë unë mendoj që për shkak se ka qenë një periudhë specifike në kohën e pandemisë pasi ata njerëz kanë punuar dhe u janë nënshtruar rrezikut sikurse punëtorët e rregullt, për atë arsye edhe qeveria e ka dhënë pakon emergjente që të jetë një lloj shpërblimi për shkak të rrezikut edhe ata kanë punuar në atë kohë edhe mos me marrë pra mos me u pagua as nga ky projekt as nga niveli qendror, kjo nuk është në rregull dhe unë mendoj që megjithatë që ju duhet të gjeni forma, metoda që këta punëtorë të kompensohen për këtë kohë. Është shumë mirë që ju keni kërkuar nga niveli qendror dhe nuk e di pse nuk e keni bërë me herët që ndoshta ata kanë mundur me krye në pakon e përgjithshme bashke me punëtorët e rregullt, bile ato 250 euro me i marr. Po ashtu, është e vërtetë se ata kanë nënshkruar ka një letër që do të punojnë vullnetarisht, mirëpo ajo është përgjegjësia e tyre morale, mirëpo nga aty unë mendoj se dalin detyrime, nga institucioni, nga komuna që megjithatë ka mundësi me u kompensua. Tash nëse ka nevojë, le të sakrifikohet sivjet edhe një projekt i vogël në infrastrukturë edhe ashtu e dimë se çfarë viti është dhe nëse jo, atëherë le të bëhet nëpërmjet formave tjera. Në mbledhjen e kaluar ky kuvend, me sa e di unë kemi ndarë mjete të buxhetit pikërisht për shëndetësi për paga dhe mëditje, ndoshta ato do të shkojnë për diçka tjetër, ndoshta ne prapë do të mundemi që në të ardhmen, që brenda vitit me nda një pjesë prej një pozicioni, aq do të kushton përafërsisht një përllogaritje që ne kemi bërë diku rreth 30,000 euro do të kushton, dhe kjo punë ishte kryer ashtu siç duhet. Komuna do të ju mbetet borxh atyre njerëzve nëse nuk e kryen këtë kompensim.

Kryetari – Është e vërtetë që ata e meritojnë shpërblimin po ashtu është e vërtetë që ne kemi situata edhe në arsim, kanë mbetur me paga brenda dhe nuk ka mundur asnjëherë me u futë në listë të pagave dhe kur janë futë në listë të pagave pastaj ka 2 apo 3 muaj ju kanë lëshuar. Unë e di që ata e meritojnë dhe plotësisht jam dakord por nëse e hapim këtë derë atëherë ekziston rreziku që d.m.th. atëherë kuvendi i komunës me pague në shume pozicione me shume 30,000 euro, dhe ne jemi të vetëdijshëm se atyre 1 muaj ju ka shkua pasi edhe kanë pranua vullnetarisht vet me punua sepse edhe ashtu kontratë nuk kemi pasur edhe s'kemi pasur mundësi si t'i paguajmë dhe nëse qeveria e Kosovës ka me fut dikë prej ndonjë komune me shërbime të veçanta prej Caritasit ose shërbime si këto, unë jam i bindur që pashmangshëm ka për obligim me shtie edhe 45 punëtorë të komunës së Rahovecit. Nëse ne do të mundemi me operatorin që ka kontratë me ne, më bo ndonjë zgjidhje gjentelmene, nuk po them zgjidhje ligjore por nëse ka ndonjë mundësi me bo ndryshe, nuk është se kemi hequr dorë nga përkushtimi për me ju ndihmua ose me i shpërblye ata që e

meritojnë por nuk guxojmë me rrezikua kuvendin e komunës me nda mjete diku 30,000 euro, këtu e kemi edhe drejtorin e DKA-së edhe unë e di që shume raste që kanë mbetur me ka 2 apo 3 muaj që nuk i ka shtie ne liste të pagave dhe u deshtë me prit edhe asnjëherë si kam kompensua për muajt që i kanë kryer si mësimdhënës pra na dalin shumë probleme dhe besoj që mirëkuptohemi, po ashtu e di që kanë kryer një punë të mirë edhe mjekët edhe infermieret e po ashtu edhe ata me shërbime të Caritasit padyshim por edhe inspektorët, policia edhe krejt bashke.

Fehmi Hoxha – Unë kam një shqetësim e për të vazhduar menjëherë me pyetjen për kryetarin. Para një viti e gjysme keni ndërmarrë një iniciativë edhe keni ftuar të gjithë inxhinierët e komunës së Rahovecit të ndërtimit të të gjitha profileve, gjë që unë sinjerisht ju kam përgëzuar për atë iniciativë që e keni marrë, për me bo një zgjidhje të qëndrueshme për qytetin e Rahovecit për trajtimin e ujerave atmosferike dhe ujërave të zeza. Tani këto ditë keni filluar në renovimin e asfaltit në qytet pa e bërë zgjidhjen e qëndrueshme siç edhe keni premtuar që do ta bëni për trajtimin e ujerave të zeza dhe ujerave atmosferike. Tani po shpenzojmë kinse ne renovimin me një kosto të madhe e që nuk është e vogël dhe përsëri do të vjen koha që vitin e ardhshëm po besoj që prishet asfalti dhe të trajtohet. A keni bërë ndonjë plan se si po e bëni këtë pasi sinjerisht ju kam përgëzuar si ide atëherë mirëpo tani po e shoh se nuk po bëhet ashtu siç keni premtuar dhe po bëhet arnimi në qytet të Rahovecit. Faleminderit shumë!

Kryetari – Ne kemi një kontratë për riparimin e gropave, riparimin e zonave të dëmtuara në qytet. Është një kontratë që fatbardhësisht e kemi prej kohës së qeverisjes së Idriz Vehapit edhe ne nuk kemi një buxhet të mjaftueshëm aty. Është e vërtetë se i kam takuar afërsisht 20 inxhinierë dhe arkitekt edhe kemi pasur një takim me ata. Të gjithë këta nuk është se kanë sjellë ndonjë zgjidhje përveç dy apo tre vetëve që kanë sjellë edhe ka pasur mospërputhje të ideve koncepteve apo propozimeve që i kanë marr edhe kanë ardh te një konkluzë se rruga prej LAB-oil e teposhtë duhet të bëhet një kanal me vlerë prej 450,000 euro e deri te stacioni i autobusëve edhe me u lidhë me lumin Dullo dhe pastaj më krijuar disa veprime tjera për me i qu ujërat e shiut dhe po ashtu edhe ujërat e zeza që pastaj me i dërguar te lumi Rimnik në Fortesë e më pastaj në Drinin e Bardhë. Tani ne jemi dakorduar që të gërryhet asfalti të rregullohen mirëfilli i pusetave dhe të shikohet si është gjendja e tyre nën asfalt tek bazamenti i tyre sepse vazhdimisht po i fundos edhe me i riparuar të gjitha ato dhe po ashtu të bëjmë një bajpas nga Lab-oil për tek lumi Dullo pra një kanal shtesë me gypa dhe një pjesë të ujit ta shkarkojmë atje pasi edhe nuk jemi jashtë ideve që kanë dhënë inxhinieret pasi kjo ishte edhe ide e kahershme nga inxhinieret po ashtu edhe nga drejtori i Shërbimeve Publike e ka përmend, po ashtu edhe Rasimi disa herë e ka ngritë si çështje për këto gropa të cilat krijohen pasi vazhdimisht na kanë krijuar probleme dhe tash kemi vendos me i rregullua mirë pusetat, me i këqyrë që mos është shpërthye ndonjë gyp në tokë, me i pastrua ata gypa pasi e dimë se është një gyp i madhe aty në rrugën kryesore që me siguri është vendos qysh para luftës me gjasë, dhe tash kur i kanë lidhë ujërat e zeza me ujërat e shiut edhe janë përzije qytetarët që kanë tentuar me bo zgjidhje aty për aty dhe tash janë mbushë me gurë edhe me mbeturina me drunjtë e shumëçka dhe tash duhet me angazhua kompaninë rajonale të ujësjellësit, Gjakova,, edhe sigurisht bashkë me ne që ta pastrojmë edhe nëse ka ndonjë defekt me riparua edhe me i shtrua 7cm asfalt edhe me i nivelizuar krejt. Pra, bajpasi behët, asfalti prej udhëkryqit atje e deri te rruga kryesore kam vendosur me trajtue sivjet dhe mundësisht po përpiqem me krye para se me ardhë mërgimtarët, jo pse duhet me u lidh me mërgimtarët por për shkak se janë krijuar disa gropa edhe vazhdimisht duke vendos beton, përsëri po dëmtohen dhe ne po duam me trajtua këtë problem dhe po mendojmë se është një zgjidhje për një periudhe kohore mbi 10 vjet. Por zgjidhja me e mirë është me livrua rrugën kryesore krejt edhe me trajtua nga fillimi gjithçka mirëpo tani për tani po bëjmë ta pamundurën që me evitua problemet që po na shfaqen si asfaltim me 7cm trashësi, shenjëzim horizontal dhe vertikal, bajpas, rregullim dhe standardizim të pusetave dhe unë besoj që ka me marr një pamje pak më të mirë edhe

qyteti edhe do të jemi më të kënaqur por a është kjo zgjidhje e përhershme, nuk jam shumë i sigurt por meqenëse tash e kemi në plan edhe Sheshin Qendror bashkë me UN-Habitatin po ashtu e kemi në plan me i krijua edhe disa parkingje edhe me i evituar disa ujëra që krijohen te Palestra edhe sigurisht që fillojnë me u zvogëlue ujërat në disa rrugë po ashtu edhe ujërat që krijohen në rrugën transite me 3 korsi që do të bëhet e njohur si rruga e UÇK-së pra fillojnë me u zvogëlue ujërat në qytet dhe po ashtu fillon me u stabilizue qyteti me një asfalt të mirë dhe puseta të standardizuara me pastrim të gypave dhe një bajpas, pra ky është thelbi kurse për detaje definitivisht mundeni me ardhë të drejtori i shërbimeve publike po ashtu me u konsultue edhe me inxhinieret se çfarë po mendojnë këta. Ne nuk po duam me bo menjëherë gërryerjen por pjesë pjesë pra sot ka filluar gërryerja nga semaforët e teposhtë edhe njëkohësisht ka filluar rregullimi i pusetave nga semaforët e deri në qendër. Unë mendoj se ka me u bë një zgjidhje e mirë se paku në planin afatmesëm e qëndrueshëm.

Munib Durguti – Faleminderit kryesues, unë nuk e kisha në plan të ndërlihdëm por informata e kryetarit dha një shqetësim për këtë bajpas që do të ketë kyçje të ujërave atmosferike te lumi Dullo te parku i qytetit. Unë shume herë e kam ngritë shqetësimin që shtrati i lumit nuk ka mirëmbajtje për shume vite, vitin e kaluar ka pasur një gërryerje një pastrim sipërfaqësor edhe ajo na ka shpëtuar prej përmbytjeve mirëpo në kushte normale dhe kur shtrati i lumit është i pastër kur kemi reshje atmosferike përsëri uji del prej shtratit të lumit. Pra rruga Xhelal Hajda krijohet një bajpas në ato ujëra dhe shkojnë në lumin Dullo, pa u trajtuar rishtas ky lum ky është mesazh shumë i keq dhe për banorët e lagjes kjo nënkupton përmbytje dhe kurrgjë tjetër, pasi shtrati i lumit është shumë i vogël dhe nuk ka me përballua në asnjë rrethanë sjelljen e ujërave deri aty. Faleminderit.

Kryetari – Unë e kuptoj shqetësimin Munib, por problemi është se tash kemi edhe kontratë për intervenime emergjente. Të shohim se dikush që është larg vëmendjes edhe trajtimi i shtratit të lumit Dullo ndoshta edhe do të bëhet edhe ndonjë përshkallëzim pra nuk bëhet fjalë për zgjidhje të një problemi edhe zhvendosje të atij problemi ne një pjesë tjetër. Ne po flasim për një zgjidhje e cila natyrshëm që e rritë vëllimin e ujit në pjesën ku vjen edhe ajo ndodh zakonisht gjatë reshjeve edhe sigurisht që vërshimet ndodhin gjatë reshjeve sepse kur nuk ka reshje është normale. Ne kemi në plan trajtimin e lumit Dullo madje edhe zgjatjen pasi e dimë se çka ndikon që me u frye dhe mu bo pengesë, që përveç shtratit kur është bërë kalkulimi atëherë i projektuesit, vëllimin e ujit e ka matë te ajo ura aty edhe nëse thelbi i shpjegimit i projektuesve atëherë dhe nëse ka pasur ndonjëherë vërshime potenciale, rreziku është tash shume me i vogël me pas vërshime sepse ne e masim me këtë urë dhe nëse duam me ndërrua urën krejt dhe me rrit perimetrin e urës atëherë kjo zgjidhje e bajpasit por nuk është që do të bëhet pa e përfill edhe atë shqetësimin që unë e di edhe me herët, që ndoshta edhe duhet me u thellua shtrati apo ndoshta duhet me u bo edhe kaskada apo të zgjerohet gryka pra ne kemi njëkohësisht edhe dy kompani emergjente pasi është e ndarë në lote, apo që është nevoja me ngritë ndonjë mur pra kanë me qenë detaje që kanë me qenë pjesë ndoshta jo në kontratën për riparim por ne do ta ndërlihdim me kontrata tjera sepse nuk jemi të interesuar me sjellë ujin dhe me pas problem tjera në mallra amvisëri ekonomi. Pra jemi të interesuar me i bo një zgjidhje problemit edhe me bajpas edhe problemi që potencialisht shkaktohet dhe kur të vjen kompania dhe fillojmë me trajtua atë pjesë unë kam me qenë dëshmitar edhe me banoret e lagjes që çka duhet me bo aty që mos me u grumbullua edhe mos me ju krijuar problem uji.

Kryesuesi – Faleminderit Kryetar, të nderuar kuvendarë, kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për bartjen e tejkalimit të të hyrave vetanake nga viti 2019.

Afrim Limani – I nderuar kryesues, kryetar, nënkryetar, kuvendarë dhe gjithë ju të pranishmit në sallë. Në fakt kjo pikë e rendit të ditës, siç e dini të gjithë ka kaluar në muajin janar mirëpo arsyeja se pse ka ardhë edhe njëherë në Kuvend është sepse departamenti i buxhetit në kuadër të Ministrisë së Financave, faktikisht

nuk na kanë aprovuar këtë vendim me arsyetimin sepse titulli i këtij vendimi ka qenë vendim mbi tejkalimin e të hyrave. Ndërsa tash na duhet sipas rekomandimit të tyre duhet të shkruhet vendim mbi bartjen e tejkalimit të hyrave dhe realisht është shuma e njëjtë e tejkalimit të të hyrave me vlerë 139,750 euro edhe këtë shume është i njëjti dokument të cilën në janar që e kemi shpërndarë në projekte të caktuara. Pra, është projekti në kuadër të drejtorisë për Arsim për ngrohje qendrore nëpër shkollat e komunës së Rahovecit 36,000 euro pastaj Ndërtimi i sistemit të ujësjellësit në komunën e Rahovecit 20,000 euro, Ndërtimi qendrës kryesore të mjekësisë familjare 61,750,37 euro edhe Investimi në Zonën Ekonomike në Opterushë 22,000 euro. Pra kjo është arsyeja se pse ka ardhë edhe njëherë në Kuvendë. Faleminderit!

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues, edhe drejtori e tha që njëherë kemi marr vendim për këtë çështje mirëpo për shkak se është i punuar keq edhe ata e kanë kthyer dhe nuk e di që vendimin që e kemi marr a duhet edhe njëherë me anulua atë vendim për me marr vendim të ri. Por vetëm desha me u ndërlidh me atë që është mirë me u krijuar praktikë e mirë, që drejtorët para se me i sjellë këtu materialet pra pikat e rendit të ditës, duhet me i shqyrtua mirë edhe mos me ardhë momenti që me na kthye qoftë MAPL-ja apo Ministria në këtë rast e Financave, se në të njëjtin rast përveç kësaj pike e kemi edhe pikën tjetër për odën në Radoste që do të ndërtohet atje e kështu që me qenë me te vëmendshëm do të ishte më mirë dhe mos me u përsërit këto lëshime. Faleminderit!

Kryetari – Këtu ka gjuhëtar dhe njerëz me përvojë që mundet dikush me ma përkthye vendim për bartjen e tejkalimit të të hyrave vetanake nga viti 2019, unë mendoj se ata kanë gabua e jo na, ndoshta mundet me qenë vendim për bartjen e të hyrave vetanake të tejkaluara por kjo si fjali, unë nuk jam gjuhëtar por me sa marr vesh unë asnjë kuptim nuk e ka. Ata të departamentit të buxhetit për komunat në momentin kur e kalojmë ne, unë do të ju shkruaj një letër për këtë fjali vendim për bartje të tejkalimit nuk e kuptoj. Bartja e të hyrave vetanake të tejkaluara ose që kanë dalë jashtë planit mundet ama bartje e tejkalimit nuk e kisha dëgjuar ndonjëherë. Pra, nëse ata kanë pasur vërejtje në titull që se kemi përmendur të hyra vetanake të tejkaluara pajtohem por nëse ky titull duhet me u kon vendim, unë do t'i shkruaj një letër edhe me ditë se çfarë vendimi është, këtu ka gjuhëtarë edhe juristë, unë mendoj se s'ka kuptim kjo fjali.

Afrim Limani – Unë deshta vetëm një arsyetim, unë personalisht në cilësinë e drejtorit për Buxhet dhe Financa kam pasur përvojë edhe më herët të natyrës së tillë, edhe para këtij mandati nëse tejkalohej të hyrat e planifikuara do të thotë kemi fjalën për tejkalim të të hyrave. Tash, te çështja e bartjes së të hyrave do të thotë se kemi pasur debate të shumta me departamentin e buxhetit e Ministrisë së Financave mirëpo tash prapë sipas sugjerimeve të tyre prapë duhet të shkruhet bartja. Ne kemi tejkalim mirëpo njëherit duhet të behet bartja e këtyre të hyrave. Te them të drejtën sinqerisht nuk e kam ditur edhe tash unë e kam praktikua përvojën të viteve të kaluar edhe e kemi shkruar tejkalim mirëpo s'kemi çka bëjmë edhe duhet me i zbatua rekomandimet e tyre, kjo është arsyetimi. Faleminderit.

Fehmi Cena – Kur jemi te kjo pike e rendit të ditës, te vendimi për bartje të hyrave vetanake nga viti 2019 ne vitin 2020, dua të ndërlidhem me pikën 3.3 faqja e parë të shëndetësia është ndarë, propozimi është një shumë 61,750 euro për ndërtimin e objektit të ri të QKMF-së, dhe mua po më intereson me ditë me këtë buxhete, a do të kryhen punimet në atë objekt apo do të ketë nevojë edhe më tepër që të punohet përafërsisht kur ai objekt do të hapet apo të jetësohet, a do të ketë me shumë buxhet për renovime apo me këto do të kryhet. Faleminderit!

Kryetari – Në korrik po shpresojmë që të hapet objekti i ri i QKMF-së, me gjasë përmbillet kontrata me këtë operator edhe objekti lëshohet në funksion sipas asaj qysh jemi dakorduar në korrik.

Munib Durguti – Pyetja për drejtorin, së a është vendimi i njëjtë që i ndryshon vetëm titulli apo kemi edhe ndryshime tjera pra vetëm një sqarim.

Dervish Çadraku – Përshëndetje për të gjithë, edhe unë pajtohem me parafolësit se çfarë u fol deri me tani për këtë rend të ditës por kam një vërejtje për të cilën ne kemi marr vendim qysh ne janar për këtë pikë, por të them të vërtetën ja 3 apo 4 herë kam qenë në Qendër Kryesore të Mjekësisë Familjare për me bo analiza edhe deri sa ka qenë pa u mbyll nga pandemia, nuk ka pasur reagenca dhe nuk ka pasur material për laboratorin e analizave. Këtu në pikën 3.3 keni ndaje 61,750 euro për me rregullua emergjencën që është shume e rëndësishme, po ashtu edhe këto mjete tjera që i keni shpërndarë po aq të rëndësishme janë për me i krye këto punë por megjithatë, meqenëse veç na ka ardh material, a kemi mundësi me ndryshuar destinacionin se qytetaret shkojnë atje edhe s'kanë mundësi një kategori e tyre me i bo analizat edhe me ble material pra nja 4 apo 5 here sa kam shkuar nuk ka pas material edhe disa herë e kam tërheq vëmendjen këtu që të kemi kujdes sepse nuk kemi material edhe me llogarit që me i ndarë disa mjete nga këtu. Faleminderit!

Kryesuesi – Faleminderit z. Çadraku, atëherë të nderuar kolegë, meqë nuk ka tjerë të lajmëruar, e qesim në votim edhe pikën e tretë të rendit të ditës. Konstatoj se unanimisht aprovohet pika e tretë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatgjatë.

Afrim Oruqi – Faleminderit kryesues, i nderuar kryetar, nënkryetar, anëtarë të kuvendit komunal dhe gjithë ju të pranishmit. Para jush e keni një vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës publike, të njëjtin vendim e kemi pasur edhe me përpara në muajin Mars edhe pse e kemi marr ligjshmërinë prej MAPL-së për këtë vendim. Sipas kërkesës se këshillit të fshatit Malësi e Vogël ne kemi vendosur që bashke me juve që të ndajmë një sipërfaqe për ndërtimin e një objekti i cili do të shërbej interesave të përgjithshme të këtij komuniteti mirëpo për arsye teknike në bashkëpunim me Urbanizmin, Shërbimet Publike dhe Drejtorinë Bujqësisë e kemi vlerësuar që sipërfaqen e njëjtë prej 7 ari e disa metra katror të i marrim prej 3 parcelave e jo prej një parcele për shkak se në atë zone atje ku veçse ka filluar ndërtimi i një objekti për interes të përgjithshëm që mos me rrezikua që në të ardhmen me zgjerua rrugën Malësi e Vogël-Ratkoc që mos me rrezikua e me vazhdua edhe me zgjerua një kanal të ujërave po ashtu edhe rrugët dytësorë që kalojnë përkaj këtyre parcelave, kemi vendosur që të marrim këtë sipërfaqe të njëjtë prej 7ari e 69m² ne 3 parcela që te gjitha janë zonë kadastrale në Malësi të Vogël te cilat janë prona shtetërore të Kosovës me numër 319/1,1646/0 dhe 303/0 ku pjesës së parë i merren 136m², të dytës 56m² dhe parcelës se tretë i merren 577m², që të gjitha këto se bashku bëjnë 7 ari 69m². Qëllimi i këtij vendimi për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite është që të jepet në shfrytëzim këshillit të fshatit Malësi e Vogël për interesa të përgjithshme për ndërtimin e një objekti i cili do të shërbej në zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe të tjera. Pronat e cekura me lartë në shfrytëzim jepen për 99 vite pa kompensim. Komuna e Rahovecit do të kujdeset që të krijojë një kontratë ku do t'i pamundësohet e drejta tjetërsimit të pronarit prej një pronari në pronarin tjetër. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi që e keni para jush shfuqizohet vendimi me numër 01/57/20 të datës 30.03.2020. Ftoj kuvendarët që pas shqyrtimit të aprovojnë vendimin për dhënien në shfrytëzim afatgjatë.

Sali Sallteku – Faleminderit kryesues, unë po flas rreth asaj që vërtet në aspektin material është një shumë e madhe pasi e dimë se nuk është e lehtë me i grumbullua 50,000 euro, mirëpo në këtë rast duhet që edhe komuna të merr pjesë në bashkëfinancim se paku me 20% kurse shuma prej 80% i takon banorëve të fshatit. Sigurisht me këtë shumë do të ju jepet përkrahje qytetareve pasi janë duke bërë një punë të madhe dhe të mirë aty dhe sigurisht që Kryetari duhet ta ketë parasysh këtë por është mirë bile 20%. Pra nga shuma prej 50,000 eurove që është gjithsej, të paktën 10,000 të merr pjesë komuna. Tash nuk e di sa do të këtë mundësi komuna të participon rreth kësaj mirëpo megjithatë është mirë me marr parasysh këtë sepse ka qenë një vullnet i madh pasi nëse bazohemi nga ajo që që zakonisht e ka praktikuar komuna apo qeveria

për participim 80% me 20% atëherë në këtë rast është e kundërta pra 80% financon banorët e fshatit Malësi e Vogël kurse 20% të participon komuna. Faleminderit!

Fehmi Hoxha – Unë po e shoh një gabim këtu në hartimin e këtij vendimi për dhënien e pronës afatgjate. Miratohet vendimi i kryetarit të Komunës por duhet të jetë miratohet propozim vendimi i kryetarit të komunës me numër 02/371/20 të datës 10.03.2020, pra, duhet të shkruhet propozim vendim dhe merret vendimi paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim personave fizik dhe juridik në shfrytëzim afatgjatë nga 15 deri 99 vite, duhet të shkruhet dhe të merret vendimi i pronës komunale sipas propozim vendimit të kryetarit në shfrytëzim afatgjatë deri 99 vite. Pra, e kemi afatshkurtër deri 15 vite, afatmesëm deri 35 ose 40 dhe afatgjatë deri 99 vite. Si vendim do të thotë tekstualisht të përmisohet afatgjatë 99 vjet. Faleminderit!

Isak Hoti – Përshëndetje kryesues dhe juve delegatë të nderuar. Ky është propozim i kryetarit të komunës dhe kur ka ardhur e kemi pasur edhe propozimin prezent edhe ne nuk mundemi me thanë ndryshe në vendim pos që miratohet propozimi i kryetarit. Unë në dokumentin tim e kam propozimin e kryetarit të komunës kurse te ju me siguri është ndonjë lëshim teknik, edhe te neni 40 i ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme komunale i specifikon këto çështje të cilat ne nuk guxojmë me dal jashtë kësaj p.sh. kur thotë ne afatgjatë sepse janë dy lloje, nga 1-15 e kemi afatshkurtër dhe nga 15 – 99 është afatgjatë. Edhe ne këtë rast ne jemi të obliguar me qenë konformë për shkak se te propozimet shpesh po na ndodhë që po hasim në të njëjtin problem edhe Rasim Fazliu shpesh e ka ngritë të njëjtën çështje, pasi ato çka janë brenda me ligje nuk guxojnë me dal jashtë asaj. Po ashtu edhe te vendimi paraprak jemi të obliguar me than vendim paraprak deri ne konfirmimin e ligjshmërisë të aktit nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pra këto janë çështje te rregulluara me ligj dhe besoj që jemi të qartë. Faleminderit shumë!

Fatmir Iska – Faleminderit kryesues, të nderuar kuvendarë, përshëndetje për të gjithë. Unë veç desha të përgjigjem meqenëse kryetari nuk është për momentin, rreth ndërtimit të odës në fshatin Malësi e Vogël. Unë po e citoj kërkesën e kryetarit të fshatit: „kërkojmë që të na lejohet dhe të na mundësohet të ndërtojmë me paratë e tona në parcelën e komunës,„. Kështu që nuk keni kërkuar mjete prej komunës edhe ne e kemi respektuar ne maksimum kërkesën tuaj. Faleminderit!

Sali Sallteku – Unë e kam lexuar kërkesën që e ka shkruar kryetari i fshatit, ndoshta edhe nuk e ka formuluar në mënyrën e duhur. Është mirë që mos me u marr me atë që ka shkruar ai por duhet ta kuptoni me realisht këtë kërkesë edhe të ja përcjellni këtë kryetarit edhe të merr përgjegjësi rreth kësaj që ta paguan të paktën 10% të shumës. Faleminderit shumë!

Kryesuesi - Faleminderit shume z. Sallteku, atëherë të nderuar kuvendarë meqë nuk kemi tjerë të lajmëruar, e qesim në votim pikën e katërt të rendit të ditës. Konstatoj se unanimisht kalon pika e katërt e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për dhënien e pronës së paluajtshme – lokaleve afariste të Komunës në shfrytëzim personave juridik.

Artan Asllani – Faleminderit kryesues, përshëndetje për te gjithë. Para jush e keni propozim vendimin për dhënien në shfrytëzim të lokaleve afariste komunale që kryesisht janë 20 lokale, që deri me tani kanë qenë në shfrytëzim nga personat juridik dhe fizik ndërsa mund të ju them se para vetes keni të specifikuar numrin e parcelave dhe hapësirën e këtyre lokaleve, ku 18 prej tyre gjinden në zonën kadastrale në Rahovec në rrugën Xhelal Hajda dhe Avdullah Bugari kurse 2 prej tyre gjinden në fshatin Xerxe konkretisht te depot e Matrex-it. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës, lokalet afariste të cekura në pikën 1,2,3,4 të këtij propozimi, është ruajtja dhe rritja e vlerës së aseteve komunale dhe njëkohësisht edhe ju jepet mundësia të gjitha bizneseve komunale të ushtrojnë veprimtarinë e tyre në këtë hapësirë të këtyre lokaleve. Komuna e Rahovecit e ruan të drejtën kurdoherë sipas nevojës

dhe realizimit të interesave publike të komunës të ndryshoj kontratën e përfituesit për dhënien në shfrytëzim. Ndërsa për procedurën për dhënien në shfrytëzim të pronës se paluajtshme për shfrytëzim afatshkurtër realizohet përmes ankandit publik. Pres nga kuvendaret që të votojnë këtë propozim vendim. Faleminderit!

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues, edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa e kemi shqyrtuar këtë pikë të rendit të ditës për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme komunale gjegjësisht lokaleve afariste që gjenden në territorin e komunës së Rahovecit në përgjithësi. Në mbledhjen e KPF-se unë kam parashtruar pyetjen që në këtë listë, a janë të përfshira të gjitha pronat gjegjësisht lokalet që ju ka kaluar afati i kontratës dhe kam marr përgjigje prej drejtorit se të gjitha janë të përfshira dhe nuk ka lokale tjera që ju ka kaluar kontrata e që nuk janë të përfshira në këtë listë mirëpo ajo çka desha tash të përkujtoj është se këto lokale afariste që kanë operuar deri tash, po më intereson a i kanë kryer obligimet të gjitha ndaj komunës deri në çastin për me shpall në ankand publik këtë punë, pra, i kanë kryer obligimet dhe nëse i kanë kryer obligimet, atëherë unë mendoj se ankandi është i qartë dhe nuk i jep përparësi askujt por do të ishte mirë që në një mënyrë apo tjetër me ju dhanë mundësi që të paktën me vazhdua punën këta pra thash për të gjithë ata që i kanë kryer obligimet ndaj komunës dhe kanë qenë të përgjegjshëm ndaj komunës. Faleminderit!

Fehmi Hoxha – Është mirë që ka ardhur ky propozim vendim i kryetarit për të diskutuar dhe ndërlidhet me lokalet komunale që i shfrytëzojnë pra janë bizneset e vogla artizanate. Unë do të ndërlidhem por paraprakisht drejtori është këtu, e pash në diskutim e sipër edhe në debat, që është munduar me u bo një ditë këtu edhe në këtë kohë të pandemisë që nuk më ka pëlqyer fare, për rregulloren për taksa dhe tarifa. Edhe aty ne paraprakisht para se të shkoj rregullorja, kemi marr vendim për lokalet ekzistuese ka 2 (dy) euro kemi marr vendim e jo për 4 (katër) euro edhe pse aty figuron përsëri 4 (katër) euro që me siguri është ndonjë gabim teknik kurse për lokalet të Palestra Sportivë 4 (katër) euro. Pra edhe me kërkesë që unë e kam propozuar e që e ka mbështetur edhe kryetari kemi marr vendim për shumën 2 (dy) euro por që tani figuron 4 (katër) euro dhe që me siguri është gabim edhe që duhet të përmirësohet dhe këto do t'i japim sipas rregullores ekzistuese që e kemi ka 2 (dy) euro. Edhe unë propozoj pasi që çdo vit edhe kuvendarët merren me këtë punë edhe ekzekutivi si dhe ata që merren me biznese që çdo vit të hapet ky ankand dhe propozoj në bazë të ligjit që është afatshkurtër deri në 15 vjet, që të shpallet ankandi për me ju dhanë bizneseve këto lokale deri në 15 vjet e jo për një vit qysh e kemi pasur deri tash. Pra, kemi mundësi 1-15 vjet të ju japim pra propozimi im është të ju japim deri në 15 vjet edhe të ndjekim procedurat e rregullta ligjore që janë përmes ankandit. Faleminderit shumë!

Munib Durguti – Faleminderit kryesues, unë e mbështes propozimin që përcaktohet për këto lokale, meqenëse numri i lokaleve nuk është i madhe siç e dha sqarimin drejtori në fjalë mirëpo ajo që desha me potencuar meqenëse ky material është shqyrtuar prej Komitetit për Politike dhe Financa. Do të ishte mirë që këso raste për dhënie në shfrytëzim qoftë pronë e paluajtshme, të dalin me një propozim të kuvendit p.sh. 1 deri 15 pra në këtë rast 15 vite si rekomandim nga Komiteti për Politike dhe Financa, pasi shumë rrallë na vjen ndonjë rekomandim nga Komiteti por vetëm po e kuptojmë se është shqyrtuar edhe atje. Tash prej atij shqyrtimi është mirë me dal edhe një rekomandim. Ne e kuptojmë se vendim nuk mundemi me marrë pasi është Kuvendi ai që merr vendim mirëpo në atë Komitet secili subjekt e ka përfaqësuesin e vet dhe e ka mandatin që në emër të subjektit del edhe me rekomandimin, kështu që në këtë mënyrë do ta thjeshtësojë edhe seancën e Kuvendit edhe diskutimet e mundshme në seancë. Përndryshe unë e mbështes propozimin për shfrytëzimin deri në 15 vjet. Faleminderit shumë.

Fehmi Cena - Unë mendoj që në kuvendaret duhet të jemi të pajtimt që kur është në pyetje prona shtetërore që të jepet në shfrytëzim qytetarëve tanë, pra, duhet të jemi gjithmonë pro kësaj sepse është edhe

në interesin e qytetareve që të ushtrojnë veprimtari, që hapen vende të reja të punës dhe njëkohësisht edhe për komunën sepse arkëtohen të hyra dhe në këtë rast jemi që këto lokale afariste të jepen. Pajtohem edhe me shqetësimin e parafolëseve rreth obligimeve që i kanë kryer, pasi është një element shumë i rëndësishëm, se a i kanë kryer apo nuk i kanë kryer, mendoj që kur ato do të jepen në ankand publik, unë mendoj që njeri prej kriterëve kryesore pikërisht duhet të jetë kjo pasi që ata që i kryejnë obligimet apo që i kanë kryer, sigurisht që kanë edhe përparësi, të vazhdojnë ta ushtrojnë veprimtarinë e tyre. Përndryshe, sa i përket asaj rreth afatit, ne si Komitet për Politike dhe Financa kemi shqyrtuar këtë pikë dhe në njëfarë mënyre jemi dakorduar të gjithë me qenë sikurse në tekst që është aty për 10 vite. Ky është propozimi i ri, natyrisht që delegatet kanë të drejtë me dhanë propozime por duhet të ketë edhe një arsyeshmëri që ne pastaj të ndryshojmë atë vendimin që kemi pasur, se në njëfarë mënyre ne ju përfaqësojmë juve, kemi ra dakord për këtë, po ashtu është arsyetuar në njëfarë mënyre 10 vjeteshin tash shqyrtohet 15 - vjeteshin se a do të bëjmë kështu apo ashtu. Si do qoftë ne jemi dakorduar që të jetë 10 vjet.

Rasim Fazliu – Unë desha të jem i sinqertë, drejtori në mbledhjen e KPF-së kur e ka sjellë vendimin, e kishte cekur aty 10 vite afat. Edhe unë mandej si anëtarë i KPF-së e kam dhënë vërejtjen time, pasi jemi ne ata që e caktojmë afatin e jo ju sigurisht në mënyrë kolegjiale edhe tani drejtori nuk e ka shkruaj, vetëm e ka cekur në bazë të ankandit prej 1-15 d.m.th. në KPF na ka ardh për 10 vite mirëpo unë i kam dhënë vërejtje drejtorit se ti nuk mundesh me caktua afatin por ne jemi ata që e caktojmë. Por, tash nuk na prish punë neve, dakordohemi të gjithë si është më së miri, ky është propozimi i z. Fehmi Hoxhës për 15 vite dhe nëse të gjithë mendoni se është mirë atëherë i japim për 15 vite, por, shumica duhet të vendosim dhe të dakordohemi por në KPF nuk kemi thënë për 10 vite por vetëm ka qenë propozim i drejtorit. Faleminderit!

Rukije Krasniqi – Faleminderit kryesues, lidhur me pronat e bizneseve të cilët janë komunale, nëse i caktojmë një afat 15 vjeçar atëherë çka nëse biznesi dështon, kur dihet se afatin e ka 15 vjet do të thotë me ja zgjat afatin. Atëherë çka ndodh me atë biznes, me atë pronë komunale, a e lëshon pronari që e ka biznesin me qera apo i kalon drejtpërdrejt komunës. Faleminderit.

Kryesuesi – Faleminderit shumë zonja Krasniqi, pra është vërtet se në mbledhje të KPF-së ka ardhur si propozim prej drejtorit deri në 10 vite, që ndoshta edhe ky i ka planifikuar ato arsytet e veta, gjithsesi sot e patëm edhe një propozim tjetër nga asambleisti z. Fehmi Hoxha që propozoi për 15 vite.

Fatmir Iska – Faleminderit Rukije, për më shumë përgjigjen e ke, nëse e keni lexuar vendimin e që ndoshta edhe nuk e keni lexuar, në pikën 8 edhe thotë kështu: Prona e paluajtshme në fjalë nuk e ndërron titullarin juridik, pronari i saj në këtë rast Kuvendi Komunal i Rahovecit dhe si e tillë ajo nuk mund t'i jepet personit të tretë në shfrytëzim pra kjo është esenca.

Kryesuesi – Atëherë faleminderit shumë të nderuar kolegë kuvendarë, e qesim ne votim pikën e pestë të rendit të ditës, për dhënien në shfrytëzim për 10 vite. Konstatoj se me 3 abstenime aprovohet pika e pestë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e gjashtë të rendit të ditës:

6. Shqyrtimi i raportit të DKA-së për ecurinë e zhvillimit të mësimin online/ në distancë.

Avni Morina – Faleminderit kryesues, i nderuar kryetar, nënkryetar, drejtorë, kuvendarë të nderuar dhe gjithë ju të pranishëm në sallë. Unë kam përgatitur një raport që përfshin një periudhë 2-mujore pra nga 12 marsi deri me 12 maj të këtij viti, që është në kuadër të aktiviteteve që ka pasur DKA-ja dhe shkollat gjatë periudhës së pandemisë. Sikur në të gjitha komunat e Kosovës ashtu edhe në komunën tonë, pas rrethanave të jashtëzakonshme të krijuara për shkak të përhapjes së pandemisë COVID-19, edhe në komunën tonë filluam të angazhohemi t'i zbatojmë rekomandimet e MASHTI-t për mësimin në distancë/online. Në bazë të raporteve të SHFMU-ve dhe SHML-ve, të komunës së Rahovecit, në periudhën prej 12 marsit 2020 mësimi online është realizuar në nivel jo mjaftueshëm të kënaqshëm, marrë për bazë faktin se një sistem i tillë mësimi është realizuar për herë të parë dhe në rrethana të jashtëzakonshme. Gjatë kontakteve që kemi pasur me drejtues të shkollave dhe me numër të madh të mësimitdhënësve, kjo sfidë fillimisht është pritur

me skepticizëm dhe rezerva, por me angazhimin e DKA-së dhe drejtorëve të shkollave e sidomos të koordinatorëve të cilësisë, ky skepticizëm është kthyer në angazhim të madh duke e dhënë kontributin e tyre shumica e mësimitdhënësve. Kjo punë është fuqizuar me krijimin e grupeve të klasave nga ku mësimitdhënësit kanë përcjellur angazhimin e nxënësve përmes detyrave të dhëna gjatë mësimit online, por edhe aktiviteteve të mësimitdhënësve në klasat e tyre dhe lëndët e caktuara. Njëra ndër sfidat sipas mësimitdhënësve ka qenë mungesa e pajisjeve teknologjike nga një numër i nxënësve me theks të veçantë me nxënës të familjeve si raste sociale dhe të komuniteteve RAE. Megjithatë, mësimitdhënësit nga shkollat tona kanë evidenca të sakta për secilin nxënës dhe mësimitdhënës dhe këto evidenca do të na shërbejnë edhe për procesin e vlerësimit të nxënësve, bazuar në U.A të MASHTI-it.

Të dhënat e mëposhtme për angazhimin e mësimitdhënësve dhe nxënësve në procesin e mësimit online, për aplikacionet që ata i kanë përdorur, për numrin e orëve të mbajtura, për lëndët mësimore dhe për sfidat e vështirësitë që kemi pasur, janë paraqitur në mënyrë tabelare për të gjitha shkollat dhe për të gjitha nivelet. Këtu në raport e keni tabelën, ky është një dokument voluminoz sepse ka të dhëna për të gjitha shkollat e Komunës dhe në këtë tabelë unë po i paraqes sipas shtyllave të dhënat që i kemi paraqit për secilën shkollë. Në shtyllën e parë janë emrat e shkollave, në shtyllën e dytë janë platformat që i kanë përdorë mësimitdhënësit dhe nxënësit, në shtyllën e tretë është numri total i nxënësve në shkollë që janë në secilën shkollë, në shtyllën e katërt është numri i nxënësve të angazhuar, në shtyllën e pestë është numri i mësimitdhënësve në nivelin përkatës të angazhuar dhe në shtyllën e gjashtë është numri i orëve të mbajtura, lëndët mësimore që ka pasur aktivitete dhe në shtyllën e fundit pra të shtatë ka të bëjë me sfidat, vështirësitë e aplikimit të mësimit online në distancë. Këto tabela fillojnë nga niveli zero që përfshihet nga niveli parashkollor pastaj fillon me nivelet tjera si nga klasa e parë deri të pestën, niveli tjetër është klasa e gjashtë deri të nëntën dhe niveli i fundit është klasa e dhjetë deri në klasën e dymbëdhjetë. Këto janë të dhëna për secilën shkollë, numri i nxënësve dhe numri i arsimtareve të angazhuar dhe lëndët, po ashtu kemi vërejtur se sfidat dhe vështirësitë kryesore të aplikimit të mësimit online kanë qenë shkathtësitë teknologjike nga mësimitdhënësit pra mungesa e shkathtësive teknologjike të disa mësimitdhënës, adaptimi me sfidat e reja si nga nxënësit ashtu edhe nga mësimitdhënësit, pjesëmarrja e nxënësve, vlerësimi që është një prej sfidave kryesore, natyra e lëndëve sepse jo në të gjitha lëndët ka pasur mundësi të zhvillohet mësimi online, mungesa e teknologjisë informative e kështu me radhë. Tek lëndët mësimore jemi munduar që të i përfshimë lëndët kryesore të cilat janë sipas niveleve duke filluar nga gjuha amtare, matematika, gjuhë angleze, liria dhe shoqëria pastaj edhe lëndet tjera ku kemi cekur sipas niveleve, duke filluar nga niveli i shkollës të mesme fillore të ulet në shkollat e mesme të larta janë të përshkruara të gjitha lëndet në të cilat kanë marr pjesë mësimitdhënësit dhe nxënësit e mësimit online. Aty ku ka pasur nevojë me të madhe të lendeve nuk kemi mundur me i përfshije të gjitha në këtë tabelë por i kemi shkruar të tjera sidomos të shkolla e mesme e lartë. Pra në këtë raport që edhe ju e keni, i kemi të gjitha të dhënat për secilën shkollë. Pas analizës që kemi bërë në DKA për angazhimin e mësimitdhënësve dhe lendeve pas këtyre shtyllave, kemi nxjerrë disa përfundime të cilat i kemi në fund këtu, unë këto i kam thënë edhe në mbledhjen e KPF-së por atë ditë nuk i kemi pasur të dhënat për numrin e mësimitdhënësve të paangazhuar në këtë sistem, siç shihet nga tabela gjatë periudhës së pandemisë numri i nxënësve që nuk kanë mundur të përfshihen në mësimin online nga niveli zero deri të klasa e dymbëdhjetë në gjithë komunën është 1674 nxënës ose shprehur në përqindje 17.6% e numrit të përgjithshëm. Sipas të dhënave që i kemi marr nga shkollat, numri i mësimitdhënësve që për arsye të ndryshme nuk kanë mundur të realizojnë mësimin online është 63 mësimitdhënës. Këto të dhëna i kemi marr prej drejtorëve të shkollave, arsyejet e mos përfshirjes janë të ndryshme nga natyra e lendeve që përmenda me herët, mungesa e teknologjisë informative jo vetëm tek nxënësit por edhe të mësimitdhënësit. Ne jemi në bashkëpunim të vazhdueshëm me ministrinë e arsimit dhe

prej 12 marsit kur janë mbyll shkollat dhe fillimi i mësimi online nga televizioni publik e pastaj përmes platformave, kemi qenë vazhdimisht në përputhje me rekomandimet që kemi marr nga MASHT-i. Kemi pasur kërkesa të ndryshme edhe nga shkollat edhe nga mësimdhënësit e nxënësit për furnizim me pajisje teknologjike mirëpo kemi pasur vetëm një ndihme të vogël simbolike, një donacion që MASHT-it i ka dhuruar Elkos që për komunën tonë kanë qenë 13 laptop, prej tyre 2 kanë dal me dëmtime edhe jemi detyruar me i kthye kurse këta 11 i kemi shpërndarë neper shkollat e mesme për nxënësit e shkollave të mesme që kanë pasur nevojë me raste sociale. Pra me këto shqetësime jemi përballur gjatë këtyre ditëve ndoshta ne nuk mund të krahasohemi me Prishtinën sepse atje po raportohet se pjesëmarrja e mësimi online ka qenë afërsisht 95% por realiteti është sipas të dhënave gjithsesi po e theksoj që kam marr nga drejtoret e shkollave në nivel komune mospjesëmarrja është 17.6% që janë të pa përfshirë. Ne kemi pranuar edhe një udhëzues nga Ministria e Arsimit që këtu nuk e kam cekur sepse udhëzuesi nga Ministria e Arsimit ka ardhur pas datës 12 Maj, që sipas të cilit mësimdhënësit do të obligohen që ti vlerësojnë njohuritë e nxënësve edhe ata që kanë marr pjesë në mësimin online edhe atë pjesën tjetër që nuk kanë marr pjesë në mësimin online duke marr parasysh se kjo periudha e fundit është 1/3 e vitit mësimor që me të drejtë u deshtë të jetë 2/3 e vitit mësimor nga Shtatori deri tani dhe që ka mbetur 1/3 dhe duhet gjetur forma në përputhje me udhëzimet që ka dhënë edhe Ministria e Arsimit që mësimdhënësit të i përmbahen atij udhëzuesi dhe të i vlerësojnë nxënësit e tyre sipas këtij udhëzuesi. Siç po shihet nga zhvillimet e deritashme, vetëm në qoftë se brenda këtyre ditëve merret ndonjë vendim që të kthehen të paktën nxënësit brenda dy jave sepse maturanet e kanë krye mësimin online që sipas kalendarit ka përfundua me 20 Maj, vetëm nëse merret ndonjë vendim nga Ministria e Arsimit që do të kthehet përndryshe deri me sot nuk kemi ndonjë vendim që të kthehemi neper shkolla. Veç gati jemi në përfundim sipas kalendarit të procesit mësimor mirëpo ne po presim tash edhe rekomandimet nga MASHT-i dhe do të i zbatojmë ato rekomandime sipas konsultimeve që merren në terenë. Faleminderit për vëmendjen, nëse keni ndonjë pyetje, unë do të jem këtu të ju përgjigjem.

Kryesuesi – Faleminderit shume drejtor për sjelljen e këtij raporti dhe informimin që edhe në komunën tonë, që unë do të i përgëzoj nga këtu të gjithë ata mësimdhënësit që janë angazhuar, sigurisht edhe ata nxënës edhe ata tjerët që nuk janë angazhuar.

Sali Sallteku – Unë konsideroj se mësimi në distancë nuk është mbajtur as 50% për shkak se nuk kanë dashur, sepse ka qenë e pamundur, pasi shumë kush prej familjarëve nuk ka mundësi, bile tash kam menduar që kjo qeveri që shkoi ka lënë shume pasoja të mëdha sepse nëpër fshatra ka pasur mundësi të mbahet edhe mësimi e që ndoshta në qytet ka qenë më e vështirë, edhe tash që kjo qeveri që vjen edhe fillon punën që të paktën dy javë. Tash jam i bindur që ky mësim në distancë ka lënë pasoja shumë të mëdha sepse nuk kemi ende një nivel të tillë për punë. Tani po shpresojmë që të paktën dy javë të mbahet mësimi pasi edhe me formimin e qeverisë së re do të ndërmerren masa për fillimin e mësimi.

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues, unë do të fokusohem kryesisht rreth informatës për dhënien e raportit që na dha drejtori i arsimit të cilin e falënderoj shume. Unë mendoj që në situatën që u gjend Kosova dhe e tërë bota, ka qenë një situatë shumë e rëndë, prandaj, është shumë për t'i vlerësuar edhe Ministrinë e Arsimit edhe drejtorin tonë të arsimit për angazhimin që kanë bërë rreth mbajtjes gjallë të arsimit në Kosovë për gjatë kësaj kohe të shkurt, ku është kryer një punë me të vërtetë shumë e madhe, dikush ndoshta edhe mundet me thënë që nuk ka qenë efektive dhe ne që jemi mësimdhënësit mjafton që nxënësit i kanë përcjellë temat, mësuesi ju ka dhënë detyrat dhe ata me pastaj ka 2-3 orë janë angazhuar rreth kryerjes së atyre detyrave dhe për mua kjo ka qenë një shumë e madhe dhe nuk i ka lejuar që nxënësit me dal jashtë situatës apo me dal rrugëve edhe me bo probleme, prandaj me të vërtetë duhet t'i falënderojmë edhe ministrinë edhe drejtorinë këtu, sepse është kryer një punë e mirë. E sa i përket asaj se sa është nxënë

apo nuk është nxënë, njeherit tek e fundit e dini se edhe në mësimin e rregullt që e kemi mbajtur vazhdimisht kemi pasur gjithmonë vërejtje sepse gjendemi në kohë pandemie edhe nuk ja vlen me cekë atë se sa ka qenë vështirë me punua mirëpo për mua është bërë një punë shumë e madhe kështu që nuk mbetet tjetër përpos me i falënderua edhe këta që kanë bërë organizimin por edhe mësimdhënësit që të gjithë që janë angazhuar në mësimin online. Faleminderit!

Fahrie Lushi – I nderuar kryesues, të nderuar kolegë këshilltar, edhe ne e falënderojmë drejtorin për këtë informatë e cila në saktësinë e saj përfshin gjithë zhvillimin e procesit të mësimin online mirëpo kjo është një përvojë e re për të gjithë e sidomos për prindërit të cilët për mbi 3 ore punojnë pas mësimin online i cili organizohet për vetëm 35 minuta, e kam fjalën për fëmijët e ciklit prej klasës së parë e deri në klasën e pestë ndërsa ajo që është për tu shqetësuar e që vlen për tu përmendur, angazhimi i mësimdhënëseve në këtë proces sepse edhe në KPF e kam përmend këtë dukuri p.sh. e kemi te shkolla “Isa Boletini” dhe unë i kisha sugjerua drejtorit pasi që e kemi përmend numrin total të nxënësve edhe po ashtu edhe numrin e nxënësve të angazhuar, do të kishim përmend përpos numrit të mësimdhënëseve të angazhuar do të kishim vendos këtu edhe numrin e mësimdhënëseve përgjithësi në shkolla pra do të ishte pasqyrë e saktë dhe nuk do të kishte as hapësirë për ndonjë mesazh edhe jo të këndshëm për mësimdhënësit, edhe pse këtu te shkolla “Isa Boletini” prej 1-5 e kemi 23 ndërsa te cikli prej 6-9 e kemi 12 mësimdhënëse. Po e përmendi këtë shkollë por është edhe shkolla tjetër “Bekim Sylka” që te cikli prej 1-5 kemi 10 mësimdhënëse po ashtu te cikli 6-9 kemi 10 mësimdhënëse, janë edhe disa shkolla të tjera dhe do të ishte mirë që ta kemi numrin e mësimdhënëseve të cilët janë në tërësi neper shkolla, nuk dua t’i fyej apo t’i bëj të ndihen keq mësimdhënësit mirëpo nga kjo ne do ta dinim edhe nivelin e arritjes se mësimdhënies nga ky proces i mbajtjes së mësimin online. Faleminderit!

Ali Zhuniqi – Përshëndetje për të gjithë, unë deshta vetëm një replike në lidhje me Sali Salltekun, mendoj se çasja e tij ishte absolut jo konstruktive dhe nuk është mirë me i përzije politikat qendrore me ato lokale, tek e fundit i gjithë menaxhimi që është bërë edhe nga Ministria e Shëndetësisë edhe nga Ministria e Arsimit janë marrë nga direktivat dhe komisionet të cilat janë krijuar prej organizatës botërore të Shëndetësisë në menaxhimin e pandemisë. Kjo ka qenë pandemi globale edhe kisha sugjerua me qenë më konstruktiv në këtë pjesë e aq më pak me komentua edhe protestën në një seancë të tillë, mirë do të ishte me diskutua problemet lidhur me këtë raport që është bërë nga drejtori i arsimit, që ne i dimë se cilat kanë qenë problemet, unë edhe vetë i kam pasur fëmijët e vëllaut që e di edhe komunikimin me arsimtarët që i kanë bërë por është një përvojë e re në gjithë botën dhe nuk është mirë me komentua edhe kisha sugjerua me qenë konstruktiv në lidhje me këtë çështje e aq më pak me përzije edhe pikën e rendit të ditës.

Sali Sallteku – Unë nuk kam asgjë kundër z. Zhuniqi, vetëm se i përmenda gjërat e politikës qendrore e që po ndikojnë në ato lokale. Është diçka që është parë dhe që ka ndikua shume keq në qeverisjen e tij.

Munib Durguti – Faleminderit kryesues, e falënderoj drejtorin e arsimit për sjelljen e kesaj informate rreth zhvillimit të mësimin online gjate kohës se pandemisë dhe të gjithë pajtohemi se ka qenë një sfidë dhe një përvojë e re mirëpo ajo që ka qenë shqetësuese për mua është mos përfshirja e një numri të konsiderueshëm të mësimdhënëseve pa arsye për faktin se kemi pasur të tillë që janë në moshe të re dhe kanë qasje në teknologji dhe u ndie një mungesë e komunikimit mes DKA-se dhe drejtoret e shkollave që fare nuk kanë qenë të angazhuar në këtë proces. Drejtori tha që ka qenë numri 63, që pajtohem me atë numër mirëpo pe mua është shqetësuese kur e presin nxënësit dhe ai nuk kyqet, që kemi pasur raste të tilla. Pyetja për drejtorin është se sa jeni angazhuar për me i trajnuar këta arsimtar, nëse ka qenë ankesa se nuk din me i përdor teknologjinë informative, a keni mundur me pas trajnime të tilla në sallën e kuvendit apo shtëpinë e kulturës duke përfshirë IT-të e komunës pastaj njohësit e teknologjisë për këshilla eventuale. Për neve është

shume e dhimbshme që numri 17.6% i nxënësve nuk janë kyçur në asnjë proces dhe ata janë përgjegjësi të prindërve ndërsa arsimtaret në përgjegjësi të komunës gjegjësisht të DKA-së. Faleminderit!

Rukije Krasniqi – Faleminderit kryesues. Unë dua të flas vetëm për organizimin e mësimit online dhe të mos dalim jashtë temës sikur kolegët më parë. Organizimi i mësimit gjatë pandemisë mendoj se ka qenë jashtëzakonisht i mirë nëse e krahasojmë me kushtet që i kemi pasur nëpër familjet tona, e aq me tepër duke ditur numrin e nxënësve/të fëmijëve që i kemi në familje. Ndodh që 2 apo 3 fëmijë i kemi në shkollë dhe kemi një mjet teknologjik/telefon/laptop e ka apo nuk e ka fare atë. Do të thotë që me mundësitë dhe kushtet familjare që kanë në familje, prindërit kanë bërë çmos që të realizohet një mësim i tillë online në distancë. Kjo vlen me përmend që edhe fëmijët kanë qenë mjaft të interesuar por një falënderim të veçantë duhet të ju dërgohet edhe prindërve. Sa i përket mësimdhënësve, kemi edhe mësimdhënës që nuk din të përdorin teknologjinë edhe nuk kanë formë apo mënyrë tjetër se si me ju qasë atij projekti që duhet të realizohet në mënyrën e duhur sepse kemi mësimdhënës afër pensionit edhe ata nuk dinë edhe formën si me ju qasë apo platformën tjetër si me MSN apo facebook të cilat janë përdor. Po ashtu ka mësimdhënës që këto forma të komunikimit nuk din edhe me i përdor por shumica e mësimdhënësve pra pjesa dërrmuese të mësimdhënësve duke përfshirë edhe lëndët e shkathtësisë, edukatën fizike kulture muzikore e kanë arrit vetëm nëpërmjet këtij mësimi online. Pra ishte fjala për mësimdhënësit e Isa Boletinit, nuk e di se për çfarë informata bëhet fjalë dhe nga i kanë marrë, ku çdo kush duhet të niset nga shkollat e veta. Unë si mësimdhënëse e Isa Boletinit një numër i madhe i mësimdhënësve jemi të kyçur qysh në fillim, që fillimisht jemi kyçur në aplikacionin Viber sepse nuk kemi ditur platforme tjetër derisa pas dy jave na kanë informuar nëpërmjet zoom-it. Menjëherë kur kemi qenë të informuar dhe kemi mësuar praktikën e zoom-it atëherë kemi filluar me mësimin, me detyra me pyetje me të gjitha vlerësimet atëherë në mënyrë të rregullt duke përjashtuar mësimdhënësit e vjetër apo të cilët ata ndoshta nuk i kanë pasur kushtet në shtëpitë e tyre. Po ashtu një falënderim përveç mësimdhënësve e nxënësve, një falënderim shume i madhe shkon për prindërit që kanë qenë kokulur se bashku me fëmijët e tyre pranë ekraneve televizive apo mjeteve teknologjike për me realizua një mësim të tillë. Faleminderit!

Avni Morina – Faleminderit shumë të gjithëve për pyetjet dhe konstatimet që ne një formë të gjithë gjatë kësaj periudhe kemi jetua me fëmijët tanë dhe me preokupimet që i kanë pasur ata. Unë jam njëri prej jush dhe jam njëri prej prindërve dhe njeri prej mësimdhënësve të komunës sonë sepse edhe unë i kam 4 fëmijë në familjen time pra dy studentë dhe dy tjerë njeri në shkollë fillore dhe tjetri në shkollë të mesme dhe jam marr vazhdimisht me këtë problematike. Të them të drejtën shtëpia ime sikur edhe shumë të tjerëve që kanë fëmijë neper shkolla janë bërë thuajse qendra interneti, po ashtu një pajisje u deshtë me huazua të djali i axhës pasi nuk kam pasur për të gjithë fëmijët. Në këtë periudhë unë nuk mendoj që as 50 % nuk kanë marr pjesë por edhe kjo shifër që është raportuar prej drejtorëve të shkollave 17:6 % mendoj që është pak më e madhe e mos përfshirjes e që ndoshta mund të shkojë diku rreth 25% sepse nuk po them që nuk po ju besoj drejtorëve por këto janë shifra zyrtare që edhe nëse nuk janë të vërteta ose plotësisht të sakta këto do të verifikohen në ditët në vazhdim sepse ne do të kemi punë prapë dhe unë do të kërkoj prej drejtorëve të shkollave që secili mësimdhënës që nuk ka raportuar te drejtori i shkollës për mbajtjen e mësimit online duhet të gjej formë që të bëjë vlerësimin e nxënësve apo t'i angazhojë ata për të vazhduar procesin d.m.th. përpjekja jonë do të vazhdojë pa marrë parasysh sa janë shifrat. Po ju them edhe njëherë edhe po i përsëriti të dhënat që i kam marr pra të dhënat burimore prej drejtorëve të shkollave sepse ata për mua janë adresa e parë. Përveç që kam marr të dhënat në mënyrë elektronike, unë kam pasur edhe takime online me ata po ashtu edhe takime fizike edhe komunikime përmes telefonit. Fahrie Lushi pyeti për numrin total të mësimdhënësve në komunën tonë? Drejtorja e Arsimit e kemi cekur edhe në tabelë numri total i mësimdhënësve është aty për secilin nivele pra aty është e ndarë niveli, nga niveli zero deri te klasa e

dymbëdhjetë dhe aty është numri total i mësimdhënësve ndërsa në baze të raportit që kam marr nga drejtoret e shkollave janë 745 mësimdhënës ne total dhe 63 janë që nuk janë angazhuar, që me përqindje i bien 8.45% e mësimdhënësve që nuk janë angazhuar. Arsytet se pse nuk janë angazhuar është sepse arsyet janë të ndryshme, por kryesisht ata që nuk janë angazhuar ose e kanë pasur lëndën e tillë sepse ne edukatë fizike nuk mund të angazhohesh në mësim online sepse shumica e plan programit në edukatë fizike është praktikë, shume pak kanë teori edhe lëndët tjera si arti figurativ dhe unë i kam të specifikuara raportet e drejtoreshave të shkollave që i kanë marrë prej mësimdhënësve tyre në secilën lëndë edhe cili nga mësimdhënësit nuk ka mbajtur mësim edhe unë do të kem përgjegjësi me këto shifra që mi kanë dërguar ata. Nuk pajtohem që dikush ndoshta edhe nuk u tregua i drejtë me mua, që sigurisht nuk do të pajtohem asnjëherë me atë sepse tek e fundit janë të detyruar secili mësimdhënës pa i vlerësuar nxënësit e vet qoftë a i kanë angazhuar apo nuk i kanë angazhuar në mësim online sepse e kanë udhëzuesin para vetës dhe Ministria e Arsimit ka kohë që ju ka dërgua udhëzuesin edhe ata duhet të veprojnë sipas udhëzuesit që e kanë marr nga Ministria e Arsimit. Nuk kemi mundur të mbajmë trajnim të atyre mësimdhënësve dhe unë kam vërejt që shumica e atyre mësimdhënësve që nuk kanë mundur të përfshihen në mësim online kanë qenë gjeneratë e vjetër pra afër pensionimit shumica prej tyre por edhe sikur të kishte një iniciativë të tillë për trajnim në këtë periudhë edhe DKA-ja ka pasur stafe të reduktuar. Sikur edhe çdo drejtori tjetër, unë për veti në dy javët e para të pandemisë, vetëm Admir Durgutin e kam pasur aty pasi asnjëri prej tjerëve nuk kam pasur sepse e kemi pas reduktua stafin në atë periudhë edhe s'kemi mundur të bëjmë organizime të tillë e asesi të mbajmë tubime për trajnime pra e kemi ditur që ka nevojë por nuk kemi mundur. Faleminderit.

Fatmir Iska - Unë po e falënderoj drejtorin e Arsimit, njëkohësisht po e shfrytëzoj rastin me i falënderuar të gjithë arsimtarët, pra profesorët e komunës tonë që kanë dhënë kontributin e tyre duke kuptuar që shqetësimet munden me qenë të vogla por gjithashtu falënderoj edhe prindërit, që në njëfarë mënyre u deshtë me qenë pak më shumë të angazhuar në këtë proces, gjithsesi i falënderoj të gjithë për kontributin që kanë dhënë gjatë kohës së pandemisë. Faleminderit!

Kryesuesi – Faleminderit shumë nënkryetar, të nderuar kolegë kuvendarë, ju falënderoj të gjithëve për kontributin e dhënë dhe shihemi në mbledhjen e radhës.

Mbledhja përfundoj në ora 12:00

01 Nr. ____/2020
Rahovec, 29.05.2020

Procesmbajtësi:

Agim Hoti

K R Y E S U E S I

Afrim Dina

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije / Ministry of Finance
Arkiva - Arhiva - Archive

Nr. Prot. 508
Nr. Prot. 508
Nr. Prot. 508
Data 15.05.2020
Prishtinë/A



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Financave dhe Transfereve / Ministarstvo za Finansije i Transfere / Ministry of Finance and Transfers

Zyra e Ministrit / Kancelarija Ministra / Cabinet of the Minister

DATË/A:	15.05.2020
PËR/ZATO:	Ministrat, Kryetarët e Komunave, Udhëheqësit e Organizatave buxhetore, Drejtorët e Drejtorive Komunale, Zyrtarët Kryesor Financiar, Zyrtarët për buxhet të organizatave buxhetore
NGA/OD/FROM:	Besnik Bislimi, Ministër i Financave dhe Transfereve
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Qarkorja Buxhetore 2021/01


Të nderuar,

Më lejoni t'ju falënderoj për kontributin e juaj në hartimin e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2021-2023, që paraqet bazën për hartimin e buxhetit për vitin 2021.

Në vijim mund të gjeni Qarkoren Buxhetore 2020/01, e cila ofron kufijtë fillestar buxhetor për secilën Organizatë Buxhetore në nivel qendror për vitin 2020. Ministria e Financave dhe Transfereve mbetet në dispozicion të juaj për të ofruar mbështetjen e nevojshme gjatë procesit të hartimit të Projektligjit të ndarjeve buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021.

Me respekt!

Besnik Bislimi
Ministër i Financave dhe Transfereve



Qarkorja Buxhetore 2021/01

1. Qëllimi

Ministri për Financa dhe Transfere është i autorizuar dhe përgjegjës që në përputhje me nenin 20 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr. 03/L-048, të nxjerrë qarkore buxhetore për cilëndo ose të gjitha organizatat buxhetore me të cilat sigurohen udhëzime për përgatitjen e Buxhetit të Kosovës.

Në mbështetje të kësaj dispozite ligjore, Ministri nxjerr Qarkoren e Parë Buxhetore 2021/01, ku ofrohen udhëzimet e para për hartimin e buxhetit për vitin 2021 dhe vlerësimet për vitet 2022-2023, kalendarin kohor indikativ si dhe kufijtë fillestar buxhetor për vitin 2021 dhe vlerësimet për vitet 2022-2023 për çdo Organizatë Buxhetore. Në rast nevojë, pas kësaj qarkoreje do të pasojnë qarkore të tjera shtesë deri në finalizimin e buxhetit për vitin 2021 dhe vlerësimet për vitet 2022-2023.

2. Konteksti për përgatitjen e buxhetit për 2021-2023

Korniza për buxhetin e vitit 2021 bazohet në KASH 2021-2023 që është aprovuar nga Qeveria e Kosovës bazuar në prioritetet afatmesme të Qeverisë dhe kornizën makro-fiskale për vitet 2021-2023. Qeveria është e përkushtuar që duke ruajtur stabilitetin fiskal të përkrah kërkesat e organizatave buxhetore, brenda orientimit sektorial buxhetor të përcaktuar me KASH 2021-2023, sipas prioriteteve të përcaktuara përmes Deklaratës së Prioriteteve Afatmesme të Qeverisë.

Projeksionet fiskale të KASH 2021-2023 kanë përcaktuar burimet e financimit që Qeveria mund të ketë në dispozicion për shpenzim në vitin 2021, dhe vlerësimet e viteve vijuese. Çdo tendencë për tejkalim të kufijve të shpenzimeve mbi kufijtë e kësaj qarkoreje e bën të detyrueshëm ndryshimin përkatësisht rritjen e burimeve të financimit, gjegjësisht ndryshimin e politikave tatimore për të arkëtuar të hyra shtesë.

Gjatë zhvillimit të procesit buxhetor, duhet të marrim parasysh edhe zotimet tona në raport me institucionet financiare ndërkombëtare. Në këtë kontekst, Qarkorja Buxhetore 2021/01 është hartuar në pajtim me obligimet nga marrëveshjet financiare ekzistuese dhe të atyre në negocim, dhe reflekton përkushtimet për drejtimin e politikave fiskale të përcaktuara në pajtim me Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN).

3. Parashikimet për implementimin e buxhetit 2020

Para prezantimit të kërkesave buxhetore për vitin 2021, organizatat buxhetore duhet t'i prezantojnë Ministrisë së Financave dhe Transfereve një parashikim të realizimit deri në fundvit të buxhetit të vitit 2020 në nivel të programeve, nën-programeve, dhe projekteve individuale. Organizatat buxhetore duhet të identifikojnë dhe të njoftojnë Ministrinë e Financave dhe Transfereve për nën apo mbi shpenzimet eventuale në buxhetin ekzistues, para parashtrimit të kërkesës buxhetore për vitin 2021, dhe vlerësimeve për 2022-2023.

4. Kriteret e përgjithshme për përgatitjen e buxhetit për 2021-2023

Procesi buxhetor për vitet 2021-2023 ka për qëllim ndërlidhjen e planeve dhe politikave buxhetore me prioritetet të Qeverisë. Në nivel sektorial, kjo ndërlidhje është realizuar në prioritizimin e sektorëve buxhetor në KASH 2021-2023. Përmes kësaj qarkoreje, kërkohet që organizatat buxhetore të konkretizojnë kërkesat e prezantuara në KASH, duke detajuar kështu përgatitjen e buxhetit në nivel të programeve, nën-programeve, kategorive të shpenzimeve dhe projekteve specifike.

Kërkesat për shpenzime të reja duhet të prezantohen vetëm nëse të njëjtat janë përfshirë në KASH 2021-2023. Gjatë procesit buxhetor, Ministria e Financave dhe Transfereve duhet të sigurohet se totali i shpenzimeve për të gjitha organizatat brenda një sektori e përcjell shumën e paraparë me KASH 2021-2023 për këtë sektor.

Organizatat buxhetore duhet të kenë parasysh që gjatë përgatitjes së kërkesave të tyre t'u japin prioritet:

- Projekteve të cilat ndihmojnë në realizimin e prioritetëve të Qeverisë, të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2016-2021, Programin Qeveritar, dhe në Programin për Reforma në Ekonomi 2020-2022;
- Projekteve të cilat janë në vazhdimësi nga vitet paraprake dhe që kanë obligime kontraktuale;
- Zotimet e Qeverisë për Planin e Veprimit për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit dhe programin – Instrumenti i Para-Anëtarësimit (IPA);
- Legjislacioni i ri apo ndryshim plotësimi i atij ekzistues;
- Të përfshijnë brenda ndarjeve buxhetore obligimet për financim të jashtëm të projekteve individuale dhe
- Të kujdesen që të hyjnë në obligime për bashkëfinancim vetëm deri në nivelin që lejon korniza e tyre buxhetore.

Procesi i planifikimit të buxhetit duhet të përfshijë këto aspekte:

- Buxhetimi në nivel të programeve dhe nën-programeve, në përputhje me strukturën ekzistuese të planit kontabël;
- Përmirësimet në qasjen e buxhetimit të orientuar drejt rezultateve dhe performancës;
- Zbatimi i konceptit shumëvjeçar mbi planifikimin e projekteve kapitale;
- Prezantimi tabelar mbi burimet e financimit dhe strukturën e shpenzimeve sipas kategorive të shpenzimeve për vitin 2021 dhe projeksionet për vitet 2022-2023 dhe
- Gjatë procesit buxhetor vëmendje e shtuar duhet t'i jepet zbatimit të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe praktikave të mira buxhetore me fokus në këto çështje:
 - Plotësimin e të dhënave që kërkohen në sistemet buxhetore SZHM dhe PIP;
 - Eliminimin e keqklasifikimit të shpenzimeve buxhetore;
 - Projektet e propozuar të jenë projekte të përgatitur në përputhje me Manualin e PIP dhe Udhëzimin Administrativ për Kriteret Përzgjedhëse të Projekteve Kapitale;
 - Projektet e propozuar të jenë të maturuar (projekte të gatshëm për zbatim);
 - Regjistrimi i zotimeve shumëvjeçare në SIMFK;
 - Ministrinë të cilat ndajnë mjete buxhetore për realizimin e projekteve kapitale në nivel komunal, duhet të bëjnë shpërndarjen e fondeve duke trajtuar komunat në mënyrë të drejtë e të barabartë;
 - Buxhetimi i projekteve kapitale duhet të bëhet në përputhje me Udhëzimin Administrativ për Definimin e Projekteve Kapitale dhe Klasifikimin e

Shpenzimeve të Projekteve Kapitale, ku pjesë e kostos së projektit janë edhe *shpenzimet e shpronësimit*. Me këtë rast, organizatat buxhetore, pas një analize paraprake duhet të planifikojnë shpenzimet e shpronësimit në kuadër të kostos totale të projektit.

Vëmendje e shtuar do t'i jepet në vijim të këtij procesi nga MFT zbatimit të rekomandimeve të lartpërmendura dhe vërejtjet do të regjistrohen nga analistët e buxhetit në sistemin PIP.

Qeveria mund të ndryshojë strukturën e shpenzimeve me qëllim të arritjes së prioritetëve të saj, si brenda programeve të një organizate buxhetore, ashtu edhe zhvendosjen e buxhetit nga një organizatë në tjetrën të nivelit qendror.

Kërkesat buxhetore duhet të mbështesin politikat prioritare të Qeverisë dhe duhet të fokusohen në këto fusha, drejtësi; ekonomi dhe punësim; arsim; shëndetësi; siguri; integritet euro-atlantike; dhe mjedis.

Shpenzimet rrjedhëse: organizatat buxhetore duhet të bëjnë kërkesat e tyre për brenda kufizimeve buxhetore. Është thelbësore që të gjitha organizatat buxhetore t'u përmbahen kufijve të dhënë në Shtojcën 1. të bashkangjitur, për vitet 2021-2023. Shpenzimet operative për vitin 2021 dhe vlerësimet për vitet 2022 dhe 2023 do të jenë pothuajse të njëjta si në vitin 2020 në nivelin agregat. Kjo vjen si rezultat i efekteve ekonomike të cilat kanë qenë gjatë vitit 2020 në luftimin e pandemisë COVID-19.

Punësimi: Në parim nuk do të ketë rritje të punësimit në sektorin publik përveç kur ka një vendim të qartë për domosdoshmërinë e punësimeve të reja dhe kur është siguruar buxheti.

Pagat dhe shtesat: Organizatat buxhetore duhet të planifikojnë rritjen vjetore të faturës së pagës në nivel prej 0.5% sipas nenit 22C, pika 1.4 të Ligjit 05/L-063.

Mallra dhe shërbime: do të kenë rritje në financim aty ku shprehet e domosdoshme siç është regjistrimi i popullsisë, zgjedhje komunale si dhe furnizimi me barna. Organizatat buxhetore duhet të identifikojnë burimet brenda skenarëve bazë të tyre nga ato fusha me performancë jo të mirë, ose që nuk janë në përputhje të mjaftueshme me prioritetet e nivelit të lartë të Qeverisë për përmbushjen e aktiviteteve me prioritet të lartë:

Shpenzimet komunale: priten të ketë pjesëmarrje të njëjtë krahasuar me vitin 2020.

Subvencionet dhe transferet: Kjo kategori e shpenzimeve pritet të rritet mesatarisht për 2% në periudhën afatmesme dhe do të bazohen në politikë të qartë të mbrojtjes sociale në veçanti për shtresat më të ndjeshme të popullsisë. Do të vazhdohet me ndarjen e mjeteve për zbatimin e Skemave sociale dhe pensionale përfshirë këtu edhe rritjen natyrale të skemave pensionale, subvencionimet në bujqësi si dhe do marrë parasysh politikat e reja tani më të aprovuara në Qeveri.

Shpenzimet kapitale: përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve të përgjithshme dhe pritet të përfaqësojnë rreth 27.5% të shpenzimeve totale në periudhën afatmesme. Gjatë kësaj periudhe, pritet implementimi i projekteve kapitale bazuar në një listë prioritare që përmban projekte me ndikim në përmirësimin e rrjetit të transportit, përmirësimin e rrjetit të energjisë elektrike dhe përmirësimin e kushteve në arsim, sistemin social dhe atë shëndetësor. Kjo kategori e shpenzimeve pritet të rritet me një normë prej 4% në periudhën afatmesme. Pjesa më e madhe e investimeve kapitale gjatë periudhës së ardhshme afatmesme pritet të

jetë nga financimi i buxhetit të rregullt, mirëpo një numër i madh i projekteve në sektorë të ndryshëm planifikohet të financohet nga huazimi i jashtëm përmes klauzolës së investimeve.

Projektet e reja duhet të caktohen në përputhje me Udhëzimin administrativ për kriteret përzgjedhëse të projekteve kapitale që është aprovuar nga Ministri i Financave dhe Transfereve dhe ka hyrë në fuqi nga Janari i këtij viti. Kriteret kryesore për përzgjedhjen e projekteve të reja kapitale sipas këtij udhëzimi janë përputhshmëria e projekteve me Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit, arsyeshmëria e propozimit në bazë të analizës ekonomike dhe financiare dhe maturiteti i projekteve (të gatshëm për zbatim).

Përparësi në financim do të kenë projektet që janë në vazhdim si dhe ato të cilat janë në harmoni të plotë me prioritetet e Qeverisë. Të gjitha projektet kapitale mbi një milion euro duhet të përgatiten mbi bazën e analizës kost-benefit. Rrjedhimisht, kufijtë buxhetor për shpenzime kapitale nëpër organizata buxhetore janë indikativ dhe Qeveria mban të drejtën t'i ndryshojë ata varësisht nga arsyeshmëria e projekteve që propozohen nga organizatat buxhetore.

Për organizatat buxhetore të cilat konkurrojnë për fonde të huamarrjes (nga deficit i buxhetor prej 2% - përmes fondit 04) dhe nga klauzola e investimeve – përmes fondit 06 (aplikimi për fondet nga klauzola bëhet vetëm për projekte kapitale), është gjithashtu e nevojshme që projektet të plotësojnë kriteret e sipërpërmendura duke përfshirë analizën e shpenzimeve rrjedhëse para, gjatë dhe pas përfundimit të projektit të cilat duhet të jenë në kuadër të projeksioneve të organizatës buxhetore.

5. Programi për investime publike (PIP)

Planifikimi i buxhetit për investime kapitale bëhet përmes sistemit të PIP-it. Është e rëndësishme që prioritetet strategjike të Qeverisë, ashtu si janë paraqitur në "Deklaratën e Prioriteteve Afatmesme të Qeverisë 2021-2023" në kuadër të KASH-it 2021-2023 të jenë bazë për përgatiten e kërkesave buxhetore dhe identifikim të projekteve kapitale.

Të gjitha organizatat buxhetore duhet të arsyetojnë kërkesat buxhetore për projektet e tyre në përputhje të plotë me kërkesat e PIP-it.

6. Sistemi i Zhvillimit dhe Menaxhimit të Buxhetit (SZHMB)

Siç është e njohur, Sistemi i Zhvillimit dhe Menaxhimit të Buxhetit është sistem financiar i cili merret me formulimin e buxhetit dhe planifikimin e shpenzimeve për të gjitha kategoritë të shpenzimeve. Që tani Sistemi SZHMB është në dispozicion për shfrytëzim nga organizatat buxhetore. Organizatat Buxhetore janë të detyruara që të respektojnë kufijtë e lëshuar me Qarkoren e parë buxhetore. Sistemi i SZHMB dhe sistemi i PIP-it nuk do të lejojnë në asnjë rast tejkalim të kufijve të lëshuar me qarkoren e parë buxhetore.

7. Indikatorët e performancës

Organizatat buxhetore të nivelit qendror duhet të prezantojnë indikatorët e performancës të përmbledhur sipas objektivave dhe aktiviteteve përkatëse në nivel të organizatës buxhetore, bazuar në nenin 21 të Ligjit Nr.03/L-48 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Organizatat buxhetore duhet të paraqesin 1 deri në 5 objektiva, të cilat janë të lidhura me strategjitë dhe mbulojnë programet më të rëndësishme. Gjithashtu kërkesat për fonde shtesë nga buxheti duhet të justifikohen në mënyrën se si ato kontribuojnë në arritjen e objektivave.

Forma e ofrimit të këtyre informatave është dhënë në Aneksin 2. Në mënyrë specifike për secilën organizatë buxhetore duhet të ofrohen këto informata:

- **Objektivat e outputit** përshkruajnë rezultatet e pritshme nga ofrimi i shërbimeve, të cilat janë nën kontrollin e organizatës buxhetore;
- **Treguesit e outputit** matin aktivitetin e institucionit, si p.sh sasinë apo cilësinë e shërbimit ose produktit.
 - a) Indikatori treguesi bazë;
 - b) Indikatori treguesi i synuar;
- Aktivitetet përshkruajnë veprimet për arritjen e objektivave të deklaruar.

8. Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinator (BPGJ)

Duke vepruar sipas Ligjit për Barazi Gjimore Nr.05/L-020 (2015), institucionet e Kosovës janë përgjegjëse për "përfshirjen e buxhetimit gjinor në të gjitha fushat, si një instrument i nevojshëm për të garantuar që parimi i barazisë gjinore të respektohet në mbledhjen, shpërndarjen dhe caktimin e burimeve" (Neni 5.1.5.). Për këtë arsye, organizatat buxhetore duhet të bëjnë të dukshme efektet e shpenzimeve publike në barazinë gjinore në buxhetin vjetor për vitin 2021. Kjo do të kontribuon gjithashtu në rritjen e efektivitetit dhe transparencës së menaxhimit të financave publike. Komunitat duhet të marrin parasysh këto udhëzime në nxjerrjen e qarkores së brendshme buxhetore komunale, si dokument bazë për planifikimin e buxhetit komunal për periudhën 2021-2023. Nëse ka paqartësi në këtë drejtim, organizatat buxhetore mund të konsultohen me analistët përkatës në kuadër të Departamentit të Buxhetit në Ministrinë e Financave. Forma e ofrimit të këtyre informatave është dhënë në Aneksin 1. Gjithashtu, me rastin e propozimit të buxhetit, organizata buxhetore duhet të adresojë në mënyrë korrekte vërejtjet dhe propozimet e zyrtarit përgjegjës për barazi gjinore të organizatës buxhetore.

9. Kufijtë buxhetor për organizatat buxhetore të nivelit qendror për 2021-2023

Organizatat Buxhetore të nivelit qendror duhet të marrin parasysh kufijtë buxhetore të dhënë në tabelën në vijim gjatë përgatitjes së buxhetit të tyre për vitin 2021 dhe për dy vitet në vijim. Ju lutem të keni parasysh se këta kufij buxhetor mund të ndryshojnë varësisht nga lëvizjet fiskale apo vendimet e Qeverisë të cilat do të pasqyrohen përmes Qarkoreve Buxhetore pasuese si dhe kualitetit të kërkesave buxhetore. Projektet kapitale të filluara nga vitet e kaluara, të cilat kanë krijuar obligime kontraktuale mbi mjetet e buxhetuara për organizatat buxhetore përkatës, duhet të përfshihen brenda buxhetit për vitet 2021-2023.

Më poshtë në Tabelën 1 janë kufijtë buxhetor për organizatat buxhetore qendrore për 2021-20

10. Fazat e procesit buxhetor për vitin 2021 për nivelin qendror

Pjesa në vijim prezanton kalendarin kohor të buxhetit, hapat dhe veprimet gjatë procesit buxhetor për vitin 2019.

- 30 Prill – aprovimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2021-2023 nga Qeveria dhe dorëzimi i KASH-it në Kuvendin e Republikës së Kosovës.
- 15 Maj - Lëshimi i Qarkores së parë buxhetore 2021/01. Kjo qarkore përmban udhëzimet për procesin buxhetor, kufijtë buxhetor dhe kalendarin buxhetor.
- 25 Qershor- Organizatat buxhetore të dorëzojnë në MFT kërkesat buxhetore sipas dokumentacionit përkatës, sipas programeve dhe kategorive të shpenzimeve. Kërkesat buxhetore duhet të jenë plotësisht të arsyetuara përmes përdorimit të sistemit të SZHMB-se dhe PIP-it.
- 25 Qershor- Departamenti i Makroekonomisë paraqet kornizën e re makro-fiskale.
- 10 Korrik - Qarkorja buxhetore 2020/02 do të lëshohet sipas nevojës dhe do të adresoj vetëm çështjet specifike të reja të cilat kanë rezultuar pas lëshimit të Qarkores së parë buxhetore.
- 24 Korrik- Nëse kërkohen informata shtesë sipas Qarkores së dytë buxhetore atëherë këto informata duhet të dorëzohen nga Organizatat buxhetore në Ministrinë e Financave dhe Transfereve – Departamentin e buxhetit deri në këtë datë.
- 20 Gusht – 28 Gusht - Dëgjimet buxhetore (pas pranimi të materialeve nga organizatat buxhetore). Pjesëmarrës në dëgjime do të jenë zyrtarët të organizatave buxhetore, stafi i MFT, Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, përfaqësues të Komisionit Parlamentar për Buxhet dhe Financa. Orari i dëgjimeve buxhetore do t'i bashkëngjitet Qarkores buxhetore 2021/02. Nëse është e mundur në këto dëgjime, do të shikohet mundësia e arritjes së marrëveshjes për shumat totale të buxhetit të organizatës suaj për vitin 2021.
- 10 Shtator, Departamenti i Makroekonomisë paraqet vlerësimet e fundit për indikatorët makro-ekonomik, posaçërisht indikatorët që lidhen me procesin buxhetor 2020-2022.
- 16 Shtator – 20 Shtator, konsultime në Qeveri për caktimin e kufijve final buxhetore.
- 25 Shtator, nxjerrja e Qarkores së tretë buxhetore me kufijtë final buxhetor, të cilët mund të ndryshojnë nga qarkorja paraprake.
- 28 Shtator-Tetor-2 Tetor Ankesat nga Organizatat Buxhetore.
- 7 Tetor – 8 Tetor, Takimet e Qeverise për t'i shqyrtuar ankesat e organizatave buxhetore.
- 15 Tetor, Drafti i parë i buxhetit në MFT dhe dërgimi i këtij drafti në Qeveri.
- 16 Tetor –26 Tetor - miratimi final i Draft Buxhetit në Qeveri.
- 29 tetor - Dorëzimi i Draft Buxhetit 2021 në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Kërkesa për buxhet nga organizata buxhetore të nivelit qendror duhet të përfshijë:

- Një tabelë me parashikimet deri në fundvit të implementimit të buxhetit 2020, në nivel programi dhe nën-programi, si dhe komentet përcjellëse për nën-ekzekutimin e apo nevojën për mbi-ekzekutim nga ndarjet e buxhetit 2020
- Tabelat 3.1, 3.1 A, 3.1 B si dhe Formularët e PCF-ve të shtypura nga sistemi i SZHMB-së,
- Tabelat 3.2, 3.2 B dhe Formularët e shtypur nga Sistemi PIP
- Tabelat e Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinator
- Tabelat e Buxhetimit sipas performancës

- Letër kërkesa (shkresa përcjellëse) e nënshkruar nga Sekretari i Përgjithshëm apo Kryeshefi i agjencise me të gjitha materialet buxhetore.
- Përshkrimi i kërkesës në formë narrative, ku duhet të paraqiten këto të dhëna:
 - Të arriturat deri më tani me fokus të veçantë në realizimin e objektivave të parapara në SKZH, PRE, PKZMSA
 - Çfarë synohet të arrihet me ndarjet buxhetore për vitin 2021 dhe vlerësimet për vitet 2022-2023.
